

KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT TËGAZIT NATYROR

Ky dokument i emërtuar “Kodi i Rrjetit të Transmetimit” është hartuar nga shoqëria ALBGAZ sh.a në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.102/2015, datë 23/09/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe në pajtueshmëri me dispozitat e Kodeve të Rrjetit dhe Manualit Operacional të ENTSO-E.

Qëllimi i Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror, i referuar ndonjëherë si "Kodi" ose "Kodi i Rrjetit" është të ofrojë një bashkësi termash dhe kushtesh standarde të hapura dhe transparente për transportin e gazit natyror përmes sistemit të transportit të gazit në Shqipëri nga Shoqëritë e licensuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e Përmbajtjes	i
1. HYRJE	1
1.1. Hyrje.....	1
1.2. Historiku i sistemit të transmetimit.....	1
1.3. Kodi operativ	2
1.4. Përshkrimi i sistemit	2
1.5. Pikat e sistemit.....	2
2. PËRKUFIZIME	4
2.1. Përkufizime	4
2.2. Skema emërtuese	26
3. PALËT E REGJISTRUARA	29
3.1. Aplikimi për tu bërë një palë e regjistruar	29
3.2. Përditësime të informacionit.....	30
3.3. Të drejtat dhe detyrimet e palëve të regjistruara	31
3.4. Heqja nga regjistri	31
4. ÇËSHTJET E KREDITIT.....	34
4.1. Caktimi i një limiti krediti fillestar	34
4.2. Përditësimi i limiteve të kreditit	34
4.3. Përcaktimi i limitit të kreditit.....	36
4.4. Krediti fillestar i disponueshëm.....	37
4.5. Llogaritja e kreditit të disponueshëm	37
4.6. Realizimi i mbështetjes së kreditit	38
4.7. Lëshimi i mbështetjes së kreditit.....	38
5. PRODUKTE KAPACITETI.....	39
5.1. Kapaciteti i disponueshëm si produkt kapaciteti.....	39
5.2. Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë	39
5.3. Kapacitet në drejtimin përpara (forward) i ndërprerë	40
5.4. Kapaciteti revers.....	40
6. REZERVIMI I KAPACITETIT	41
6.1. Qasja në platformën e rezervimit të kapacitetit.....	41
6.2. Kalendari i ankandit.....	41
6.3. Kapaciteti në drejtimin përpara (forward): rezervimi	41
6.4. Kapaciteti në drejtimin përpara (forward): (kapacitet i lidhur (bundled)).....	42
6.5. Kapaciteti revers: rezervimi.....	43
6.6. Kapaciteti revers: rezervimi.....	43
6.7. Zhvillimi i ankandeve	44

6.8.	Publikimi i rezultateve të ankandit.....	44
6.9.	Vlera e ankandit (auction premium)	44
6.10.	Testet e tregut dhe procesi i kapacitetit rritës.....	45
6.11.	Kapaciteti ndalues/rregullues (capacity ratchet)	45
6.12.	Aksesi në kapacitet në pikat e sistemit që nuk janë pikë ankandi	46
7.	TREGU SEKONNDAR	48
7.1.	Aksesi në tregun sekondar.....	48
7.2.	Procedura e transferimeve.....	48
7.3.	Procedura për delegimet.....	49
7.4.	Kushtet për tregtimin në tregjet sekondare	51
7.5.	Efektet e tregtimeve të tregjeve sekondare	52
7.6.	Njoftimet për transferimet e kapacitetit të rezervuar.....	52
8.	NOMINIMET	54
8.1.	Nominimet e dy-anshme	55
8.2.	Nominimet për kapaciteti revers	56
8.3.	Nuk përdoret	56
8.4.	Procedura e përgjithshme	56
8.5.	Dorëzimi i nominimeve.....	56
8.6.	Pika virtuale e tregëtimit dhe njoftimet tregëtare.....	57
8.7.	Kalendari	58
8.8.	Rinominimet.....	59
9.	PËRPUTHJA DHE KONFIRMIMI	61
9.1.	Fillimi i procesit të përputhjes	61
9.2.	Verifikimi i sasive të nominuara dhe sasive të tregtuara	61
9.3.	Përputhja.....	62
9.4.	Sasitë e konfirmuara	63
10.	BALANCIMI DHE ALOKIMI	65
10.1.	Disbalancimi i transmetimit.....	65
10.2.	Nuk përdoret	65
10.3.	Tarifa ditore e disbalancimit.....	65
10.4.	Alokimi në pikat e interkoneksionit	66
10.5.	Alokimi në pikat e tjera të sistemit.....	67
10.6.	Alokimet në pikën virtuale të tregëtimit.....	68
10.7.	Alokimi provizor.....	68
10.8.	Marrëveshja e neutralitetit	68
10.9.	Shuma e pagesës së neutralitetit.....	69
10.10.	Shërbimet e balancimit.....	70

10.11.	Platforma balancuese.....	72
10.12.	Tarifat e skedulimit.....	73
10.13.	Çmimi referencë i gazit.....	76
11.	MIRËMBAJTJE E PLANIFIKUAR	78
11.1.	Njoftimet për mirëmbajtje.....	78
11.2.	Ndryshimet në njoftimet e mirëmbajtjes.....	79
11.3.	Detyrimet e transportuesit në lidhje me mirëmbajtjen e planifikuar.....	79
11.4.	Reduktimi i Mirëmbajtjes së Planifikuar	80
12.	REDUKTIMI I KAPACITETIT	82
12.1.	Të përgjithshme.....	82
12.2.	Kufizimi i kapacitetit dhe mirëmbajtja e planifikuar	82
12.3.	Kufizimi i kapacitetit në drejtimin përpara (forward) i pandërprershëm	84
12.4.	Ndërprerja dhe kufizimi i kapacitetit revers	84
12.5.	Ndërprerja dhe kufizimi i kapacitetit në drejtimin përpara (forward) të ndërprershëm	85
12.6.	Kufizimet e vazhdueshme të kapacitetit	86
12.7.	Ndërprerje të vazhdueshme	86
12.8.	Emergjencat	86
12.9.	Hapat e emergjencës	87
12.10.	Kontaktet e emergjencës	89
12.11.	Transportuesi duhet të lajmërojë tregëtarët/furnizuesit për emergjencat	89
12.12.	Kontrolli i hyrjes në një emergjencë	90
12.13.	Kontrolli i daljes në një emergjencë	90
12.14.	Pasojat e emergjencës.....	91
12.15.	Auditimi pas një emergjencë	92
12.16.	Procedurat e emergjencës	92
13.	MENAXHIMI I MBINGARKESAVE	93
13.1.	Dorëzimi.....	93
13.2.	Procedura e dorëzimit.....	93
13.3.	(Kapaciteti) përdore ose humbe i ditës në avancë i pandërprershëm) firm day-ahead use-it-or-lose-it (FDA UIOLI).....	95
13.4.	Aplikimi i FDA UIOLI	96
13.5.	Tërheqja e FDA UIOLI.....	97
13.6.	(përdore ose humbe në terma afatgjatë) long term use it or lose it (LT UIOLI).....	98
13.7.	Nën-shfrytëzimi sistematik dhe përjashtimet	99
13.8.	Njoftimi i referimit dhe ankimimi	102
13.9.	Aplikimi i LT UIOLI.....	104

13.10.	LT UIOLI informacion jo konfidencial	106
13.11.	Vlera e ankandit (auction premium)	106
14.	GAZIKARBURANT	108
14.1.	Gazi karburant	108
14.2.	Nuk përdoret	108
14.3.	Shumat e pagueshme në lidhje me gazin karburant	108
14.4.	Nuk përdoret	109
14.5.	Gaz Karburant për tu alokuar për tregëtarët/furnizuesit	109
15.	KY NEN NUK PËRDORET	110
16.	UFG (inaccounted for gas)	111
16.1.	Blerja dhe shitja e UFG.....	111
16.2.	Shumat e pagueshme në lidhje UFG	111
16.3.	Llogaritja UFG	112
16.4.	Alokimi i UFG tek tregëtarët/furnizuesit.....	113
17.	MATJA	114
17.1.	Pajisjet matëse	114
17.2.	Korrigjimi i të dhënave të pasakta të matjes	115
17.3.	Kërkesat për verifikim.....	116
17.4.	Detyrimi për të instaluar pajisje matëse.....	118
18.	RISHPËRNDARJA	119
18.1.	Të përgjithshme.....	119
18.2.	Fondi i veçantë i rregullatorit	119
19.	FATURIMI	120
19.1.	Deklarata master.....	120
19.2.	Deklarata vjetore	121
19.3.	Korrigjimi i deklaratave mujore.....	122
19.4.	Procedurat e faturimit, afatet kohore etj.	123
20.	PEZULLIMI	125
20.1.	Pezullimi i të drejtave dhe shërbimet e transportit	125
20.2.	Rrethanat që nxisin një pezullim.....	125
21.	KOMUNIKIMET	127
21.1.	Rendi i përparësisë së komunikimeve.....	127
21.2.	Edig@s	128
21.3.	Platforma elektronike e të dhënave.....	129
22.	MODIFIKIMI	130
22.1.	Modifikimi i kodit të rrjetit.....	130
22.2.	Dorëzimi i kërkesave për modifikim.....	130

22.3.	Vlerësimi i kërkesave për modifikim	131
22.4.	Konsultimi publik i modifikimit	133
22.5.	Procesi i miratimit.....	133
22.6.	Ndryshimi i kodit të rrjetit	134
22.7.	Paneli i modifikimit	134
22.8.	Modifikime urgjente	135
23.	NUK PËRDORET	136
24.	REGJISTRIMET	137
24.1.	Regjistri i pikës dalëse të sistemit.....	137
24.2.	Njoftim për regjistrimin e pikës dalëse	137
24.3.	Njoftimi	138
24.4.	Data	140
25.	KËRKESAT PËR HYRJE DHE DALJE	141
25.1.	Qëllimi.....	141
25.2.	Dispozitat e matjes.....	141
25.3.	Kërkesat për hyrje në sistem.....	141
25.4.	Ndryshime në dispozitat e hyrjes në sistem	142
25.5.	Dispozitat e hyrjes në sistem	143
25.6.	Procedurat lokale të operimit.....	144
25.7.	Tregëtar/Furnizues dorëzues dhe gaz i dorëzuar	145
25.8.	Përputhshmëria me kushtet e hyrjes së gazit.....	145
25.9.	Lidhjet e marrjes (offtake)	147
25.10.	Të drejtat sipas ligjit	148
25.11.	Kërkesat për marrjes	149
25.12.	Specifikimi i gazit në dalje	150
26.	PLANIFIKIMI I SISTEMIT	152
26.1.	Përgatitja e planit të zhvillimit të rrjetit të transmisionit	152
26.2.	Dispozitat e informacionit për transportuesin	152
27.	TË PËRGJITHSHME	154
27.1.	Ligji qeverisës	154
27.2.	Përgjegjësia.....	154
27.3.	Mosmarrëveshjet që do të zgjidhen nga ARK	154
27.4.	Mosmarrëveshjet që lidhen me Kodin e Rrjetit	154
27.5.	Taksat etj.....	155
27.6.	Konfidencialiteti.....	155
27.7.	Delegimi	158
27.8.	Forcë Madhore	159

27.9. Titulli i Gazit	160
SHTOJCA 1: SISTEMI I TRANSMETIMIT	161
PJESA 1: PËRSHKRIMI I SISTEMIT	161
PJESA 2: PAJISJET MATËSE.....	162
SHTOJCA 2: PIKAT E NDËRLIDHJES	163
Tabela A: Pikat e Interkoneksionit dhe pikat e hyrjes dhe pikat e daljes në lidhje me kapaciteti në drejtimin përpara (forward).....	163
Tabela B: Pikat e hyrjes dhe pikat e daljes në lidhje me kapacitetin revers	163
SHTOJCA 3: Formulari i regjistrimit	164
SHTOJCA 4:Specifikimi i gazit natyror	165
SHTOJCA 5: Procedura operative për lidhjen e gazit	166

1. HYRJJE

1.1. Hyrje

- a) Ky Kod lidhet me Sistemin e Transmetimit të Shqipërisë dhe përmban rregullat dhe procedurat për funksionimin e Sistemit të Transmetimit dhe detajon të drejtat dhe detyrimet e Albgaz si transportuesi, palëve të regjistruara dhe tregëtarëve/furnizuesve (shippers) në lidhje me rezervimin dhe përdorimin e produkteve të kapacitetit.
- b) Këtij Kodi i jepet efekt kontraktual me anë të një marrëveshjeje kuadër të datës [_____] ("marrëveshja kuadër").
- c) Një person mund të bëhet një tregëtar/furnizues vetëm në bazë të këtij kodi duke aderuar në përputhje me kushtet e nenit 3 të Marrëveshjes kuadër me anë të ekzekutimit të një marrëveshjeje aksesi, të përcaktuara në shtojcën 6 të këtij kodi dhe kushtet e marrëveshjes kuadër. Të gjitha referencat në këtë kod do të përfshijnë Marrëveshjen kuadër dhe çdo Marrëveshje aksesi në fuqi.
- d) Nënshkruesit origjinalë të marrëveshjes kuadër janë tregëtar/furnizues sipas këtij kodi dhe nuk ju kërkohet të përfundojnë procesin e aplikimit në nenin 3 të këtij kodi.
- e) Termi tregëtar/furnizues nënkupton tregëtarë dhe/osefurnizues.

1.2. Historiku i sistemit të transmetimit

- a) Sistemi i transmetimit në Shqipëri është i rregulluar në bazë të Ligjit Nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" dhe për momentin furnizohet me gaz nga një pikë interkoneksioni në Fier, ku sistemi i transmetimit është i ndërlidhur me tubacionin trans adriatik pipeline (TAP).
- b) TAP dhe pika e interkoneksionit me sistemin e transmetimit Shqiptar janë përcaktuar sipas kushteve të opinionit të përbashkët përfundimtar të rregullatorëve të energjisë në aplikimin për përjashtim të TAP AG të datës 6 qershor 2013, dhënë nga ARK-të në përputhje me Direktivën 2009/73 / EC.
- c) Me kohë pritet që sistemi i transmetimit të lidhet me rrjete të tjera sistemesh kombëtare dhe Kodi i Rrjetit do të ndryshohet në mënyrë të duhur.
- d) Gjithashtu me kalimin e kohës, sistemi i transmetimit mund të lidhet me Sistemet e Shpërndarjes së presionit më të ulët brenda Shqipërisë të rregulluara nga kodet e tyre të shpërndarjes dhe përsëri do të ndryshohet për të akomoduar këto lidhje.

1.3. Kodi operativ

- a) Ky Kod i rrjetit përfaqëson kodin e rrjetit të transmetimit të përshkruar në ligjin Nr 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

1.4. Përshkrimi i sistemit

- a) Sistemi i transmetimit është sistemi kryesor i tubacioneve në pronësi dhe operim të Albgaz sh.a përmes të cilit transmetimi i gazit është i autorizuar me licencë nga rregullatori i energjisë.
- b) Sistemi i transmetimit:
- (i) përfshin të gjitha tubacionet e gazit me presion të lartë, impiante gazi dhe pajisje gazi të përdorura për qëllime të transmetimit të gazit
 - (ii) vepron në më shumë se [15] Bar; dhe
 - (iii) nuk përfshin asnjë strukturë të përdorur për magazinimin e gazit
- c) Sistemi i transportit përfshin sistemin e transmetimit dhe sistemin e shpërndarjes.
- d) Sistemi i transmetimit përfshin pikat e sistemit të llojeve të ndryshme siç përshkruhet në paragrafin.1.5.
- e) Një skemë e sistemit është dhënë në shtojcën 1 për të ndihmuar të kuptuarin e kodit. Një plan i azhurnuar i sistemit do të paraqitet nga transportuesi në faqen e tij të internetit dhe do të përditësohet në përputhje me planin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

1.5. Pikat e sistemit

- a) Për qëllimet e këtij kodi
- (i) pikëhyrjeje është çdo pikë e sistemit të transmetimit ku gazi mund të injektohet në sistemin e transmetimit qoftë nga sistemi i ndërlidhur, sistemi i shpërndarjes, terminali GNL, objekti i prodhimit ose objekti i magazinimit.
 - (ii) pikë daljeje është çdo pikë e sistemit të transmetimit ku gazi mund të largohet nga sistemi i transmetimit për tu dorëzuar në një sistem të ndërlidhur, sistem shpërndarje ose objekt magazinimi.
 - (iii) pikë interkoneksioni është çdo pikë e sistemit të Transmetimit që lidh sistemin e transmetimit me një sistem tjetër transmetimi ose një interkonektor dhe mund të përfshijë një pikë hyrjeje dhe një pikë daljeje ose të dyja bashkë.

- (iv) pikë e sistemit është secila nga pikat e mësipërme në sistemin e transmetimit
- (v) pikë e ankandit është çdo pikë sistemi ku kapaciteti vihet në dispozicion përmes një ankandi.
- (vi) pika virtuale e tregtimit është pika nocionale ku titulli ndaj gazit mund të ndryshojë si rezultat i një tregëtie.

2. PËRKUFIZIME

2.1. Përkufizime

Pala pranuese do të thotë një palë e regjistruar që ka pranuar një transferim të kapacitetit të rezervuar.

Tarifa aktuale mujore do të thotë, në lidhje me një tregëtar/furnizues të veçantë, tarifa aktuale mujore e llogaritur për kapacitetin e rezervuar përkatës në përputhje me këtë kod të rrjetit.

OST fqinje do të thotë një OST që operon një sistem të ndërlidhur.

Filiali ka kuptimin që i është dhënë atij në Kushtet dhe Termat e Përgjithshme.

Sasi të alokuara do të thotë sasia e gazit natyror të alokuar për një tregëtar/furnizues në lidhje me dorëzimin nga ose ri-dorëzimin (sipas rastit) tek ai tregëtar/furnizues në një pikë të sistemit ose në pikën virtuale të tregimit për një ditë gazi (gas day), e shprehur në kWh. sasi të alokuara në pikat e hyrjes ose për tregtimet kur gazi dorëzohet në pikën virtuale të tregimit do të shprehen si një numër pozitiv dhe sasi të alokuara në pikat e daljes ose për tregtimet kur gazi dorëzohet prej pikës virtuale të tregimit do të shprehet si numra negativ.

Kapacitet mbështetës i kredituar në mënyrë alternative nënkupton ndonjë prej:

(a) një produkt kapaciteti i rezervuar para datës efektive fillestare; ose

(b) një produkt kapaciteti i rezervuar si pjesë e një Testi të tregut,

dhe në secilin rast përfshin një kapacitet të rezervuar i cili ka qene rezultat i një delegimi.

Deklarata vjetore nënkupton çdo deklaratë master që i dërgohet palëve të regjistruara në mars të çdo viti gazi.

Njoftim ankimimi nënkupton një ankimim përkundrejt gjetjeve të përmendura në njoftimin e referimit.

Dokumentet e aplikimit kanë kuptimin që i është dhënë atyre në nenin 3.1 (b).

Agjensi e miratuar e vlerësimit të kreditit nënkupton një agjenci e vlerësimit të kreditit që është e përfshirë në një listë, e botuar në faqen e internetit të transportuesit dhe e përditësuar herë pas here, e agjencive të vlerësimit të kreditit që janë, sipas vullnetit të vetëm të transportuesit, të pranueshëm për transportuesin për qëllimet e caktimit të një limiti krediti për palët e regjistruara.

Kapaciteti i deleguar do të thotë çdo kapacitet i rezervuar (ose një pjesë e tij) që i nënshtrohet një delegimi.

Delegim nënkupton kalimin nga një tregëtar/furnizues të të gjithë ose një pjesë të kapacitetit të tij të rezervuar tek një palë tjetër e regjistruar, i cili kryhet me anë të një delegimi të të gjitha të drejtave të tij për atë kapacitet të rezervuar (ose të një pjesë të tij), dhe një presupozim të të gjitha detyrimeve të ndërlidhura nga ajo palë e regjistruar sipas këtij kodi të rjetit. Një delegim i një pjesë të kapacitetit të rezervuar sipas këtij kodi të rjetit mund të përbëhet nga:

- (a) një delegim i një pjesë por jo i të gjithë kapacitetit të rezervuar për çdo ditë gazi,
- (b) një delegim i të gjithë kapacitetit të rezervuar vetëm gjatë një periudhe të caktuar, ose
- (c) një kombinim i sa mësipër.

Formulari i delegimit nënkupton një formular që duhet të paraqitet nga një tregëtar/furnizues ofertues dhe një palë e regjistruar, që dëshirojnë të tregtojnë të drejtat dhe detyrimet për kapacitetin e rezervuar me anë të një delegimi, formulari i të cilit do të vihet në dispozicion nga transportuesi në faqen e tij të internetit.

Pika e ankandit nënkupton një pikë sistemi ku kapaciteti i disponueshëm u ofrohet tregëtarëve/furnizuesve përmes një ankandi.

Kapaciteti i disponueshëm nënkupton, në lidhje me; një pikë të sistemit të caktuar, në një drejtim të caktuar dhe për një periudhë të caktuar kohore, aftësinë për të transportuar gaz natyror që mund të vihet në dispozicion nga transportuesi tek palët e regjistruara për t'a blerë si produkt kapaciteti për atë periudhë sepse nuk ka qenë i prenotuar me parë si apacitet i rezervuar ose sepse është bërë i disponueshëm për rezervim si kapacitet i dorëzuar ose kapaciteti i tërhequr.

Kreditim i disponueshëm do të thotë, në lidhje me një Palë të Regjistruar, shuma në euro që përfaqëson borxhin e mëtejshëm që mund të marrë, i llogaritur në përputhje me nenin 4.4.

Përdorimi mesatar ka kuptimin që i është dhënë në nenin 13.6.

I Balancuar do të thotë, në lidhje me një tregëtar/furnizues të veçantë dhe sasi të e tij të nominuara dhe sasi të e tregtuara (ose, pas përfundimit të një procesi përputhje, sasi të e tij provizore) për një ditë të veçantë të gazit që:

- (b) në lidhje me kapacitetin në drejtimin përpara (forward):

- (i) totali i të gjitha sasive të nominuara (ose, nëse është e aplikueshme, sasi të e përkohshme) për kapacitetin në drejtimin përpara (forward) për shpërndarjen nga ai tregëtar/furnizues në pikat e hyrjes dhe sasi të e tregëtuara në total (ose, nëse është e aplikueshme, sasi të provizore) për t'u transferuar nga ai tregëtar/furnizues tek një tregëtar/furnizues tjetër në pikën virtuale të tregimit, në secilin rast në atë ditë të gazit;

është i barabartë me:

- (ii) vlerën absolute në total të të gjitha sasive të nominuara (ose, nëse është e aplikueshme, sasi të e përkohshme) për kapacitetin në drejtimin përpara (forward) për ri-dërgim tek ai Tregëtar/furnizues në pikat e daljes dhe sasi të në total të tregëtuara (ose, nëse është e aplikueshme, sasi të e përkohshme) që do të merren nga ai tregëtar/furnizues tek një tregëtar/furnizues tjetër në pikën virtuale të tregimit, në secilin rast në atë ditë të gazit; dhe

- (b) në lidhje me kapacitetin tregëtar në drejtim të kundërt (revers):

- (i) totali i të gjitha sasive të nominuara (ose, nëse është e aplikueshme, sasi të provizore) për kapacitetin tregëtar revers për shpërndarje nga ai tregëtar/furnizues në pikat e hyrjes në atë ditë të gazit;

është i barabartë me:

- (ii) vlerën absolute në total të të gjitha sasive të nominuara (ose, nëse është e aplikueshme, sasi të e përkohshme) për kapacitetin Tregëtar në drejtim të kundërt (revers) për ri-dorëzim tek atë tregëtar/furnizues në pikat e daljes në atë ditë të gazit.

Gaz balancues do të thotë gaz i kërkuar në mënyrë të arsyeshme për të arritur ekuilibrin fizik të rrjetit ose ndonjë pjesë të lokalizuar të tij.

Shërbimet e balancimit të gazit nënkupton shërbimet e vëna në dispozicion të transportuesit që i mundësojnë atij blerje ose shitje të gazit Balancues, siç kërkohet për çdo ditë të gazit, herë pas here;

Kontrata e balancimit e gazit nënkupton një kontratë për blerjen ose shitjen e gazit balancues si përshkruhet në nenin 10;

Marrëveshje kuadër e blerjes së gazit balancues nënkupton një marrëveshje kuadër për blerjen e gazit balancues për rrjetin, lëshuar si rezultat i një tenderi;

Marrëveshje kuadër e gazit balancues nënkupton ose **marrëveshjen uadër të shitjes së gazit balancues** ose **marrëveshjes kuadër të blerjes së gazit balancues** dhe "**marrëveshjet kuadër të gazit balancues**" do të thotë të dyja;

Ofruesi i gazit balancues nënkupton një anëtar kuadër ose një palë që ofron shërbime të gazit balancues për transportuesin në përputhje me një kontratë të gazit balancues, e lidhur në përputhje me nenin 10 të këtij Kodi;

Marrëveshje kuadër e shitjes së gazit balancues nënkupton një marrëveshje kornizë për shitjen e **gazit balancues** për rrjetin, lëshuar si rezultat i një tenderi;

Platforma e balancimit nënkupton platformën e tregtimit të krijuar nga transportuesi për blerjen dhe shitjen e produkteve të standardizuara afatshkurtra, ku transportuesi është një pjesëmarrës tregëtar për të gjitha veprimet tregëtare;

Kapaciteti i lidhur nënkupton një produkt kapaciteti që, kur u ofrohet palëve të regjistruara, u ofrohet si një kombinim i kapacitetit të hyrjes dhe daljes në një pikë të veçantë interkoneksioni në secilin sistem transmetimi dhe sistemit përkatës të ndërlidhur.

Ditëpune do të thotë çdo ditë (përveç ditës së shtunë, të diel ose festë publike) në të cilën bankat në Shqipëri janë përgjithësisht të hapura për biznes.

Kalibrimi ka kuptimin që i është dhënë atij në fjalorin ndërkombëtar të metrologjisë - konceptet themelore dhe të përgjithshme dhe termat shoqërues (botimi i 3-të VIM) - JCGM 200: 2012 dhe termat **kalibrojt** dhe **i kalibruar** do të kenë kuptime ekuivalente.

Kodi i rrjetit CAM nënkupton Rregulloren e BE-së (KE) 2017/459 sikurse miratuar prej Komunitetit të Energjisë.

Platforma e rezervimit të kapacitetit nënkupton platformën në internet për rezervimin dhe tregtimin e produkteve të kapaciteti që është zgjedhur nga transportuesi për t'u përdorur në secilën pikë ankandi.

Produkte kapaciteti nënkupton secilin prej produkteve për transportimin e gazit natyror në sistemin e transmetimit që ofrohen për blerje për palët e regjistruara nga transportuesi, që konsistojnë në secilin prej produkteve të ndryshme që përbëjnë kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të pandërprershëm, kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të ndërprershëm dhe kapacitetin tregëtar revers.

Kufizim i kapacitetit nënkupton ndodhjen e çdo ngjarje, përveç mirëmbajtjes së planifikuar, e cila zvogëlon aftësinë e transportuesit për të ofruar kapacitet të rezervuar në një pikë sistemi.

Njoftimi për kufizim kapaciteti nënkupton një njoftim për ndodhjen e pritshme të një kufizimi të kapacitetit që kërkon që kapaciteti i rezervuar të zvogëlohet nga transportuesi në një pikë sistemi dhe i cili specifikon:

- (a) datën dhe kohën në të cilën fillon kufizimi i kapacitetit;
- (b) datën dhe orën (e rrumbullakosur në orën më të afërt) në të cilën transportuesi pret që të përfundojë kufizimi i kapacitetit;
- (c) pika e Sistemit e prekur;
- (d) shkaku i kufizimit të kapacitetit; dhe
- (e) kapaciteti i mbetur në drejtimin përpara (forward) i pandërprershëm që transportuesi mund të vërë në dispozicion në atë pikë sistemi.

Njoftimi i përfundimit të kufizimit të kapacitetit nënkupton një njoftim që u dërgohet të gjitha palëve të regjistruara, për të informuar palët e regjistruara që kufizimi i kapacitetit që kërkonte që Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprershëm të reduktohej nga transportuesi në një pikë sistemi ka përfunduar dhe i cili specifikon:

- (a) kohën dhe datën në të cilën kapaciteti i plotë i rezervuar i çdo tregëtari/furnizuesi në atë pikë sistemi do të vihet në dispozicion të tij; dhe
- (b) çdo informacion tjetër që transportuesi beson se është i nevojshëm në lidhje me heqjen e këtij kufizimi të kapacitetit.

Llogari kolaterale në para nënkupton një llogari në monedhë euro me një institucion financiar me reputacion e cila i nënshtrohet një dorëzanie ose aranzhimi të depozitave të sigurimit të kënaqshme për transportuesin që lejon që bilanci që qëndron në kredinë e një llogarie të tillë të aplikohet në pagimin e shumave të mbetura nga pala e regjistruar përkatëse për transportuesin (dhe për asnjë qëllim tjetër). dorëzania ose aranzhimi i depozitave të sigurimit do të sigurojë që çdo interes ose tarifë që aplikohet në atë llogari do të kreditohet ose debitohet nga ajo llogari.

CET do të thotë (Central European Time) Koha e Evropës Qëndrore e cila është një orë përpara UTC.

CEST do të thotë Koha Verore e Evropës Qëndrore e cila është një orë përpara CET dhe dy orë përpara UTC.

Drejtim i rrjedhës në drejtim të kundërt (commercial reverse) nënkupton, në lidhje me çdo pikë interkoneksioni, drejtimin e rrjedhës të gazit natyror që është e kundërt me drejtimin përpara (forward) dhe është drejtimi në të cilin transportuesi synon të sigurojë shërbime

transporti të rrjedhës në drejtim të kundërt (revers) virtuale (por jo fizike) në pika të caktuara të interkoneksionit.

Kapaciteti tregëtar në drejtim të kundërt nënkupton kapacitetin transportues në sistemin e transmetimit për transportin e rrjedhës tregëtare në drejtim të kundërt (revers) të gazit natyror që u vihet në dispozicion tregëtarëve/furnizuesve sipas këtij kodi të rrjetit në një pikë të veçantë interkoneksioni. kapaciteti tregëtar në drejtim të kundërt (Reverse) në një pikë të veçantë të interkoneksionit mund të jetë në drejtimin përpara (forward) ose tregëtar revers, por duhet të rezultojë në një fluks të përgjithshëm tregëtar në drejtim të kundërt (revers). kapaciteti Tregëtar revers përbëhet nga:

(a) Kapaciteti tregëtar ditor në drejtim të kundërt .

Kapaciteti tregëtar ditornë drejtim të kundërt (reverse) nënkupton kapacitetin Tregëtar në drejtim të kundërt (reverse) të disponueshëm në bazë të ditës në avancë.

Fluksi tregëtar në drejtim të kundërt (revers) nënkupton fluksin virtual (por jo fizik) të gazit natyror në sistemin e transmetimit në drejtim të kundërt me fluksin në drejtimin përpara (forward).

Stacioni i kompresorit nënkupton një strukturë që është pjesë e sistemit të transmetimit që ka si qëllim kompensimin e gazit natyror në sistemin e transmetimit për të ndihmuar rrjedhën e këtij gazi natyror.

Sasi të konfirmuara nënkupton sasinë e gazit Natyror që duhet të dërgohet ose ridërgohet tek një tregëtar/furnizues specifik në një pikë specifike të sistemit ose në pikën virtuale të tregimit pas përfundimit të të gjitha proceseve të përputhjes të shprehura në kwh për ditën e gazit. Sasitë e konfirmuara në pikat e hyrjes do të shprehen si një numër pozitiv dhe sasitë e konfirmuara në pikat e daljes do të shprehen si numra negativë.

Njoftimi i konfirmuar i sasisë nënkupton një njoftim të dërguar nga transportuesi për secilin tregëtar/furnizues pas llogaritjes së sasive të konfirmuara që përcakton sasitë e konfirmuara të Tregëtarëve/furnizuesve në secilën pikë të sistemit.

Njoftimi i mbingarkesës ka kuptimin që i është dhënë në nenin 13.7 (a).

Regjistrimi kontraktual (timestamp-data) nënkupton kohën e saktë në të cilën një tregëtar/furnizues ka kontraktuar një produkt kapaciteti me transportuesin.

Limiti i kreditit nënkupton në lidhje me secilën palë të regjistruar, shumën në Euro që përfaqëson borxh-marrjen maksimale që mund të përballojë, i llogaritur në përputhje me nenin 4.3.

Kriteret e limitit të kreditit kanë kuptimin që i është dhënë në nenin 4.1 (b).

Kriteri i limitit të kreditit nënkupton një element individual të kriterëve të limitit të kreditit.

Përqindja e limitit të kreditit nënkupton një përqindje që duhet të publikohet herë pas here në faqen e internetit të transportuesit dhe që do të aplikohet nga transportuesi për letër kreditin e lëshuar nga një Bankë që nuk është vlerësuar me AAA në mënyrë që të përcaktojë limitin e kreditit që do të aplikohet tek pala ose personi përkatës i regjistruar (ose pjesa e limitit të kreditit që do të aplikohet tek pala ose personi përkatës i regjistruar që i atribuohet këtij kriteri të limitit të kreditit, në rastin e një pale ose personi të regjistruar që kënaq më shumë se një nga kriteret e limitit të kreditit).

Tarifa ditore e disbalancimit nënkupton, në lidhje me një tregëtar/furnizues të veçantë në një ditë të veçantë gazi, një shumë të llogaritur në përputhje me nenin 10.3.

Dita nënkupton një ditë kalendarike.

Dita në avancë do të thotë, në lidhje me një produkt kapaciteti, që kapaciteti do të vihet në dispozicion për transportimin e gazit natyror për një ditë gazi, duke qenë ajo dita e gazit që vjen menjëherë pas ditës së rezervimit të këtij produkti të kapacitetit.

Nominimi i dyanshëm nënkupton, në lidhje me nominimin e sasive të gazit natyror në një pikë të veçantë të interkoneksionit, që tregëtarët/furnizuesit në secilën anë të asaj pike të interkoneksionit paraqesin nominimet e tyre në OST-në përkatëse, në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Edig@s do të thotë standardet e mesazheve elektronike të zhvilluara nga EASEE-gas, versioni i fundit i të cilit mund të shkarkohet nga <http://www.edigas.org>.

Konsumator përfundimtar do të thotë palë të treta që kanë hyrë në një marrëveshje me një tregëtar/furnizues për të blerë dhe/ose përdorur gazin që do të tërhiqet nga sistemi i transmetimit prej atij Tregëtari/Furnizuesi në një pikë daljeje dhe termi "konsumator final" do të interpretohet në përputhje me këto rrethana.

Pikë hyrëse do të thotë:

- (a) në lidhje me kapacitetin në drejtimin përpara (forward), një pikë ndërlidhëse që specifikohet si "pika e hyrjes" në tabelën A në shtojcën 2; dhe

(b) çdo pikë tjetër ku gazi natyror mund të hyjë në Sistemin e Transmetimit.

Kalendari i ankandëve ENTSOG nënkupton kalendarin e ankandëve të publikuar nga Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Gazit.

Euro ose € nënkupton monedhën e vetme të atyre vendeve anëtare të Bashkimit Evropian që kanë miratuar ose miratojnë një monedhë të tillë si monedhën e tyre të ligjshme në përputhje me legjislacionin e Komunitetit Evropian në lidhje me Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Çmimi shtesë i gazit për disbalancimin ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10;

Pikë dalje do të thotë:

(a) në lidhje me kapaciteti në drejtimin përpara (forward), një pikë ndërlidhëse që specifikohet si një "pikë dalje" në tabelën A në shtojcën 2;

(b) në lidhje me kapacitetin tregëtar në drejtim të kundërt(revers) që specifikohet si një "pikë dalje" në tabelën B në shtojcën 2; dhe

(c) çdo pikë tjetër ku gazi natyror mund të largohet nga sistemi i transmetimit.

Rast kontraktual i mbingarkesës FDA UIOLI(firm day ahead use it or lose it) ka kuptimin që i është dhënë në nenin 13.3 (c).

Opinionimi përfundimtar i përbashkët nënkupton "opinionin e përbashkët të rregullatorëve të energjisë për aplikimin për përjashtim të TAP AG" të datës 6 qershor 2013, dhënë nga ARK në përputhje me Direktivën 2009/73 / EC.

Kapaciteti i sigurt (firm capacity) nënkupton kapacitetin për transportimin e gazit natyror në sistemin e transmetimit që transportuesi merr përsipër t'ja sigurojë një tregëtar/furnizuesi dhe që transportuesit nuk i lejohet t'a ndërpresë gjatë operacioneve normale tregëtare.

Forcë madhore nënkupton ndodhjen e një "ngjarje të forcave madhore" nën dhe siç përcaktohet në nenin 27.

Drejtimi ërpara (forward)do të thotë, në lidhje me një pikë sistemi:

(a) nënkupton një pikë hyrje për kapacitetin në drejtimin përpara (forward), rrjedhja e gazit natyror në atë pikë të sistemit nga sistemi përkatës i ndërlidhur drejt sistemit të transmetimit; dhe

(b) nënkupton një pikë daljeje për kapacitetin në drejtimin përpara (forward), rrjedhja e gazit natyror në atë pikë sistemi nga sistemi i transmetimit drejt sistemit përkatës të ndërlidhur.

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) nënkupton kapaciteti në drejtimin përpara (forward) të pandërprershëm dhe kapaciteti në drejtimin përpara (forward) të ndërprershëm.

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i ndërprerë i Ditës në Avancë nënkupton kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë që bëhet i disponueshëm në baze të ditës në avancë.

Kapacitet në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë nënkupton secilin prej kapaciteteve në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë afatgjatë dhe kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë afatshkurtër .

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë ditor nënkupton kapacitetin e pandërprerë në sistemin e transmetimit për transportin në drejtimin përpara (forward) të gazit natyror që u vihet në dispozicion regëtarëve/furnizuesve në një pikë sistemi të veçantë mbi bazën e ditës në avancë.

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerëafatgjatë nënkupton kapacitetin e pandërprerë në sistemin e transmetimit për transportin në drejtimin përpara (forward) të gazit natyror që u vihet në dispozicion tregëtarëve/furnizuesve në një pikë sistemi të veçantë në çdo ditë të gazit për një periudhë më të gjatë se një vit gazi.

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerëmuajor nënkupton kapacitetin e pandërprerë në sistemin e transmetimit për transportin në drejtimin përpara (forward) të gazit natyror që u vihet në dispozicion tregëtarëve/furnizuesve në një pikë sistemi të veçantë në çdo ditë të gazit në një muaj gazi të dhënë.

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë3-mujor nënkupton kapacitetin e pandërprershëm në sistemin e transmetimit për transportin në drejtimin përpara (forward) të gazit natyror që u vihet në dispozicion tregëtarëve/furnizuesve në një pikë sistemi të veçantë në çdo ditë të gazit në një tremujor gazi të dhënë.

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerëshëmafatshkurtër nënkupton secilën prej:

(a) kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë vjetor;

(b) kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë 3-mujor;

(c) kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë mujor; dhe

(d) kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë ditor.

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerëvjektor nënkupton kapacitetin e pandërprerëshëm në sistemin e transmetimit për transportin në drejtimin përpara (forward) të gazit natyror që u vihet në dispozicion tregëtarëve/furnizuesve në një pikë sistemi të veçantë në çdo ditë të gazit në një vit gazi të dhënë.

Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i ndërprerë nënkupton kapacitetin transportues në sistemin e transmetimit për transportin e gazit natyror që u vihet në dispozicion tregëtarëve/furnizuesve në një pikë sistemi të veçantë dhe që transportuesit i lejohet t'a ndërpresë në çdo kohë për mirëmbajtje të planifikuar, forcë madhore ose ndonjë nga arsytet e specifikuar në neni 12.5.

Anëtar kuadër nënkupton një tregëtar/furnizuesose një palë tjetër që është palë në një Marrëveshje kuadër të gazit balancues;

Gaz karburant nënkupton sasinë e gazit natyror në kWh që i nevojitet transportuesit për të siguruar shërbimet e transportit, të llogaritura në përputhje me nenin 14.

Impiant i gazit karburant nënkupton çdo stacion kompresorësh dhe terminal pritës të gazsjellësit.

Çmimi i gazit karburant do të thotë, në lidhje me një muaj gazi, të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë taksat) (në euro) të bëra nga transportuesi në lidhje me blerjen e gazit karburant të përdorur në atë muaj gazi dhe të prokuruar në përputhje me nenin 14.1 (a) pjesëtuar me sasinë e përgjithshme të gazit karburant të përdorur në atë muaj gazi për të dhënë një çmim në € / kWh.

Ditë gazi nënkupton periudhën nga:

(a) 05:00 UTC në një ditë të veçantë deri në 05:00 UTC (06:00 deri në 06:00 CET) ditën tjetër, gjatë periudhave kur ora verore nuk është aplikuar; dhe

(b) 04:00 UTC në një ditë të veçantë deri në 04:00 UTC (06:00 deri në 06:00 CEST) ditën tjetër, gjatë periudhave kur ora verore është aplikuar në Shqipëri, dhe një ditë gazi gjatë së cilës Shqipëria ndryshon në ose nga ora verore do të ketë 23 ose 25 orë (sipas rastit). Për qëllim të këtij kodi të rjetit, referenca për (i) ditën e fundit të gazit në një muaj të veçantë do të thotë dita e fundit e gazit që fillon në atë muaj dhe përfundon në 06:00 CET ose CEST (sipas rastit) në fillim të ditës së parë të muajit pasardhës dhe (ii) dita e parë e gazit në një muaj të veçantë do të thotë dita e parë e gazit që fillon brenda atij muaji në orën 06:00 CET ose CEST (sipas rastit) në ditën e parë të atij muaji.

Muaj gazi nënkupton periudhën që fillon në fillimin e ditës së parë të gazit të çdo muaji kalendarik dhe që përfundon në fund të ditës së fundit të gazit në të njëjtit muaj kalendarik, përveçse muaji i parë i gazit do të fillojë në fillim të ditës së parë të gazit në të cilin transportuesi ofron shërbime transporti për një tregëtar/furnizuesnë përputhje me kodin.

Çmimi referencë i gazit ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10

Tremujor gazi nënkupton një periudhë që fillon nga fillimi i:

- (a) ditës së parë të gazit në një vit gazi dhe që përfundon në fund të ditës së fundit të gazit në dhjetor të atij viti të gazit;
- (b) ditën e parë të gazit në janar të një viti të gazit dhe që përfundon në fund të ditës së fundit të gazit në mars të atij viti të gazit;
- (c) ditën e parë të gazit në prill të një viti të gazit dhe që përfundon në fund të ditës së fundit të gazit në qershor të atij viti të gazit; ose
- (d) ditën e parë të gazit në korrik të një viti të gazit dhe që përfundon në fund të ditës së fundit të gazit në shtator të atij viti të gazit, përveçse tremujori i parë i gazit do të fillojë në fillimin e ditës së parë të gazit në të cilin transportuesi ofron shërbime transporti për një tregëtar/furnizuesnë përputhje me këtë kod të rrjetit.

Vit gazi nënkupton një periudhë që fillon në fillimin e ditës së parë të gazit në tetor të çdo viti kalendarik dhe që përfundon në fund të ditës së fundit të gazit në shtator të vitit kalendarik pasardhës, përveçse viti i parë i gazit do të fillojë në fillimin e ditës së parë të gazit në të cilin transportuesi ofron shërbime transporti për një tregëtar/furnizuesnë përputhje me këtë kod të rrjetit.

GCV nënkupton vlerën kalorifike bruto, sasia e nxehtësisë që do të lëshohet nga djegia e plotë e një Nm³ të gazit natyror në ajër, në atë mënyrë që presioni (1.01325 bar absolut) në të cilin ndodh reaksioni të mbetet konstant, dhe të gjitha produktet e djegies të kthehen në të njëjtën temperaturë të specifikuar (25° C) me atë të reagenteve, ndërkohë që të gjitha këto produkte janë në gjendje të gaztë, përveç ujit të formuar nga djegia, i cili është kondensuar në gjendje të lëngshme në 25° C.

Autoritet qeverisës nënkupton çdo qeverisje kombëtare, vendore, rregullatore ose agjenci administrative, komision, organ ose autoritet tjetër dhe çdo gjykatë ose gjykatë qeveritare, në secilin rast, duke ushtruar në mënyrë të ligjshme juridiksion mbi këtë kod të rrjetit ose sistemin e transmetimit ose (siç është e zbatueshme në kontekst) transportuesin ose një palë të regjistruar.

Marrja e borxhit ka kuptimin që i është dhënë në nenin 4.5.

Marrja e informacioni ka kuptimin që i është dhënë në nenin 13.8 (h).

Data efektive fillestare nënkupton [*shëno datën në të cilën Kodi i Rrjetit hyn në fuqi pas publikimit*] duke qenë data kur kodi i rrjetit ka hyrë në fuqi.

Sistem i ndërlidhur nënkupton një sistem transporti i gazit natyror që lidhet drejtpërdrejt me sistemin e transmetimit.

Marrëveshje e interkoneksionit nënkupton një marrëveshje midis transportuesit dhe një OST-je fqinje që lidhet me menaxhimin dhe koordinimin e transportit të gazit Natyror midis sistemit përkatës të ndërlidhur dhe sistemit të transmetimit.

Pikë interkoneksioni nënkupton një pikë të ndërlidhjes fizike midis sistemit të transmetimit dhe një sistemi të ndërlidhur siç përcaktohet në shtojcën 2.

Ndërprerje nënkupton një ndërprerje të përdorimit të kapacitetit tregëtar në drejtim të kundërt (revers) të një tregëtari/furnizuesi, në përputhje me nenin 12.4 (a) ose kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë në përputhje me nenin 12.5 (a).

Njoftim ndërprerje nënkupton një njoftim që u dërgohet të gjithë tregëtarëve/furnizuesve të prekur, për t'i informuar ata mbi ndërprerjen e Kapacitetit në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë sipas nenit 12.5 ose një ndërprerje të kapacitetit tregëtar në drejtim të kundërt (reverse), sipas nenin 12.4, i cili, në secilin rast, specifikon:

- (a) datën dhe kohën në të cilën fillon ndërprerja;
- (b) datën dhe orën (rrumbullakosur në orën më të afërt) në të cilën transportuesi pret që ndërprerja të përfundojë;
- (c) shkaku i ndërprerjes;
- (d) nëse ndërprerja ndikon në kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të ndërprerëose kapacitetin tregëtar në drejtim të kundërt (revers); dhe
- (e) kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë që mbetet ose kapacitetin tregëtar ditore në drejtim të kundërt (revers) (te ndarë në produktet përbërëse të kapacitetit), sipas rastit, në atë pikë sistemi.

Njoftim i përfundimit të ndërprerjes nënkupton një njoftim që u është dërguar të gjithë tregëtarëve/furnizuesve të prekur, për t'i informuar ata se ndërprerja e kapacitetit në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë ose kapacitetit tregëtar revers në një pikë sistemi ka përfunduar dhe që specifikon kohën dhe datën në të cilën kapaciteti i

plotë i rezervuar i çdo tregëtari/furnizuesi në atë pikë sistemi do të t'i vihet në dispozicion të atij.

kWh do të thotë kilovat-orë.

Ligj nënkupton çdo kushtetutë kombëtare, vendore ose Europiane, kartë, akt, statut, ligj, rregullore, kodi, rregull, rregullore ose urdhër, ose ndonjë veprim tjetër legjislativ ose administrativ të zbatueshëm të një autoriteti qeveritar ose një dekret, vendim gjykate ose urdhër të formës së prerë.

Humbje lokale nënkupton humbje të paqëllimshme të gazit natyror nga sistemi i transmetimit (përveç atyre humbjeve të gazit natyror që vijnë nga ngjarje të forcave madhore ose nga kryerja e mirëmbajtjes së planifikuar ose mirëmbajtjes së paplanifikuar në lidhje me sistemin e transmetimit).

LT UIOLI, “përdore ose humbe” afatgjatë, nënkupton procesin me të cilin transportuesi tërheq sistematikisht plotësisht ose pjesërisht kapacitetin e nën-shfrytëzuar në Sistemin e Transmetimit nga një tregëtar/furnizues LT UIOLI në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 13.6.

Produkt kapaciteti LT UIOLI nënkupton secilin nga kapacitetet në drejtimin përpara (forward) të pandërprershme vjetore dhe kapacitetet në drejtimin përpara (forward) të pandërprershme afatgjata.

Rast kontraktual i mbingarkesës LT UIOLI ka kuptimin që i është dhënë në nenin 13.6 (e).

Tregëtar/furnizues LT UIOLI ka kuptimin që i është dhënë në nenin 13.8 (a).

Njoftim mirëmbajtje nënkupton një njoftim të dërguar nga transportuesi për të gjitha palët e regjistruara, duke detajuar kalendarin e mirëmbajtjes së planifikuar që transportuesi synon të kryejë në një vit të veçantë të gazit, dhe i cili përfshin informacionin e përcaktuar në nenin 11.1 (c).

Test i Tregut nënkupton një procedurë të kryer nga transportuesi, në përputhje me nenin 6.10, për të vlerësuar nëse ka interes midis pjesëmarrësve të tregut për produkte kapaciteti që do t'i kërkonin transportuesit të sigurojë zgjerim kapaciteti.

Deklaratë kryesore (bazë) nënkupton deklaratën që do t'i dërgohet palëve të regjistruara çdo muaj gazi në përputhje me nenin 19.

Proçesi i përputhjes do të thotë:

- (a) në lidhje me, proceset e përputhjes dhe të konfirmimit që do të kryhen midis transportuesit dhe një OST-je fqinje, në të cilat çdo sasi e përkohshme e tregëtarëve/furnizuesve në atë pikë interkoneksioni llogaritet nga sasi të e nominuara dhe sasi të e nominuara tek OST-ja fqinje dhe;
- (b) në lidhje me çdo pikë tjetër sistemi, proceset e përputhjes dhe të konfirmimit që duhet të kryhen nga transportuesi në të cilat çdo sasi e përkohshme e tregëtarëve/furnizuesve në atë pikë sistemi llogaritet nga sasi të e nominuara dhe sasi të e nominuara tek OST-ja e fqinje; dhe
- (c) në lidhje me pikën virtuale të tregtimit, proceset e përputhjes dhe të konfirmimit që duhet të kryhen nga transportuesi në të cilat çdo sasi e përkohshme e tregëtarëve/furnizuesve në pikën virtuale të tregtimit llogaritet nga sasi të e tregtuara të njoftuara nga secili tregëtar/furnizues palën përkatëse të tregëtarëve/furnizuesve.

Të dhënat e matjes do të thotë sasi të e matura [dhe të dhënat e tjera të mblledhura nga pajisjet matëse, përfshirë analizat dhe rezultatet e kromatografisë].

Pajisja matëse nënkupton pajisjet që kërkohet të instalohen në lidhje me secilën pikë sistemi dhe struktura të tjera që përbëjnë sistemin e transmetimit në mënyrë që të identifikojnë sasi të e matura dhe cilësinë e gazit natyror në secilën vendndodhje përkatëse për qëllimet e këtij kodi të rrjetit.

Specifikimet teknike të pajisjeve matëse do të thotë, në lidhje me një zë të pajisjeve matëse, specifikimet teknike për instalimin dhe funksionimin e atij zëri të pajisjeve matëse që janë zhvilluar nga transportuesi që vepron si operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm në përputhje me ligjin në fuqi dhe rekomandimet teknike të prodhuesit të atë zë.

Sasi të e matura nënkupton sasinë e gazit natyror në kWh të matur gjatë një periudhe kohe të caktuar në një pikë sistemi ose në një stacion kompresori, siç përcaktohet nga pajisjet matëse në atë pikë sistemi ose atë stacion kompresori.

Kufiri minimal i kreditimit nënkupton kufirin minimal të kreditimit në euro të publikuar herë pas here në faqen e internetit të transportuesit.

Përqindja minimale e kreditimit nënkupton përqindjen minimal të kreditimit, të publikuar herë pas here në faqen e internetit të transportuesit, nga një agjenci e miratuar e vlerësimit të kreditimit, e cila është, sipas gjykimit të vetëm të transportuesit, e pranueshme për transportuesin për qëllimet e caktimit të një kufiri të kredisë për palët e regjistruara.

Debiti minimal nënkupton sasinë minimale të gazit natyror që kërkohet në një pikë të veçantë interkoneksioni, në mënyrë që transportuesi të sigurojë shërbimet e transportit në atë pikë interkoneksioni, në përputhje me kufizimet teknike të zbatueshme të sistemit të transmetimit dhe sistemit të ndërlidhur.

Volumi hyrës minimal, kur është përdorur në çdo marrëveshje të transportit të gazit, e lidhur përpara datës efektive fillestare, do të thotë debiti minimal.

Periudhë monitorimi nënkupton çdo periudhë përgjatë të cilës transportuesi do të monitorojë nëse LT UIOLI duhet të aplikohet për ndonjë tregëtar/furnizues, e cila duhet të jetë një viti i plotë gazi.

Tarifë mujore do të thotë, në lidhje me një tregëtar/furnizues dhe kapacitet të rezervuar të dhënë, "pagesa mujore" për atë kapacitet të rezervuar në përputhje dhe sikurse përcaktohet në tarifën e publikuar në faqen e internetit të transportuesit.

Deklaratë mujore do të thotë, në lidhje me një tregëtar/furnizues të veçantë, "deklarata mujore" që duhet t'i dorëzohet atij tregëtari/furnizuesi nga ana e transportuesit në përputhje dhe sikurse përcaktohet në tarifën e publikuar në faqen e internetit të transportuesit.

Gaz natyror nënkupton çdo hidrokarbur ose përzierje hidrokarburesh dhe gazesh jo të djegshme, që përbëhen kryesisht nga metani, të cilat janë kryesisht në gjendje të gaztë.

Kodi i Rrjetit nënkupton këtë dokument (përfshirë shtojcat e tij), sikurse mund të rishikohet herë pas here në përputhje me neni 22.

Llogari neutraliteti ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10.7.

Vlera e pagesës së neutralitetit ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10.8.

Nm³ nënkupton një metër kub normal, që është një metër kub gaz në kushte standarte referimi prej 0°C dhe 1.01325 bar absolut.

Sasi të nominuara nënkupton sasinë në total të gazit natyror në kWh për ditë gazi që është nominuar ose konsiderohet të jetë nominuar nga një tregëtar/furnizues ose:

- (a) për dorëzim nga ai tregëtar/furnizues tek transportuesi në një pikë hyrjeje; ose
- (b) për ridorëzim nga transportuesi në një pikë daljeje,

në secilin rast në lidhje me një palë të caktuar tregëtarësh/furnizuesish dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë kod të rrjetit.

sasitë e nominuara në pikat e hyrjes do të shprehen si një numër pozitiv dhe sasitë e nominuara në pikat e daljes do të shprehen si numra negativë.

nominim nënkupton njoftimin paraprak nga një tregëtar/furnizues për transportuesin për sasitë e tij të nominuara.

Rregullator do të thotë autoriteti shqiptar rregullator i energjisë i përcaktuar si një autoritet rregullator kombëtar sipas direktivës EC 2009/73 ose çdo pasardhës ose ligj i barabartë.

Vendim rregullator ka kuptimin që i është dhënë në nenin 13.8 (i).

tregëtar/furnizues ofertues nënkupton një tregëtar/furnizues që ka ofruar kapacitet të rezervuar për shitje tek një palë tjetër e regjistruar.

Marrëveshje operacionale balancimi nënkupton një marrëveshje ndërmjet transportuesit dhe një OST-je fqinje (e cila mund të dokumentohet në një marrëveshje interkoneksioni) në lidhje me trajtimin e diferencës midis sasive të matura dhe sasive të konfirmuara në një pikë të veçantë interkoneksioni në mënyrë që sasitë e alokuara në atë pikë të interkoneksionit të jenë, sa më shumë të jetë e mundur dhe duke iu nënshtruar kushteve të asaj marrëveshjeje operacionale të balancimit, të barabarta me sasitë e konfirmuara.

Çift tregëtarësh/furnizuesish nënkupton një palë tregëtarësh/furnizuesish (të cilët, për shmangien e dyshimit, mund të jenë i njëjti tregëtar/furnizues) që transferojnë titullin mbi gazin natyror në pikën virtuale të tregtimit ose në një pikë interkoneksioni.

Person nënkupton çdo individ, partneritet, korporatë, shoqatë, trust, autoritet qeveritar, ose person tjetër juridik.

Mirëmbajtje nënkupton çdo mirëmbajtje të sistemit të transmetimit, të njoftuar dhe konfirmuar nga transportuesi në përputhje me nenin 11, i cili kërkon një zvogëlim të aftësisë së një tregëtari/furnizuesi për të përdorur kapacitetin e tij të rezervuar ndërkohë që është duke u kryer mirëmbajtja.

Përfitues i mundshëm ka kuptimin që i është dhënë në nenin 7.1.

Sasi provizore nënkupton sasinë e gazit natyror në një pikë të veçantë të sistemit ose pikës virtuale të tregtimit që rezulton nga secili proces i përputhjes i shprehur në kwh për ditë gazi dhe i llogaritur në përputhje me nenin 9.3.

Renditja nënkupton rendin në të cilin janë dhënë kontratat e gazit balancues në lidhje me një vit të caktuar gazi në përputhje me marrëveshjet në një tender.

Garanci e klasifikuar e subjektit nënkupton një garanci (e cila mund të ketë një limit monetar të caktuar në euro), që i lëshohet transportuesit në emër të një pale të regjistruar nga një garantues i klasifikimit të subjektit në thelb në formën e përcaktuar në faqen e internetit të transportuesit ose një formë tjetër që mund të pranohet nga transportuesi.

Muaj kufizues (arpion¹) nënkupton një muaj në të cilin një Sasia e Alokuar e Gazit nga një tregëtar/furnizues tejkalon kapacitetin e rezervuar paraprak në atë pikë sistemi.

Tarifë kufizuese (arpion) nënkupton një tarifë të pagueshme në përputhje me nenin 6.11.

Kapaciteti kufizues (arpion) kakuftimin që i është dhënë në nenin 6.11.

Garantues i klasifikimit të subjektit nënkupton një institucion financiar ndërkombëtar ose një filial ose një entitet tjetër i lidhur i palës së regjistruar në emër të të cilit ofrohet garancia e klasifikimit të subjektit, në secilin rast që ka një klasifikim të kreditimit nga një agjenci e miratuar e klasifikimit të kreditimit që është e barabartë ose më e madhe se kufiri minimal i kreditimit.

Operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm nënkupton një person që ushtron shkallën e aftësisë, vigjilencës, maturisë dhe largpamësisë që pritet në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një person i aftë dhe me përvojë që respekton të gjithë ligjin në fuqi dhe i angazhuar në të njëjtën lloj ndërmarrjeje sikurse ai person në të njëjtat rrethana të njëjta ose të ngjashme.

Përpjekje të arsyeshme do të thotë, për çdo veprim që kërkohet të merret nga një person, përpjekjet që një operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm do të bënte për të ndërmarrë atë veprim, duke marrë parasysh kushtet që ndikojnë në atë veprim, me kusht që atij personi të mos i kërkohet të shpenzojë fonde për të të ndërmarrë atë veprim që janë më shumë sesa shuma që ai përcakton të jetë e përshtatshme, në diskrecionin e tij të vetëm.

Periudha e rishpërndarjes nënkupton çdo periudhë prej dymbëdhjetë muajsh gazi që fillon me ditën e parë të gazit në janar dhe përfundon në fund të ditës së fundit të gazit në dhjetor në çdo vit kalendarik, përveçse periudha e parë e rishpërndarjes do të fillojë në fillimin e ditës së parë të gazit në të cilën transportuesi ofron shërbime transporti për një tregëtar/furnizues në përputhje me këtë kod të rrjetit.

Njoftim referimi ka kuptimin që i është dhënë në nenin 13.8 (a).

¹Mekanizem që nuk lejon kthimin mbrapsht në një sistem ingranazhesh

Regjistër nënkupton bazën e të dhënave të të gjitha palëve të regjistruara që mbahen dhe menaxhohen nga transportuesi.

Konfirmim regjistrimi ka kuptimin e dhënë në nenin 3.1 (f).

Tarifë regjistrimi nënkupton tarifën e regjistrimit që paguhet në shumën dhe në mënyrën e përcaktuar herë pas here në faqen e internetit të transportuesit.

Formular regjistrimi nënkupton formularin e aplikimit që një person duhet të paraqesë, së bashku me dokumentet e tjera të përmendura në nenin 3.1 (b), në mënyrë që të aplikojë për t'u bërë një palë e regjistruar, forma e së cilit është paraqitur në shtojcën 3 (formulari i regjistrimit) dhe mund, herë pas here, të përditësohet nga transportuesi duke publikuar një formë të rishikuar në faqen e tij të internetit.

Palë e regjistruar nënkupton çdo person që ka përmbushur kushtet për t'u bërë një palë e regjistruar e specifikuar në nenin 3.1 dhe ka marrë konfirmim nga transportuesi për statusin e tij si palë e regjistruar.

Rinominimi nënkupton një nominim të dorëzuar nga një tregëtar/furnizues për një ditë të caktuar gazi pas afatit për konfirmimin e nominimit fillestar për atë ditë gazi.

Kufizimi i rinominimit nënkupton kufizimet se rinominimet e një tregëtari/furnizuesi ose njoftimet e përditësuara të tregtisë nuk mund të jenë më të mëdha se një sasi e llogaritur në përputhje me Nenin 8.8 (c) ose më pak se një sasi e llogaritur në përputhje me nenin 8.8 (d).

Kapacitet i rezervuar do të thotë, në lidhje me një tregëtarfurnizues, kapacitetin maksimal (shprehur në kwh për ditë gazi) në një pikë sistemi të specifikuar që i kërkohet Transportuesit të vërë në dispozicion të këtij tregëtari/furnizuesi për transportimin e gazit gatoryr, në përputhje me këtë kod të rrjetit. Kapaciteti i rezervuar i një tregëtari/furnizuesi kur aplikohet në një ditë caktuar të gazit prej 23 ose 25 orësh ai do të jetë i barabartë me kapacitetin e tij të rezervuar pjestuar me 24 dhe shumëzuar me 23 ose 25 (sipas rastit).

Çmimi rezervë nënkupton çmimin fillestar për ankandin e çdo produkti të kapacitetit, i cili do të jetë çmimi rezervë, përveç nëse ankandi është për kapacitet me volum, rast në të cilin do të jetë totali i çmimit rezervë dhe çmimi rezervë për produktin e kapacitetit respektiv të ofruar nga OST-ja fqinje në përputhje me rregullat tarifore të asaj OST-je fqinje.

Periudha e marrjes së të ardhurave nënkupton çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon një muaj më vonë se fillimi i periudhës së rishpërndarjes dhe që përfundon një muaj më vonë se fundi i kësaj periudhe rishpërndarjeje.

Revers (drejtim i kundërt) do të thotë, në lidhje me një pikë sistemi:

- a) Që është një pikë hyrjeje për kapacitetin në drejtim të kundërt (revers), rrjedhja e gazit natyror në atë pikë të sistemit prej sistemit të transmetimit drejt sistemit përkatës të ndërlidhur; dhe
- b) Që është një pikë daljeje për kapacitetin në drejtim të kundërt (revers), fluksi i gazit natyror në atë pikë sistemi prej sistemit përkatës të ndërlidhur drejt sistemit të transmetimit.

Modifikim nënkupton procedurën me të cilën kodi i rrjetit është ndryshuar në përputhje me nenin 22.

Kërkesë për Modifikim nënkupton një propozim për ndryshimin e kodit të rrjetit që i është dërguar transportuesit për vlerësim, në përputhje me nenin 22.

Propozim për Modifikim nënkupton një propozim me shkrim të përgatitur nga transportuesi për konsultim publik, duke rekomanduar një amendim në kodin e rrjetit, në përputhje me nenin 22.

Tarifë skedulimi ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10 dhe tarifatat e skedulimit do të interpretohen në përputhje me rrethanat;

Diferenca e skedulimit ose SD ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10;

Përqindja e tolerancës së skedulimit ose STP ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10;

Sasia e tolerancës së skedulimit ose STQ ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10;

Treg sekondar ka kuptimin që i është dhënë në nenin 7.1 (a).

Periudha 6-mujore nënkupton, në lidhje me një periudhë monitorimi, secilën prej; (a) periudha nga 1 tetori deri në 31 mars dhe (b) periudha nga 1 prilli deri më 30 shtator, në atë periudhë monitorimi.

Skeduli GTC 5 nënkupton skedulimin GTC 5 të termave dhe kushteve të përgjithshme, i cili përcakton, mes të tjerash, llogaritjen e tarifave të zbatueshme për produktet e kapacitetit, të aprovuar nga ARK.

Tregëtar/furnizues nënkupton çdo palë të regjistruar që ka blerë një ose më shumë produkte kapaciteti.

Kodi i llogarisë së tregëtarëve/furnizuesve nënkupton përfaqësimin me anë të një kodi të përcaktuar nga një OST për të identifikuar llogarinë specifike të një tregëtari/furnizuesi me atë OST.

Çmimi i gazit të disbalancimit prej mungesës ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10;

Çmimi i mungesës ka kuptimin që i është dhënë në nenin 12.14

Produkt i standardizuar afatshkurtër nënkupton produkte siç janë përcaktuar në nenin 7 të rregullores së komisionit (BE) nr 312/2014 dhe tregtohen në platformën e balancimit.

Forumi i palëve të interesuara nënkupton forumin e krijuar nga transportuesi në përputhje me nenin 22.7.

Deklarata nënkupton një deklaratë kryesore (përmbledhëse) master ose një deklaratë mujore.

Personi dorëzues ka kuptimin që i është dhënë në nenin 22.3 (a).

Dorëzim nënkupton lëshimin nga një tregëtar/furnizuesi të gjithë ose një pjese të kapacitetit të tij në drejtimin përpara (forward) të pandërprershëm (përveç kapacitetit tregëtar ditor në drejtim të kundërt (revers) ose kapacitetit tregëtar në drejtim të kundërt (revers) (përveç kapacitetit tregëtar revers ditor) në një pikë sistemi në mënyrë që transportuesi të mund të ofrojë një kapacitet të tillë të rezervuar si kapacitet të disponueshëm në ankande dhe **dorëzimi** do të ketë një kuptim ekuivalent.

Kapacitet i dorëzuar nënkupton çdo kapacitet të rezervuar që është objekt i një kërkesë për dorëzim.

Kërkesë për dorëzim nënkupton një kërkesë nga një tregëtar/furnizues për transportuesin për dorëzimin e të gjithë ose një pjese të kapacitetit përcjellës të i pandërprershëm të **tregëtarëve/furnizuesve** (përveç kapacitetit tregëtar revers ditor) ose Kapacitetit Tregëtar Revers (përveç kapacitetit tregëtar revers ditor).

Pikë sistemi nënkupton një pikë ndërlidhëse, pikë hyrje ose pikë Dalje.

Platforma elektronike e të dhënave nënkupton aplikacionin në internet të vënë në dispozicion nga transportuesi për të gjitha palët e regjistruara.

Çmimi rezervë nënkupton çmimin fillestar për ankandet e çdo produkti kapaciteti në sistemin e transmetimit i cili përcaktohet në përputhje me skedulën GTC 5.

Tarifë nënkupton tarifën e zbatueshme për produktet e kapacitetit, të llogaritura në përputhje me skedulën GTC5 (dhe përfshin çdo çmim ankandi).

Taksë nënkupton çdo taksë, tarifë, pagesë, detyrim, ose vlerësim tjetër të vendosur nga çdo autoritet qeveritar, qëndror ose vendor, duke përfshirë të gjitha të ardhurat, mbajtjen në burim, fitimet e rastësishme, arkëtimet bruto, biznesin, taksën mjedisore, vlerën e shtuar, fitimin

kapital, taksat doganore, aksionet e kapitalit, regjistrimi, akciza, *ad valorem*, prona e paluajtshme, prona personale, toka, zhvillimi vendor, licenca, shitjet, prodhimi, profesioni, përdorimi, shërbimi, përdorimi i shërbimit, transferimi, lista e pagave, punësimi, sigurimi shoqëror (ose të ngjashme), papunësia, udhëtimi, ekskluziviteti, shkëputja, shpërblimi, ose ndonjë taksë tjetër e çfarëdo lloji, si dhe çdo tarifë dhe vlerësim (përfshirë çdo interes, gjobë ose shtesa në taksë për shkak të ose të i Pandërprershëm ose lidhur me ndonjë vlerësim, qoftë të kontestuara ose jo, por duke përjashtuar çdo honorar, honorare shtesë dhe tarifa të ngjashme), dhe të gjitha taksat dhe tarifat e pullave ose dokumentave.

Tender do të thotë një procedurë vjetore tenderimi e kryer nga transportuesi për të prokuruar shërbime balancimi.

Tregtim nënkupton një transferim të gazit natyror ndërmjet tregëtarëve/furnizuesve në pikën virtuale të tregimit.

Tarifa totale e skedulimit ka kuptimin që i është dhënë në nenin 10;

Disbalanca totale e transmetimit nënkupton shumatoren e të gjitha shifrave individuale të zbalancimit të transmetimit.

Njoftim tregtimi nënkupton njoftimin paraprak nga një tregëtar/furnizues për transportuesin e mbi sasi të tij të tregtuara.

Sasi të tregtuara nënkupton sasinë e përgjithshme të gazit natyror në kWh për ditë gazi që është nominuar nga një tregëtar/furnizues:

- (a) për transferimin nga ai tek një tregëtar/furnizues tjetër në pikën virtuale të tregimit; ose
- (b) për transferimin tek ai prej një tregëtarifurnizuesi tjetër në pikën virtuale të tregimit në secilin rast në lidhje me një palë të caktuar Tregëtarësh/Furnizuesish dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë kod të rrjetit.

Transferim nënkupton një marrëveshje ndërmjet një tregëtari/furnizuesi dhe një palë të regjistruar sipas të cilit tregëtari/furnizuesi i lejon palës së regjistruar përdorimin e një pjesë ose të gjithë Kapacitetit të rezervuar të tregëtarëve/furnizuesve dhe në zbatim të të cilës:

- (a) pala e regjistruar është në gjendje të paraqesë nominimet në vend të tregëtarëve/furnizuesve në lidhje me kapacitetin e rezervuar që i nënshtrohet transferimit në përputhje me këtë kod të rrjetit; dhe
- (b) të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera të tregëtarëve/furnizuesve dhe të transportuesit kundrejt njëri-tjetrit për sa i përket këtij kapaciteti të rezervuar nuk ndikohen. Një transferim është referuar gjithashtu si një "nën-qiradhënie" në termat dhe kushtet e

përgjithshme të marrëveshjeve të transportit të gazit, të lidhura përpara datës efektive fillestare.

Kapacitet i transferuar do të thotë çdo kapacitet i rezervuar (ose një pjesë e tij) që i nënshtrohet një transferimi.

Sistem transmetimi nënkupton sistemin e tubacionit të gazit natyror, duke përfshirë tubacionet mbi dhe nën tokë dhe të gjithë pajisjet e tjera të lidhura në pronësi, përdorim dhe të operuara, nga Transportuesi në mënyrë që të ofrojë shërbimet e transportit në përputhje me këtë kod të rrjetit.

Transportues do të thotë Albgaz sh.a.

Vendim përfundimtar i transportuesit ka kuptimin që i është dhënë në nenin 22.5 (a).

Disbalancim i transmetimit do të thotë, në lidhje me një tregëtar/furnizues të veçantë në një ditë të veçantë gazi:

- (a) në lidhje me kapaciteti në drejtimin përpara (Forward), një sasi të llogaritur në përputhje me nenin 10.1; dhe
- (b) në lidhje me Kapacitetin tregëtar në drejtim të kundërt (revers), një sasi të llogaritur në përputhje me nenin 10.2.

Shërbime transporti nënkupton shërbimet e transportit të gazit natyror që do të ofrohen nga transportuesi për një tregëtar/furnizues sipas këtij kodi të rrjetit.

OST nënkupton çdo operator të një sistemi të transmetimit të gazit, përfshirë transportuesin.

UFG (unaccounted for gas) do të thotë gaz i pallogaritur, që është sasia pozitive ose negative e gazit natyror në kwh që rezulton nga humbjet lokale dhe pasaktësitë në pajisjet matëse, të llogaritura në përputhje me nenin 16.3.

Kosto UFG për kwh nënkupton, në lidhje me një muaj gazi, të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë taksat pro duke përjashtuara çmimin e ufg për kwh) (në euro) që bën transportuesi në lidhje me blerjen ose shitjen e ufg-së të llogaritur në lidhje me atë muaj gazi në përputhje me nenin 16.1 (a) pjesëtuar me sasinë totale të UFG-së të llogaritur në lidhje me atë muaj gazi për të dhënë një kosto në € / kWh.

Çmimi UFG për kWh nënkupton, në lidhje me një muaj gazi, shumën në total që paguhet ose merret nga transportuesi në lidhje me blerjen ose shitjen e ufg-së e llogaritur në lidhje me atë muaj gazi në përputhje me nenin 16.1 (a) pjesëtuar me sasinë totale të UFG-së së llogaritur në lidhje me atë muaj gazi për të dhënë një kosto në € / kWh.

Mirëmbajtje e paplanifikuar nënkupton çdo mirëmbajtje të sistemit të transmetimit të realizuar nga transportuesi, përveç mirëmbajtjes së planifikuar, e cila kërkon vendosjen e kufizimeve në përdorimin e kapacitetit të rezervuar ndërkohë që mirëmbajtja është duke u kryer.

Njoftim tregtie i përditësuar nënkupton një njoftim tregtie të paraqitur nga një tregëtarfurnizues për një ditë të veçantë gazi pas afatit për dorëzimin e njoftimit fillestar të tregtisë për atë ditë gazi.

UTC nënkupton koha universale e koordinuar, siç përcaktohet herë pas here nga agjencia e unionit ndërkombëtar të telekomunikacionit të kombeve të bashkuara.

Vlefshmëri ka kuptimin që i është dhënë në fjalorin ndërkombëtar të metrologjisë - konceptet themelore dhe të përgjithshme dhe termat e asociuar (botimi i 3-të VIM) - JCGM 200: 2012 dhe termat vërtetohet dhe i vërtetuar do të kenë kuptime ekuivalente.

Verifikim ka kuptimin që i është dhënë në fjalorin ndërkombëtar të metrologjisë - konceptet themelore dhe të përgjithshme dhe termat e shoqërues (botimi i 3-të VIM) - JCGM 200: 2012 dhe termat verifikohet dhe i verifikuar do të kenë kuptime ekuivalente.

Pikë virtuale tregtimi nënkupton një vëndndodhje nacionale në të cilën tregëtarët/furnizuesit mund të regjistrojnë tregtinë e gazit natyror.

Kapaciteti virtual i ndërprerë në drejtim të kundërt (revers) do të thotë kapaciteti transportues në sistemin e transmetimit për transportin në drejtim të kundërt të gazit natyror që u vihet në dispozicion tregëtarëve/furnizuesve sipas këtij kodi të rrjetit në pikën e interkoneksionit Fier dhe që transportuesit i lejohet ta ndërpresë në çdo kohë për mirëmbajtje të planifikuar, forcë madhore ose ndonjë prej tyre arsyeve të specifikuara në nenin 12.5.

Kapacitet i tërhequr do të thotë kapacitet i rezervuar që është tërhequr nga transportuesi në përputhje me procedurat e LT UIOLI të specifikuar në nenin 13.6.

2.2. Skemat emërtuese

(a) Variablat dhe parametrat e përdorur në këtë dokument emërtohen sipas skemave të mëposhtme, përveç kur tregohet ndryshe:

(i) indekset për funksionin e *shumës* (psh. Σ), funksionet *max* dhe *min*:treguesi

(A) d = shuma e vlerave të çdo orë në ditën e gazit d

(B) m = shuma e vlerave të çdo ditëgazi në muajin e gazit m

- (ii) treguesi: h = për orë; d = ditor; m = mujor; y = vjetor; s = tregëtarfurnizues
 - (iii) parashtesa: E = pika e hyrjes; X = pika e daljes
 - (iv) çmim shtesë(suffix prime) (') = mujor (alokim); asnjë kuotë nuk do të thotë (alokim) provizor
- (b) Në këtë kod të rrjetit:
- (i) fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, përveç rastit kur konteksti e kërkon ndryshe;
 - (ii) fjalët që tregojnë individë ose persona përfshijnë të gjitha llojet e personave, përveç rastit kur konteksti e kërkon ndryshe;
 - (iii) fjalët që tregojnë njëjërën gjini përfshijnë të gjitha gjinitë, përveç rastit kur konteksti e kërkon ndryshe;
 - (iv) titujt janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në interpretim dhe nuk kanë asnjë efekt juridik;
 - (v) referenca për paragrafë, nene dhe shtojca do të thotë paragrafë të, neneve dhe shtojcave të këtij kodi të rrjetit
 - (vi) referencat në këtë kod të rrjetit përfshijnë çdo Modifikim të këtij Kodi të Rrjetit, në përputhje me Nenin 22;
 - (vii) referenca për ndonjë marrëveshje tjetër ose për ndonjë ligj, statut, rregull, ose rregullore do të thotë e njëjta me ndryshimin, modifikimin, ose zëvendësimin herë pas here;
 - (viii) referencat për një palë ose ndonjë person përfshijnë pasardhësit e saj dhe të deleguarve të lejuar;
 - (ix) fjalët "përfshijnë" dhe "përfshirë" konsiderohen të kualifikuara nga një referencë për "pa kufizim";
 - (x) një reduktim i një sasive të nominuar, sasive të konfirmuar ose sasive të alokuar do të nënkuptojë një reduktim të vlerës absolute të një sasive të tillë dhe në krahasimin e ndonjë sasive të tillë, sasia më e vogël do të thotë më e vogla e vlerave absolute të sasive të tilla;
 - (xi) një referencë në faqen e internetit të transportuesit nënkupton faqen e internetit të korporatës së transportuesit, e i pandërprershëm në <https://albgaz.al/>; dhe

- (xii) fjalët, frazat ose shprehjet që nuk përcaktohen në këtë kod të rrjetit, por që kanë një kuptim të pranuar përgjithësisht në praktikën e matjes dhe metrimit në bizneset ndërkombëtare të prodhimit, transportit, shpërndarjes dhe shitjes së gazit natyror kanë atë kuptim.

3. PALËT E REGJISTRUARA

3.1. Aplikimi për tu bërë një palë e regjistruar

- a) Çdo person që dëshiron të bëhet një palë e regjistruar duhet të aplikojë për t'u bërë një palë e regjistruar duke paraqitur dokumentet e aplikimit tek transportuesi dhe duke paguar tarifën e regjistrimit tek transportuesi. Një person do të bëhet një palë e regjistruar vetëm pasi të marrë një konfirmim regjistrimi nga transportuesi dhe një kopje të ekzekutuar siç duhet të marrëveshjes së pranimit.
- b) Çdo person që aplikon për t'u bërë një palë e regjistruar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme në adresën e transportuesit, e cila do të përcaktohet në formularin e regjistrimit:
 - (i) një formular regjistrimi të plotësuar dhe të nënshkruar;
 - (ii) të gjitha dokumentet mbështetëse të specifikuar në formularin e regjistrimit të cilat dëshmojnë se personi plotëson një ose më shumë nga kriteret e limitit të kreditit; dhe
 - (iii) një marrëveshje pranimi të plotësuar dhe të nënshkruar, së bashku, **dokumentet e aplikimit**.
- c) Transportuesi do të njoftojë çdo person që ka paraqitur dokumentet e aplikimit mbi tërësinë ose paplotësinë e këtyre dokumenteve, jo më vonë se pesë ditë pune pas marrjes së dokumenteve nga ana e transportuesit.
- d) Nëse njoftimi i përmendur në paragrafin (c) më lart:
 - (i) përmban konfirmimin nga transportuesi se dokumentet e aplikimit janë jo të plota, atëherë kërkesa do të refuzohet, por personi përkatës mund, në çdo kohë, të plotësojë dhe ri-dorëzojë ato dokumente pa pasur nevojë të paguajë tarifën e Regjistrimit; ose
 - (ii) përmban konfirmimin nga transportuesi se dokumentet e aplikimit janë të plota, transportuesi (duke vepruar në fshehtësi të plotë) vlerëson nëse personi përkatës i ka përmbushur të gjitha kërkesat për t'u bërë një palë e regjistruar.
- e) Pas marrjes së një njoftimi mbi plotësinë e përmendur në paragrafin (c) më lart, personi përkatës duhet të sigurojë që personi i caktuar prej tij në formularin e regjistrimit për të menaxhuar komunikimet e këtij personi duke përdorur Edig@s (e cila mund të jetë një kompani shërbimesh profesionale palë e tretë) të kalojë një

provë komunikimi që do të organizohet nga transportuesi si pjesë e procesit të aplikimit.

- f) Nëse transportuesi përcakton që personi përkatës i ka përmbushur të gjitha kërkesat për t'u bërë një palë e regjistruar, transportuesi do të ekzekutojë marrëveshjen e aksesit dhe do t'i paraqesë një konfirmim me shkrim personit përkatës (konfirmimin e regjistrimit) brenda 45 ditëve punë për një njoftim të përfundimit referuar në paragrafin (c) më lart, duke thënë:
- (i) që ky personëshhtë pranuar si palë e regjistruar dhe është regjistruar në regjistër;
 - (ii) limiti i kreditit që është i zbatueshëm për atë person;
 - (iii) një kod llogarie të tregëtarëve/furnizuesve që do të përdoret nga ai person në lidhje me çdo blerje të kapacitetit të ndërprerë në drejtimin përpara ose Kapacitetit të Pa ndërprerë në drejtimin përpara (**forward interruptible capacity**); dhe
 - (iv) Kode të veçanta të llogarisë së tregëtarëve/furnizuesve për çdo itinerar në drejtim të kundërt (revers) për t'u përdorur nga ai person në lidhje me çdo blerje të kapacitetit në drejtim të kundërt (revers).

3.2. Përditësime të informacionit

- a) Secila palë e regjistruar duhet, jo më shumë se 15 ditë pune para fillimit të çdo viti gazi, t'i sigurojë një njoftim me shkrim transportuesit:
- (i) duke konfirmuar që asnjë informacion i dhënë nga ajo palë e regjistruar në dokumentet e aplikimit nuk ka ndryshuar që nga konfirmimi i fundit i dhënë nga ajo palë e regjistruar; ose
 - (ii) identifikimin e informacionit të dhënë nga ajo palë e regjistruar në dokumentet e aplikimit që ka ndryshuar.
- b) Secila palë e regjistruar, përveç detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (a) më lart, duhet t'i sigurojë një njoftim me shkrim transportuesit duke identifikuar çdo ndryshim material në informacionin e dhënë nga ajo palë e regjistruar në dokumentet e aplikimit, menjëherë pasi të marrë dijeni mbi çdo ndryshim të tillë material.
- c) Secila palë e regjistruar që njofton transportuesin për një ndryshim të ndonjë prej informacioneve të dhëna nga ajo palë e Regjistruar në dokumentet e aplikimit, duhet të paraqesë versionet e

rishikuara të dokumenteve të aplikimit që preken nga ai ndryshim brenda pesë ditëve pune të këtij njoftimi dhe duhet të bashkëpunojnë me çdo kërkesë që transportuesi mund të bëjë për informacion të mëtejshëm ose dokumentacion në lidhje me atë ndryshim.

3.3. Të drejtat dhe detyrimet e palëve të regjistruara

- a) Vetëm palët e regjistruara kanë të drejtë:
 - (i) të marrin pjesë në ankande dhe të blejnë produkte kapaciteti, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 6;
 - (ii) tregtojnë produkte kapaciteti me palët e tjera të regjistruara në përputhje me neni 7; dhe
 - (iii) aksesin në platformën elektronike të të dhënave dhe platformën e rezervimit të kapaciteteve.
- b) Secila palë e regjistruar duhet të mbajë në çdo kohë një limit të kreditit jo më pak se limiti minimal i kreditit duke përbushur vazhdimisht një ose më shumë prej kriterëve të limitit të kreditit përveç nëse ajo palë e regjistruar mban kapacitetin alternativ të mbështetjes së kreditit.
- c) Një palë e regjistruar që bëhet një tregëtarfurnizues, përveçse bëhet tregëtar/furnizues, mbetet një palë e regjistruar për qëllimet e këtij kodi të rrjetit.

3.4. Heqja nga regjistri

- a) Një palë e regjistruar që dëshiron të pushojë së qënuri një palë e regjistruar mund të njoftojë me shkrim transportuesin për qëllimin e saj për të pushuar të qënit një palë e regjistruar nëse nuk ka më ndonjë kapacitet të rezervuar. Transportuesi, jo më vonë se dhjetë ditë pune, pas marrjes së një njoftimi të tillë ose datës në të cilën janë shlyer shumat e papaguara të pagueshme nga pala e regjistruar, do ta heqë atë palë të regjistruar nga regjistri dhe do t'i konfirmojë me shkrim palës së regjistruar se nuk është më një palë e regjistruar.
- b) Në varësi të (c), transportuesi mund të heqë një palë të regjistruar nga regjistri dhe t'i konfirmojë me shkrim asaj pale të regjistruar se nuk është më palë e regjistruar nëse:
 - (i) Pala e regjistruar pushon së mbajturi një limit të kreditit prej të paktën limitit minimal të kreditit përveç nëse një person i tillë ka ndonjë kapacitet alternativ të mbështetjes së kreditit;
 - (ii) një marrëveshje pranimi ku një palë e tillë e regjistruar është një palë që duhet të ndërpritet nga transportuesi para

përfundimit të mandatit të saj dhe ajo palë e regjistruar nuk është palë në asnjë marrëveshje tjetër të transportit të gazit;

(iii) pas dorëzimit nga një palë e regjistruar e çdo dokumenti aplikimi të rishikuar, transportuesi (duke vepruar në fshehtësi të plotë) përcakton që versionet e rishikuara të atyre dokumenteve tregojnë se një palë e regjistruar nuk i plotëson më kërkesat e saj për të qenë një palë e regjistruar ashtu siç përcaktohet më sipër; ose

(iv) nëse:

A. ajo palë e regjistruar fillon vullnetarisht ndonjë procedurë ose paraqet ndonjë petition ku kërkon likuidimin, riorganizimin, shpërbërjen, prishjen, përbërjen, ose lehtësim tjetër (përfshirë çdo kërkesë që kërkon shtyrjen e një procesi të tillë ose dhënien e një moratoriumi) nën ndonjë falimentim, paaftësia paguese, marrje në dorëzim, ose ligje të ngjashme, të zbatueshme për atë palë të regjistruar ose që bie dakord për fillimin e ndonjë procedimi ose paraqitjen e ndonjë peticioni kundër saj, sipas ndonjë ligji të ngjashëm;

B. ndonjë veprim korporativ, procedurë ligjore ose ndonjë procedurë apo hap tjetër është ndërmarrë në lidhje me delegimin në dobi të kreditorëve të asaj palë të regjistruar në kontekstin e falimentimit ose ajo pranon me shkrim paaftësinë e saj për të paguar borxhet e saj përgjithësisht në momentin që ato duhet të shlyhen, pushon së paguari për shkak të borxheve të saj përgjithësisht kur ato duhet të shlyhen ose kur ato bëhet me mbi-borxhe në kuptim të ndonjë ligji në fuqi;

C. ajo palë e regjistruar miraton emërimin e një marrësi, të besuari, ose likuiduesi mbi pjesën e saj ose të ndonjë pjese të pasurive ose ndërmarrjeve të saj.

D. një person paraqet një petition që kërkon likuidimin, riorganizimin, shpërbërjen, prishjen, përbërjen ose ndonjë lehtësimin tjetër për atë palë të regjistruar ose dhënien e një moratoriumi në lidhje me atë palë të regjistruar sipas parashikimeve të çdo falimentimi, paaftësie paguese, marrje ose ligje të ngjashme, të zbatueshme për të, dhe peticioni nuk hidhet poshtë brenda 60 ditëve pas dorëzimit.

E. një gjykatë e juridiksionit kompetent nxjerr një urdhër ose dekret që cakton një marrës, likuidues, ose të

administrator të besuar për atë palë të regjistruar ose ndonjë prej pasurive të tij dhe marrësi, likuiduesi, ose administratori i besuar nuk shkarkohet brenda 60 ditëve nga data e urdhrit ose dekretit;

F. një gjykatë e juridiksionit kompetent nxjerr në një urdhër ose dekret që gjykon që pala e regjistruar të falimentohet ose pa aftësi paguese ose të japë një moratorium në lidhje me atë palë të regjistruar dhe urdhri ose dekreti të mos mbetet në fuqi ose të shkarkohet brenda 60 ditëve nga data e urdhërit ose dekretit;

G. pala e regjistruar shkakton ose i nënshtrohet ndonjë ngjarje në lidhje me të, e cila, sipas ligjeve në fuqi të çdo juridiksioni, ka efektin analog me ndonjë nga ngjarjet e specifikuara në paragrafët (A) deri (F) më lart; ose

H. ndonjë prej rrethanave të përcaktuara në nenin 20.2 (a).

- c) Kur pala e regjistruar referuar në paragrafin (b) më lart është një subjekt i licencuar, transportuesi do të ndërlidhet me rregullatorin për të përcaktuar datën e heqjes nga regjistri ose në mënyrë alternative nëse pezullimi i të drejtave sipas nenit 20 është më i përshtatshëm.
- d) Heqja e një personi nga regjistri nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e këtij personi si tregëtar/furnizues ose palë e regjistruar e përlogaritur para një heqje të tillë.
- e) Për shmangien e dyshimit, referencat për një tregëtar/furnizues që pushon së qënuri palë e këtij kodi do të nënkuptojnë gjithashtu që tregëtari/furnizuesi do të pushojë së qënuri palë në marrëveshjen kuadër dhe, nëse është e aplikueshme, marrëveshja e pranimit e tregëtarëve/furnizuesve do të përfundojë.

4. ÇËSH TJET E KREDITIT

4.1. Caktimi i një limiti krediti fillestar

- a) Transportuesi do të, në lidhje me secilin person që aplikon për t'u bërë një palë e regjistruar dhe që përmbush një ose më shumë prej kriterëve të limitit të kreditit, vendos një limit krediti për atë person në përputhje me nenin 4.3 dhe do të njoftojë atë person mbi limitin e kreditit së tij në konfirmimin e regjistrimit.
- b) Personat që aplikojnë për t'u bërë një palë e regjistruar duhet të plotësojnë një ose më shumë prej kriterëve të mëposhtme (së bashku, kriteret e limitit të kreditit) përpara se t'i caktohet një limit krediti nga transportuesi në përputhje me nenin 4.3:
 - (i) nëse statement nga banka vërteton që personi ka blerë në favor të Transportuesit;
 - (ii) nëse vërtetohet se personi ka paguar të paktën limitin minimal të kreditit tek një llogari lollaterale në cash; ose
 - (iii) ka siguruar mbështetje krediti në një formë tjetër të dakorduar nga autoriteti.

4.2. Përditësimi i limiteve të kreditit

- a) Limiti i kreditit të një pale të regjistruar mund të rivlerësohet dhe rishikohet, duke u rritur ose ulur:
 - (i) në çdo kohë, me kërkesë të asaj pale të regjistruar, nëse pala e regjistruar ka vendosur ose synon të vendosë një mbështetje të re krediti e cila plotëson një ose më shumë nga kriteret e limitit të kreditit;
 - (ii) në çdo kohë, nga transportuesi, nëse ai beson në mënyrë të arsyeshme që rivlerësimi i limitit të kreditit të caktuar aktualisht ndaj një pale të regjistruar do të rezultojë në llogaritjen e limitit të kreditit të llogaritur; dhe
 - (iii) si pjesë e një rivlerësimi vjetor të limiteve të kreditit të caktuar për të gjitha palët e regjistruara që transportuesi do të kryejë në datën 30 qershor ose para kësaj date të çdo vit gazi.
- b) Nëse limiti i kreditit i një pale të regjistruar duhet të rishikohet, siç përshkruhet në paragrafin (a) (i) më sipër:
 - (i) Pala e regjistruar që po kërkon rishikimin e limitit të saj të kreditit, duhet të njoftojë me shkrim transportuesin për këtë dhe duhet të japë detajet me shkrim tek njoftimi

mbështetjen e re të kreditit që plotëson një ose më shumë prej kritereve të limitit të kreditit që tashmë është krijuar ose që pala e regjistruar synon të krijojë;

(ii) Transportuesi, jo më vonë se dhjetë ditë pune pas marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin (i) më lart, duhet të njoftojë palën e regjistruar për:

A. në rastin e një mbështetje të re krediti që tashmë është i Pandërprershëm dhe që plotëson një ose më shumë prej kritereve të limitit të kreditit, limitin e rishikuar të kreditit që zbatohet për atë palë të regjistruar nga transportuesi; ose

B. në rastin e një mbështetje të re krediti që pala e regjistruar synon të vendosë dhe që do të plotësojë kriteret e limitit të kreditit pasi të vendoset, limiti i rishikuar i kreditit që do të zbatohet për atë palë të regjistruar nga transportuesi nëse vendoset mbështetja e re e propozuar e kreditit;

(iii) pas marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin (ii) (B) më lart, pala e regjistruar duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të realizuar mbështetjen e re të kreditit dhe pasi të jenë ndërmarrë të gjitha hapat e tillë, duhet të njoftojë transportuesin që janë ndërmarrë të gjitha hapat e tillë, pas së cilës transportuesi duhet, brenda dhjetë ditëve të punës, të njoftojë palën e regjistruar për limitin e kreditit të rishikuar që aplikohet për atë palë të regjistruar nga transportuesi.

c) Nëse limiti i kreditit i një pale të regjistruar duhet të rivlerësohet, siç përshkruhet në paragrafin (a) (ii) më lart:

(i) Pala e regjistruar duhet të bashkëpunojë me transportuesin dhe të sigurojë një informacion të tillë nën kontrollin e saj pasi transportuesi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme me qëllim të rivlerësimit këtë limit krediti; dhe

(ii) nëse një testimi i tillë rezulton në një rishikim të Limitit të kreditit, transportuesi duhet të njoftojë palën përkatëse të regjistruar mbi:

A. arsyet pse transportuesi ka vendosur rivlerësimin e limitit të kreditit të palës së regjistruar; dhe

B. Limiti i kreditit të rishikuar që ka rezultuar nga ai rivlerësim.

d) Nëse limiti i kreditit i një pale të regjistruar duhet të rivlerësohet dhe rishikohet, si përshkruhet në paragrafin (a) (iii) më lart,

transportuesi duhet të njoftojë secilën palë të regjistruar që ka rishikuar limitin e kreditit së saj pas rivlerësimit të limitit të kreditit të rivlerësuar që ka rezultuar nga rivlerësimi.

- e) Pa paragjykuar ndonjë të drejtë tjetër ose mjetet juridike në dispozicion të transportuesit sipas këtij kodi të rrejtë, nëse një palë e regjistruar e rishikon limitin e saj të kreditit dhe si rezultat i këtij limiti të rishikuar të kreditit, krediti i saj në dispozicion është më pak se zero atëherë pala e regjistruar duhet menjëherë të ndërmarrë hapa që janë të domosdoshëm për të rritur limitin e saj të kreditit, në mënyrë që krediti në dispozicion të jetë së paku zero.

4.3. Përcaktimi i limitit të kreditit

- a) Nëse një palë e regjistruar ose një person që po aplikon të bëhet një palë e regjistruar plotëson kriterin e limitit të Kreditit duke siguruar një vërtetim nga banka, limiti i kreditit që do të zbatohet për atë palë të regjistruar ose person (ose, nëse aplikohet, pjesa e limitit të kreditit që do t'i atribuohet këtij kriteri të limitit të kreditit) sipas secilës bankë do të jetë:
- (i) nëse banka ka një vlerësim minimal AAA, çdo limit i shumës në euro mund të kërkohet sipas një vërtetimi të bankës; ose
 - (ii) nëse banka nuk eka klasifikimin AAA, përqindja e limitit të kreditit shumëzuar me shumën në euro mund të kërkohet me një vërtetim të bankës për kreditin, ku një tabelë e vlerave të përqindjes së limitit të kreditit do të sigurohet në faqen e internetit të transportuesit.
- b) Nëse një palë e regjistruar ose një person që po aplikon për t'u bërë një palë e regjistruar plotëson kriterin e limitit të kreditit duke përdorur një llogari kolaterali me para ne dore, limiti i kreditit që do të zbatohet për atë palë të regjistruar ose person (ose, nëse aplikohet, pjesa e limitit të kreditit që do t'i jepet këtij kriteri të limitit të kreditit) do të jetë bilanci që i përket kreditit të kësaj llogarie kolaterali me para në dorë në dispozicion për aplikim nga transportuesi.
- c) Nëse një palë e regjistruar ose një person që po aplikon për t'u bërë një palë e regjistruar plotëson kriterin e limitit të kreditit duke përdorur një formë alternative të aprovuar nga rregullatori, limiti i kreditit që do të zbatohet për atë palë të regjistruar ose person (ose, nëse është e aplikueshme, pjesa e limitit të kreditit që do t'i atribuohet këtij Kriteri të limitit të kreditit) do të përcaktohet në përputhje me njoftimin e miratimit të publikuar nga rregullatori.
- d) Nëse një palë e regjistruar ose një person që po aplikon për t'u bërë një palë e regjistruar plotëson më shumë se një prej kriteve të

limitit të kreditit, limiti i kreditit që do të zbatohet për atë palë të regjistruar ose person do të jetë pjesë e limitit të kreditit që do të zbatohen për atë palë të regjistruar sipas paragrafëve (a), (b) dhe (c) më lart (sipas rastit).

4.4. Krediti fillestar i disponueshëm

- a) Para rezervimit të kapacitetit, një palë e regjistruar do të konsiderohet se kanë kredit të disponueshëm të barabartë me limitin e saj të kreditit.
- b) Krediti i disponueshëm i një pale të regjistruar do të zvogëlohet nga çdo sasi e kapacitetit të rezervuar (përveç kapacitetit alternativ të mbështetjes së kreditit) që pala e regjistruar rezervon përmes ankandit ose përvetëson përmes delegimit, në përputhje me llogaritjen e përcaktuar në nenin 4.5.
- c) Asnjë palë e regjistruar nuk mund të rezervojë përmes ankandit ose të marrë përmes delegimit ndonjë kapacitet të rezervuar që do të zvogëlonte kreditin e tij të disponueshëm në më pak se zero, pas llogaritjes së përcaktuar në paragrafin 4.5 më poshtë.

4.5. Llogaritja e kreditit të disponueshëm

- a) Krediti i disponueshëm i një pale të regjistruar do të përditësohet çdo ditë gazit dhe menjëherë pas:
 - (i) rezervimit të palës së regjistruar përmes ankandit, ose marrjen përmes delegimit, një produkti kapaciteti (përveç kapacitetit alternativ të mbështetjes së kreditit); ose
 - (ii) përditësimit të limitit të kreditit të palës së regjistruar,në përputhje me nenin 4.2 në përputhje me formulat e mëposhtme:

krediti i disponueshëm = limiti i kreditit – marrja e borxhit

ku:

marrja e borxhit nënkupton totalin (pa numëruar përsëri):

- A. të gjitha shumave të papaguara të përcaktuara në një deklaratë mujore që transportuesi i ka lëshuar tregëtarëve/furnizuesve;
- B. të gjitha tarifat mujore për të gjithë kapacitetin e rezervuar që transportuesi mban për çdo muaj paraprak të gazit (për të cilin nuk është lëshuar një deklaratë mujore), muaji aktual i gazit dhe çdo 12 muajt pasardhës të gazit, me një shumëfish krediti që

aplikohet për çdo tarifë mujore për muajt e gazit deri në muajin e tretë të gazit pas muajit aktual të gazit; dhe

- C. një preventiv të arsyeshëm të tarifave mujore që rrjedhin nga balancimi i gazit për muajin aktual të gazit.

në secilin rast duke përjashtuar çdo tarifë mujore për kapacitetin alternativ të mbështetjes së kreditit.

- b) Transportuesi do të njoftojë palën e regjistruar kur krediti i disponueshëm i llogaritur në përputhje me këtë nen është më e vogël se [10] % e limitit të kreditit të palës së regjistruar.

4.6. Realizimi i mbështetjes së kreditit

- a) Në rast se dërguesi nuk paguan ndonjë shumë të pagueshme për transportuesin kur është e detyruar, transportuesi ka të drejtë të tërheqë, arkëtojë ose mbledhë shuma të tilla nga mbështetja e kreditit e dhënë në bazë të nenit 4.1.
- b) Në rastin e ndonjë tërheqjeje, arkëtimit ose mbledhjeje të tillë, dërguesi duhet të sigurojë që mbështetja e kreditit të zëvendësohet, plotësojë ose rinovohet në kënaqësinë e transportuesit brenda [shtatë (7) ditësh] prej tërheqjes, arkëtimit ose mbledhjes.
- c) Mos zëvendësimi, plotësimi ose rinovim i mbështetjes së kreditit për kënaqësitë transportuesit do të përbëjë një shkelje materiale për qëllimet e nenit 1 ose nenit 20.

4.7. Lëshimi i mbështetjes së kreditit

- a) Nëse një Person pushon së qeni një palë e regjistruar, transportuesi do t'i kthejë personit të tillë çdo vërtetim bankar për kredinë e marrë nga një personi i tillë dhe çdo shumë që i mbetet kreditit të një llogarie kolateralit me para në dore që ka të bëjë me atë person brenda 30 ditëve nga plotësimi i të gjitha shumave që duhen paguar dhe të pagueshme nga një person i tillë janë shkarkuar në mënyrë të pakthyeshme plotësisht dhe asnjë shumë tjetër nuk mund të bëhet e pagueshme.

5. PRODUKTE KAPACITETI

5.1. Kapaciteti i disponueshëm si produkt kapaciteti

- a) Transportuesi do të:
- i) ofrojë kapacitet të disponueshëm për palët e regjistruara për të blerë në formën e produkteve të kapacitetit, në përputhje me dispozitat e këtij kodi të rrjetit;
 - ii) sigurojë që kapaciteti i disponueshëm në lidhje me çdo pikë ankandi që është për çdo ankand, të publikuar tek platforma e rezervimit të kapaciteteve; dhe
 - iii) sigurojë që arifa e aplikueshme për çdo produkt kapaciteti që ofrohet nga Transportuesi është publikuar në faqen e tij të internetit.
- b) Blerja e produkteve të kapacitetit është e hapur vetëm për palët e regjistruara që janë nënshkruar origjinalë të marrëveshjes kuadër ose që kanë miratuar marrëveshje kuadër përmes një marrëveshjeje pranimi të zbatuar siç duhet. Proçedura për rezervimin e produkteve të kapacitetit është paraqitur në nenin 6.

5.2. Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë

- a) Transportuesi do të vendosë në dispozicion të kapaciteti në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë afatgjatë në çdo pikë sistemi nëse kërkohet në përputhje me testimet e tregut.
- b) Transportuesi do t'i ofrojë produktet e mëposhtme të kapacitetit për kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë afatshkurtër për blerje nga palët e regjistruara, sipas kapacitetit të mjaftueshëm në dispozicion:
- (i) kapacitet në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë vjetor;
 - (ii) kapacitet në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë tremujor;
 - (iii) kapacitet në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë mujor; dhe
 - (iv) kapacitet në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë Ditor.
- c) Transportuesi do t'i ofrojë produkte kapaciteti për kapacitet të në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë afatgjatë për blerje nga palët e regjistruara si shumëfish i kapacitetit të në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë vjetor, me kusht që të ketë mjaftueshëm kapacitet të disponueshëm;

- d) Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i pandërprerë ofrohet në mënyrë të pavarur në çdo pikë sistemi dhe për këtë arsye palët e regjistruara duhet të rezervojnë veç e veç kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë në pikën(at) e kërkuara të hyrjes dhe /ose pikën(at) e kërkuara të daljes.

5.3. Kapacitet në drejtimin përpara (forward) i ndërprerë

- a) I vetmi produkt i kapacitetit në drejtimin përpara (forward) i ndërprerë që ofrohet nga transportuesi është kapacitet ditor në drejtimin përpara (forward) i ndërprerë ditor.
- b) Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i ndërprerë ditor do të ofrohet në mënyrë të pavarur nga çdo pikë sistemi dhe si pasojë palët e regjistruara duhet të rezervojnë në mënyrë të vecantë kapacitet në drejtimin përpara të ndërprerë tek pikat e kërkuara hyrëse dhe/ose dalëse
- c) Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) i ndërprerë ofrohet në mënyrë të pavarur në çdo pikë sistemi dhe për këtë arsye palët e regjistruara duhet të rezervojnë veç e veç kapaciteti në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë në pikën(at) e kërkuara të hyrjes dhe/ose pikën(at) e kërkuara të daljes.

5.4. Kapaciteti në drejtim të kundërt (revers)

- a) I vetmi produkt kapaciteti në drejtim të kundërt (revers) i ofruar nga transportuesi është kapaciteti në drejtim të kundërt (revers) virtual në pikën e interkoneksionit Fier.
- b) Kapaciteti virtual në drejtim të kundërt (revers) i ndërprerë do të ofrohet nga transportuesi për blerje nga palët e regjistruara në pikën e interkoneksionit Fier në bazë të itës në avancë vetëm kur nuk ka kapacitet të disponueshëm për kapaciteti në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë në atë pikë të daljes të përfshirë në atë pikë interkoneksioni.

6. REZERVIMI I KAPACITETIT

6.1. Qasja në platformën e rezervimit të kapacitetit

- a) Përveç produkteve të kapacitetit të alokuara përpara datës fillestare efektive, në qoftë se një palë e regjistruar dëshiron të rezervojë kapacitet tek një pikë ankandi duhet të bëjë nëpërmjet platformës së rezervimit të kapaciteteve. Është përgjegjësi e çdo pale të regjistruar të pranojë dhe të përmbushë kërkesat e aksesit të platformës së rezervimit të kapacitetit, si përcaktohet tek kushtet dhe termat e platformës së rezervimit të kapacitetit.
- b) Për të shmangur dyshimet, pjesëmarrja tek ankandipër rezervimin e kapacitetit tek sistemi i transmetimit është i hapur vetëm për palët e regjistruara të cilat kanë firmosur origjinalin e marrëveshjes kuadër.

6.2. Kalendari i ankandit

- a) Produktet e kapacitetit do të ofrohen për rezervim platformës së rezervimit të kapaciteteve në përputhje me këtë neni 6 dhe sipas kalendarit të ankandeve ENTSOG i cili përditësohet çdo vit dhe do të publikohet në faqen e internetit të transportuesit.
- b) Jo më pak se [7] ditë përpara datës përkatëse të ankandit, tregëtarët/furnizuesit mund të shprehin interesin tek faqja e transportuesit.
- c) Transportuesi rezervon të drejtën të anulojë një ankand dhe të alokojë kapacitetin, në përputhje me nenin 6.12, ku asnjë tregëtar/furnizues nuk ka shprehur interes për të marrë pjesë në ankand.

6.3. Kapaciteti në drejtimin përpara (forward): rezervimi

- a) Palët e regjistruara mund të blejnë produkte kapaciteti për kapacitet në drejtimin përpara (forward) në pikat e ankandit përmes ankandeve të kryera në platformën e rezervimit të kapaciteteve.
- b) Transportuesi do të ofrojë produktet e mëposhtme të kapacitetit për kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë në pikat e ankandit sipas prioritetit me poshtë për secilën pikë sistemi për sa kohë mbetet mjaftueshëm kapacitet në dispozicion për të akomoduar ato produkte kapaciteti:
 - (i) Kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë vjetor për vitin e ardhshëm të gazit në ankande vjetore;
 - (ii) Kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë tremujor për secilin tremujor të gazit në të njëjtin vit gazi në ankandet tremujore;

- (iii) Kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë mujor për muajin vijues të gazit në ankandet mujore;
 - (iv) Kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë ditor në bazë të ditës në avancë në ankande ditore; dhe
 - (v) Kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë ditor brenda ditës në ankande për orare.
- c) Transportuesi do të ofroj kapacitet në drejtimin përpara të pandërprerë vjetor në çdo pikë të sistemit për secilën prej 14 viteve të gazit në çdo ankand vjetor për kapacitet vjetor të pandërprerë në drejtimin përpara për sa kohë ka mjaftueshëm kapacitet në dispozicion për të akomoduar kapacitetinë drejtimin përpara të pandërprerë vjetor pasi është hequr kapaciteti që transportuesi duhet të rezervojë për produktet afat shkurtra në përputhje me nenin 8 të kodit të rrjetit për mekanizmin e alokimit të kapacitetit (CAM NC).
- d) Transportuesi do të ofrojë kapacitet në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë ditor në pikat e ankandit përmes një ankandi ditor nëse i gjithë kapaciteti në dispozicion për kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë për atë pikë sistemi dhe ditë gazit të cilat janë rezervuar plotësisht.

6.4. Kapaciteti në drejtimin përpara (forward): (kapacitet i lidhur (bundled))

- a) Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) do të ofrohet si kapacitet i Lidhur në çdo pikë interkoneksioni, për sa kohë që kapaciteti të jetë i disponueshëm në të dy anët e kësaj pike interkoneksioni. Nëse sasia e një produkti të veçantë kapaciteti për kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë në ofertë në një pikë interkoneksioni nga transportuesi është i ndryshëm nga sasia e kapacitetit të ofruar nga OST- të fqinje për një produkt kapaciteti me të njëjtin standard, sasia më e ulët do të ofrohet si kapacitet i lidhur dhe kapaciteti i mbetur do të ofrohet si kapacitet i pa lidhur në anën përkatëse të pikës së interkoneksionit.
- b) Kapaciteti i lidhur (bundled) në një pikë interkoneksion specifike do të ofrohet përmes ankandëve të mbajtura në platformën e rezervimit të kapaciteteve. Palët e regjistruara mund të rezervojnë kapacitet në drejtimin përpara (forward) në çdo anë të një pike interkoneksioni si kapacitet i lidhur (bundled) përmes një procedure të vetme rezervimi për secilën pikë interkoneksioni.
- c) Çmimi rezervë i çdo kapaciteti të në drejtimin përpara (forward) të ofruar si kapacitet i lidhur (bundled) do të jetë totali i çmimit rezervë dhe çmimit rezervës për produktin e kapacitetit të ofruar

nga OST-ja fqinje, në përputhje me rregullat tarifore të OST-së Fqinje.

- d) Transportuesi do të koordinojë me OST-në fqinje për të maksimizuar kapacitetin në drejtimin përpara (forward) në dispozicion si kapacitet i lidhur (bundled) në ofertë në çdo pikë interkoneksioni.

6.5. Kapaciteti në drejtim të kundërt (revers): ezervimi

- a) Palët e regjistruara mund të blejnë produkte kapaciteti për kapacitetin në drejtim të kundërt (revers) në pika të ankandit përmes ankandeve të kryera në platformën e rezervimit të kapaciteteve.
- b) Transportuesi do të ofrojë produktet e mëposhtme të kapacitetit për kapacitetin në drejtim të kundërt (revers) në pikat e ankandit në prioritetin më poshtë për aq kohë sa mbetet kapaciteti i disponueshëm:
 - (i) Kapaciteti i ndërprerë në drejtim të kundërt (revers) ditore në bazë të ditës në avancë në ankande ditore; dhe
 - (ii) Kapaciteti i ndërprerë në drejtim të kundërt (revers) ditore brenda ditës në ankande orare

6.6. Kapaciteti në drejtim të kundërt (revers): rezervimi

- (a) Kapaciteti në drejtim të kundërt (revers) do të ofrohet si kapaciteti i lidhur (bundled) në masën që kapaciteti është në dispozicion të të dyja anëvetë pikës së interkoneksionit.
- (b) Kapaciteti i lidhur (bundled) do të ofrohet përmes ankandeve të mbajtura tek platforma e rezervimit të kapaciteteve. Palët e regjistruara mund të rezervojnë kapacitetin në secilën anë të pikës së interkoneksionit si kapaciteti i lidhur (bundled) përmes një procedure të vetme rezervimi.
- (c) Çmimi rezervë i çdo kapaciteti në drejtim të kundërt (revers) të ofruar si kapaciteti i Lidhur (bundled) do të jetë totali i çmimit rezervë për pikën e interkoneksionit Fier dhe çmimit rezervës për pikën e hyrjes të TAP të ofruar nga transportuesi i TAP në përputhje me rregullat tarifore të transportuesit të TAP.
- (d) Transportuesi do të koordinojë me transportuesin e TAP për të maksimizuar kapacitetin në drejtim të kundërt (revers) të disponueshëm si kapaciteti i lidhur (bundled) në ofertë për pikën e interkoneksionit Fier.

6.7. Zhvillimi i ankandeve

Ankandet e kapaciteti në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë, përveç kapacitetit në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë ditor, do të aplikojnë një algoritëm “**ascending clock auction algorithm**” që lejon palët e regjistruara të vendosin ofertat e vëllimit kundër çmimeve të përshkallëzuara të shpallura në raundet e njëpasnjëshme të ankandit, duke filluar nga çmimi rezervë. Ankandet “ascending clock” do të zhvillohen në përputhje me procedurat dhe algoritmin e përcaktuar në kodin e rrjetit CAM.

- (a) Ankandet për kapaciteti në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë ditor, kapacitetin në drejtim të kundërt (revers) ditor dhe kapaciteti në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë të ditës në avancë do të aplikohet një algoritëm ankandi për një çmim uniform, sipas të cilit ekziston një raund i vetëm ofertash tek i cili palët e regjistruara ofertojnë çmimin, si dhe sasinë e kapacitetit. Ankandet për çmimet uniform do të bëhen në përputhje me procedurat dhe algoritmin e përcaktuar në kodin e rrjetit të mekanizmit për alokimin e kapacitetit.
- (b) Transportuesi do të pranojë vetëm oferta që janë, në përputhje me Nenin 4.4, brenda kreditit të disponueshëm të palës së regjistruar.

6.8. Publikimi i rezultateve të ankandit

- (a) Rezultatet e ankandit do të publikohen nga transportuesi në platformën e rezervimit të kapaciteteve pasi të mbyllet çdo raund i tenderit. Palët e regjistruara do të njoftohen në baza individuale mbi kapacitetin e rezervuar që ata kanë rezervuar në ankandin përkatës. Transportuesi do të vërë në dispozicion informacione për rezultatet e ankandit duke i postuar këto informacione në faqen e tij të internetit.
- (b) Për ankandet e kapacitetit në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë dhe kapacitetit në drejtim të kundërt (revers) përveç kapacitetit në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë ditor dhe kapacitetit në drejtim të kundërt (revers) ditor, rezultatet do të publikohen në ditën e ardhshme të punës pas mbylljes së ofertave.
- (c) Për ankandet e kapacitetit në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë ditor, kapacitetit në drejtim të kundërt ditor dhe kapacitetit në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë të ditës në avancë, rezultatet do të publikohen jo më vonë se 30 minuta pas mbylljes së ofertave.

6.9. Çmimi i ankandit

- (a) Për Kapacitetin e lidhur, nëse një ankand rezulton në një çmim ankandi, atëherë çmimi i ankandit do t'i alokohet fondit special të rregullatorit, në përputhje me opinionin e përbashkët, sipas një

alokimi përqindjeje që njoftohet nga platforma e rezervimit të kapaciteteve. Kjo ndarje në përqindje do të dakordohet midis transportuesit dhe OST-së fqinje përkatëse dhe do t'i nënshtrohet miratimit nga autoritetet rregullatore. Për produktet e kapacitetit që nuk ofrohen si kapacitet i lidhur, shumat e plotë e çmimit të ankandit do të kalohet për fondin special të rregullatorit.

- (b) Pjesa e transportuesit në çdo çmim të ankandit, së bashku me çmimin rezervë, do të paguhet nga transportuesi përkatës sipas kushteve të tarifës së publikuar në faqen e internetit të transportuesit.

6.10. Testimet e tregut dhe procesi i kapacitetit rritës

- (a) Transportuesi do të kryejë testimet e tregut të paktën çdo dy vjet nga data efektive fillestare, në përputhje me udhëzimet e aprovuara nga rregullatori dhe të publikuara në faqen e internetit të transportuesit herë pas here.
- (b) Procedurat e testimit të tregut do të jenë specifike për sistemin Shqiptar të transmetimit dhe do të zhvillohen duke marrë parasysh rregulloret në fuqi dhe kërkesat e kodit të rrjetit të mekanizmit të alokimit të kapacitetit.

6.11. Kapaciteti ndalues/rregullues (arpion)

- (a) Në një pikë sistemi, nëse në lidhje me një ditë të rrjedhës së gazit në çdo muaj tregëtarit/furnizuesit i alokohet një sasi gazi më shumë se "kapaciteti i tij i rezervuar në drejtimin përpara (forward) në atë pikë sistemi" (një "muaj tëcaktuar (ratchet) arpion"), ai do të jetë përgjegjës për të paguar një tarifë kufizuese (ratchet) si llogaritet në përputhje me pikën (iii) më poshtë dhe do të alokohet dhe regjistrohet si mbajtës i një sasive shtesë të kapacitetit në drejtimin përpara (forward) në përputhje me sa vijon:
 - (i) Sasia më të cilën sasia e alokuar e tregëtarëve/furnizuesve në pikën e sistemit tejkalon kapacitetin në drejtimin përpara (forward) të tregëtarëve/furnizuesve në një ditë të rrjedhës së gazit, do të jetë një "sasia kufizuese/ndaluese/rregulluese";
 - (ii) nga $M + 1$ tregëtarëve/furnizuesve do t'i alokohet një sasi shtesë e kapacitetit të rezervuar në pikën e sistemit deri në atë masë që kapaciteti në dispozicion i mbetur të mos jetë rezervuar, i barabartë me sasinë më të lartë kufizuese (rregulluese) në muajin respektiv, një kapacitet i tillë i rezervuar shtesë të alokohet dhe regjistrohet pasi ai mbajet nga tregëtari/furnizuesi deri në fund të vitit të gazit;

- (iii) Një tarifë kufizuese (arpon)(ose " RC ") do të paguhet e llogaritur si më poshtë:

$$RC = RA_{\max} \times P \times t$$

ku:

RA_{\max} është sasia më e lartë kufizuese (rregulluese) në një muaj të caktuar;

P është tarifa mujore aktuale; dhe

t është numri i muajve (përfshirëm) që nga fillimi i vitit të gazit.

- (b) Kur një tregëtari/furnizuesi i është alokuar kapaciteti shtesë në drejtimin përpara (forward) si rezultat i zbatimit të këtij neni 6.11 kapaciteti i tij i rezervuar do të ndryshohet në mënyrë që rritja të hyjë në fuqi nga $m + 1$.

6.12. Aksesit në kapacitetet në pikat e sistemit që nuk janë pika ankandi

- a) Palët e regjistruara mund të blejnë produkte kapaciteti për kapacitete në drejtimin përpara (forward)në pikat e sistemit që nuk janë pika ankandi duke paraqitur një kërkesë tek Transportuesi.
- b) Kërkesat për Produkte Kapaciteti nën këtë nen 6.12 mund të bëhen vetëm në përputhje me kalendarin e publikuar në faqen e internetit të transportuesit.
- c) Për çdo produkt kapaciteti dhe pikë sistemi nevojitet një kërkesë e veçantë.
- d) Kërkesa duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
- (i) pikën e sistemit;
 - (ii) produkt i kapacitetit;
 - (iii) pasinë e kapacitetit të kërkuar; dhe
 - (iv) palën e regjistruar që bën kërkesën.
- e) Pas marrjes së kërkesës për blerjen e produkteve të kapacitetit, transportuesi do të verifikojë kërkesën brenda një dite të plotë pune nga marrja e kësaj kërkesë.
- f) Transportuesi do të alokojë kapacitetin e sistemit të transmetimit në përputhje me kërkesat e marra për të blerë produkte kapaciteti dhe në përputhje me kapacitetin e disponueshëm në secilën pikë sistemi dhe në mënyrë të pavarur në secilën pikë sistemi.

- g) Transportuesi do të alokojë kapacitet në drejtimin përpara (forward) të ndërprerë ditor në përputhje me këtë nen vetëm nëse të gjitha kapacitetet e disponueshme për kapacitet në drejtimin përpara (forward) të pandërprerë për atë pikë sistemi dhe ditë gazi janë rezervuar plotësisht.
- h) Nëse kapaciteti i disponueshëm tejkalon ose është i barabartë me kapacitetin e përgjithshëm të kërkuar, për një pikë individuale të sistemit, transportuesi do të alokojë kapacitetin në përputhje me kërkesat për të blerë produkte kapaciteti.
- i) Nëse kapaciteti i disponueshëm është më i vogël se kapaciteti i përgjithshëm i kërkuar, për një pikë individuale të sistemit, transportuesi do të alokojë kapacitetin në bazën e pari shërbehet i pari në lidhje me ndarjen e kapacitetit në bazë të radhës së pranimit të kërkesës përfundimtare që konsiderohet se është përmbushur vetëm pjesërisht, derisa të mos ketë më tej kapacitet në dispozicion.
- j) Palët e regjistruara që bëjnë një kërkesë për të blerë produkte kapaciteti, në përputhje me këtë nen 6.12 pranojnë se produktet e kapacitetit për kapacitet në drejtimin përpara (forward) në pikat e sistemit që nuk janë pika ankandi, ato vendosen në dispozicion në përputhje me tarifën e publikuar në faqen e internetit të transportuesit.
- k) Palët e regjistruara që bëjnë kërkesa në përputhje me këtë nen 6.12 do të njoftohen individualisht për kapacitetin e rezervuar që u është alokuar në ditën tjetër të punës pas procesit të alokimit.

7. TREGU SEKONDAR

7.1. Akses në tregun sekondar

- (a) Tregu sekondar është tregtimi i kapacitetit të rezervuar midis një tregëtari/furnizuesi ofertues dhe një pale tjetër të Regjistruar e cila do të bëhet ose si një delegimi ose transferim.
- (b) Transportuesi do të lehtësojë tregtimin e kapacitetit të rezervuar në tregun sekondar për palët e regjistruara:
 - (i) në lidhje me transferimet, duke përdorur platformën e rezervimit të kapacitetit; dhe
 - (ii) në lidhje me delegimet, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7.3,
- (c) duke i mundësuar një tregëtari/furnizuesi tregtimin e të gjithë ose një pjesë të kapacitetit të tij të rezervuar në përputhje me këtë kod të rrjetit.
- (d) Nëse një palë e regjistruar dëshiron të ketë qasje në kapacitetin e rezervuar me anë të një transferimi, ajo duhet ta bëjë këtë përmes platformës së rezervimit të kapaciteteve. Është përgjegjësi e secilës palë të regjistruar që synon të marrë kapacitet të rezervuar me anë të transferimit të pranojë dhe të përmbushë kërkesat e qasjes së platformës së rezervimit të kapaciteteve, siç përcaktohet në termat dhe kushtet e platformës së rezervimit të kapaciteteve.
- (e) Nëse një palë e regjistruar dëshiron të pranojë një delegim të të gjithë ose një pjese të ndonjë kapaciteti të rezervuar, ajo duhet ta bëjë këtë duke plotësuar një formular delegimi në përputhje me nenin 7.3.

7.2. Proçedura e transferimeve

- (a) Transportuesi do të sigurojë që platforma e rezervimeve të kapaciteteve të mbështesë proçedurat e mëposhtme për transferimet e kapaciteteve të rezervuara:
 - (i) tregtia sipas kontratave të brëndshme afatgjata (OTC), ku një transportues ofertues dhe një palë e regjistruar tregtojnë në mënyrë bilaterale;
 - (ii) Thirrje për Urdhra (CFO), kur një transportues ofertues paraqet një propozim transferimi të hapur për përgjigjet e palëve të regjistruar dhe zgjedh përgjigjen që ai pranon; dhe**
 - (iii) First come firstserved (FCFS), ku një transportues ofertues paraqet një propozim transferimi të hapur për**

përgjigjet e palëve të regjistruara dhe automatikisht pranon përgjigjet bazuar në rendin në të cilin janë marrë ato përgjigje.

- (b) Për procedurën e thirrjes për urdhëra, një transportues mund të krijojë një listë të palëve të mundshme homologe në platformën e rezervimit të kapaciteteve.**
- (c) Një tregëtar/furnizues mund të tërheqë propozimin e tij për transferim përpara se të marrë një përgjigje nga një palë e regjistruar, por jo më pas.**
- (d) Nëse një transportues ofertues dhe një palë e regjistruar konfirmojnë një tregti në përputhje të bërë si një transferim, tregëtari/furnizuesi ofertues duhet të njoftojë transportuesin përmes platformës së rezervimit të kapacitetit. Njoftimi nga tregëtari/furnizuesi ofertues duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm në lidhje me një transferim:
 - (i) Pika e Sistemit;
 - (ii) produkti i Kapacitetit
 - (iii) sasia e kapacitetit të rezervuar që i nënshtrohet transferimit dhe kohëzgjatja e transferimit; dhe
 - (iv) Pala e regjistruar duke supozuar të drejtat për kapacitetin e rezervuar që i nënshtrohet transferimit.
- (e) Pas marrjes së njoftimit të transferimit, transportuesi më pas do të verifikojë transferimin brenda një dite të plotë pune për marrjen e një njoftimi të tillë, nëse transferimi është në përputhje me kushtet për transferimet e kapaciteteve të rezervuara, të përcaktuara në këtë nen 7.
- (f) Transferimet e përfunduara do të regjistrohen dhe tregohen në platformën përkatëse të rezervimit të kapaciteteve.

7.3. Procedura për delegimet

- (a) Një tregëtar/furnizues ofertues që dëshiron të transferojë të drejtat dhe detyrimet që lidhen me kapacitetin e rezervuar përmes një delegimi dhe pala e regjistruar që dëshiron të marrë ato të drejta dhe detyrime (i deleguari potencial) do t'i dorëzojë një formular delegimi të plotësuar siç duhet transportuesit jo më vonë se 33 ditë pune para datës së propozuar të këtij delegimi.
- (b) Formulari i delegimi duhet të përfshijë konfirmime nga tregëtari/furnizuesi ofertues dhe i deleguari potencial, që delegimi

i propozuar plotëson kushtet në nenin 4.7.9 të opinionit të përbashkët final;

- (c) Transportuesi duhet, brenda dy ditëve të punës, nga marrja e një formulari delegimi, t'i konfirmojë tregëtarëve/furnizuesve fertues dhe të deleguarit potencial nëse formulari i delegimi është plotësuar siç duhet ose jo.
- (d) Pas marrjes së një formulari delegimi të plotësuar siç duhet, transportuesi duhet të përcaktojë nëse delegimi i propozuar për I deleguari potencial plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 7.4. Nëse, nën një marrëveshje të transportit të gazit të lidhur para datës efektive fillestare, pëlqimi i transferuesit kërkohet për një delegimi, transportuesi duhet ta ushtrojë atë pëlqim në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje të transportit të gazit.
- (e) Transportuesi rezervon të drejtën, si pjesë e vlerësimit të tij për një delegim potencial, por vetëm kur kërkohet nga transportuesi për të siguruar që delegimi potencial nuk do të çojë në mosrespektim të kushteve të opinionit të përbashkët përfundimtar apo ndonjë ligji tjetër të lidhur, të këshillohet menjëherë me rregullatorin për delegimin potencial. Në rast të një konsultimi të tillë, si transportuesi ofertues ashtu dhe i deleguari potencial duhet të japin informacione të tilla brenda kontrollit të tyre siç mund të kërkojë transportuesi në mënyrë të arsyeshme për të lehtësuar konsultimin me rregullatorin.
- (f) Nëse delegimi i propozuar ka të bëjë me kapacitetin alternativ të mbështetjes së kreditit:
 - (i) Transportuesi mund të kërkojë nga i deleguari potencial që të sigurojë informacione të tilla të mëtejshme siç kërkon transportuesi në mënyrë të arsyeshme, në mënyrë që të vlerësojë se pajtueshmëria e të deleguarit potencial me kërkesat e mbështetjes së kreditit të nenit 4 që rregullojnë kushtet e kapacitetit përkatës të rezervuar, si pjesë e vlefshmërisë së tij të delegimit të propozuar; dhe
 - (ii) Delegimi i propozuar nuk do të hyjë në fuqi derisa i deleguari potencial të ketë përmbushur kërkesat e mbështetjes së kreditit të përcaktuara në nenin 4.
- (g) Transportuesi duhet që brenda pesë ditëve të punës të njoftojë tregëtarin/furnizuesin ofertues që formulari i tij i delegimit është plotësuar siç duhet, të njoftojë tregëtarin/furnizuesin ofertues nëse kërkon ndonjë informacion ose konsultim të mëtejshëm në përputhje me paragrafët (e) ose (f).

- (h) Transportuesi do të njoftojë tregëtarin/furnizuesin ofertues dhe të deleguarin potencial nëse delegimi është pranuar apo jo nga transportuesi jo më vonë se;
- (i) 23 ditë pune pas përfundimit të çdo konsultimi dhe marrjes së një informacioni të mëtejshëm siç mund të kërkohet nga transportuesi, siç njoftohet në përputhje me paragrafin (g) më lart; dhe
 - (ii) 30 ditë pune pas marrjes së formularit të delegimi të plotësuar siç duhet.
- (i) Nëse transportuesi nuk e ka pranuar atë delegim dhe transportuesi do të sigurojë arsye për atë mos pranim.
- (j) Nëse Transportuesi ka përcaktuar se delegimi është i suksesshëm, transportuesi duhet me anë të atij njoftimi të specifikojë ditën e parë të gazit në të cilën delegimi i propozuar do të jetë në fuqi (duke qenë më vonë e tre ditë pune pas datës së njoftimit dhe datës së specifikuar në formularin e delegimit, por që i nënshtrohet paragrafit (f) (ii) më lart nëse është e aplikueshme).

7.4. Kushtet për tregtimin në tregjet sekondare

- (a) Kushtet e mëposhtme zbatohen për tregtimin e kapaciteteve në tregun sekondar:
- (i) Vetëm palët e regjistruara mund të tregëtojnë kapacitetin e rezervuar;
 - (ii) Kapaciteti i rezervuar që fillimisht u alokua si kapacitet i lidhur (bundled) mund të rishitet vetëm si Kapacitet i lidhur (bundled). Kapaciteti i palidhurmund të rishitet vetëm si kapacitet i pa lidhur (por mund të shndërrohet në kapacitet i lidhur (bundled) me marrëveshje të OST-ve përkatëse);
 - (iii) Periudha minimale për një delegim ose transferim është një ditë Gazi;
 - (iv) Periudha maksimale për një delegim ose transferim është kohëzgjatja e plotë e tregimit të kapacitetit të rezervuar;
 - (v) Transportuesi do të vërtetojë një delegim të kapacitetit të rezervuar (përveç kapacitetit alternativ të mbështetjes së kreditit) për një palë të regjistruar e cila është brenda kreditit të disponueshëm për atë palë të regjistruar; dhe
 - (vi) Delegimi ose transferimi i propozuar nuk duhet të rezultojë në mos-përputhshmëri me kushtet e opinionit përfundimtar të përbashkët.

- (b) Termat dhe kushtet e kapacitetit të rezervuar nuk ndikohen nga tregtimi në tregun sekondar.
- (c) Nëse tregëtari/furnizuesi ofron një shumë të kapacitetit të rezervuar për dorëzim dhe në treg sekondar, i cili në total tejkalon kapacitetin e tij të rezervuar, transportuesi do të refuzojë njoftimin e tregtisë që korrespondon me tregtinë në tregun sekondar.

7.5. Efektet e tregimit të tregjeve sekondare

- (d) Për çdo kapacitet të transferuar, për kohëzgjatjen e transferimit transportuesi do të pranojë vetëm nominime, rinominime dhe njoftime tregëtare në lidhje me atë kapacitet të transferuar nga pala pranuese. Tregëtari/furnizuesi ofertues nuk do të ketë të drejtë të bëjë nominime, rinominime ose njoftime tregëtare në lidhje me kapacitetin e transferuar dhe transportuesi do të refuzojë çdo nominim ose njoftim të marrë nga tregëtari/furnizuesi ofertues për kohëzgjatjen e këtij transferimi. Në varësi të nenit 7.6, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera (përfshirë detyrimet e pagesës) në lidhje me kapacitetin e transferuar mbeten tek tregëtari/furnizuesi ofertues dhe tregëtari/furnizuesi ofertues do të vazhdojë të trajtohet si " tregëtar/furnizues" në lidhje me atë kapacitet të transferuar.
- (e) Për çdo kapacitet të deleguar, për kohëzgjatjen e delegimi, të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me atë kapacitet të deleguar do t'i përkasë palës së regjistruar që pranon delegimi e këtij kapaciteti të deleguar. Pa paragjykuar ndonjë të drejtë ose detyrim të përlllogaritur, tregëtari/furnizuesi ofertues do të pushojë së patur ndonjë të drejtë dhe do të lirohet nga të gjitha detyrimet në lidhje me kapacitetin e deleguar për tërë kohëzgjatjen e delegimit.

7.6. Njoftimet për transferimet e kapacitetit të rezervuar

- (a) Për çdo Kapacitet të transferuar, rregullimet e mëposhtme në dispozitat e komunikimit tek ky kod i rrjetit do të zbatohen për kohëzgjatjen e atij transferimi:
- (b) Transportuesi do t'i dërgojë palës pranuese:
 - (i) kopje të çdo:
 - A. Njoftimi për kufizimin e kapacitetit, njoftimi për ndërprerjen e kufizimit të kapacitetit, njoftimi për ndërprerje dhe njoftimi për përfundimin e ndërprerjes; dhe
 - B. Njoftimi për mirëmbajtje të planifikuar dhe çdo njoftim në përputhje me nenin 11.3 ose 11.4;

në të njëjtën kohë kur ato dërgohen tek tregëtari/furnizuesi ofertues në masën që lidhen me Kapacitetin e Transferuar;

- (i) çdo njoftim i sasive të konfirmuara dhe çdo komunikim në lidhje me nominimet, rinominimet, njoftimet tregëtare, njoftimet e përditësuara të tregtisë, sasitë e nominuar, sasitë e tregtuara, sasitë provizore dhe sasitë e konfirmuara, në lidhje me kapacitetin e transferuar;
 - (ii) kopje të çdo komunikimi në lidhje me sasitë e alokuara ose çështjet e përcaktuara në nenet 10.4 ose 10.6 në lidhje me kapacitetin e transferuar në të njëjtën kohë kur ato dërgohen tek tregëtari/furnizuesi ofertues (por pa asnjë zbritje në përputhje me paragrafin (c) më poshtë); dhe
 - (iii) në të njëjtën kohë kur ajo i dërgon ndonjë deklaratë tregëtarëve/furnizuesve ofertues, detaje për sasitë e alokuara në lidhje me kapacitetin e transferuar për çdo ditë gazi në çdo muaj gazi përkatës;
- (c) Transportuesi nuk do t'i dërgojë tregëtarëve/furnizuesve ofertues asnjë njoftim ose komunikim tjetër të specifikuar në paragrafin (b) (ii) më lart; dhe
- (d) Për çdo kapacitet të transferuar që është kapacitet i lidhur, transportuesi do të përjashtojë nga çdo deklaratë dhe çdo komunikim në lidhje me sasitë e alokuara në lidhje me çdo kapacitet të transferuar për secilën palë tregëtarësh/furnizuesish, detajet e tregëtarit/furnizuesit në sistemin e ndërlidhur që po merr gaz natyror nga pala pranuese.

8. NOMINIMET




Figura 2 – Skemë që tregon procesin e nominimeve dhe rinominimeve

Shënime

- 1. Shpjegimi i figurës** – Qëllimi i diagramës së mësipërme është të ofrojë një shembull se si funksionon procesi i nominimeve dhe rinominimeve.
- 2. Nominimet në avancë** – Në shumë aspekte, kërkesa për të siguruar informacione nga një javë deri në një vit në avancë është për të lehtësuar një planifikim të mirë nga OST-ja.
- 3. Nominimet e ditës në avancë dhe brënda ditës** – Këto nominime janë të rëndësishme sepse ato rrjedhin drejtpërdrejt nga kërkesat e klientëve që përdorin gaz në rrjet. Qëllimi i rinominimeve është sigurimi që dërguesit / klientët t'i japin OST-së njoftim sa më parë të jetë e mundur, dhe një nominim sa më të saktë që të jetë e mundur.

8.1. Nominimet e dy-anshme

- (a) Nominimet në lidhje me kapaciteti në drejtimin përpara (forward) mund të bëhen ose si nominime të dyanshme në rastin e të gjitha pikave të interkoneksionit ose nominime të njëanshme në rastin e secilës pikë interkoneksioni me rezervime të njëanshme.
- (b) Transportuesi duhet të publikojë në faqen e tij të internetit një listë të Pikave të interkoneksionit, në lidhje me të cilat do të pranohet një nominim i njëanshëm (secila, një pikë interkoneksioni e njëanshme), së bashku me identitetin e OST-së aktiv dhe OST-së pasiv në secilën pikë interkoneksioni të njëanshme.
- (c) Në lidhje me secilën pikë interkoneksioni të njëanshëm:
 - (i) Transportuesi dhe OST-ja Fqinje do të përcaktojnë se kush prej tyre do të jetë OST aktiv, ndërkohë që tjetri është OST pasiv; dhe
 - (ii) Tregëtari/Furnizuesi në një palë tregëtarësh/furnizuesish që ka kapacitetin e rezervuar për atë palë tregëtarësh/furnizuesish me OST-në aktive do të bëhet tregëtari/furnizuesi aktiv, ndërkohë që tjetri është tregëtari/furnizuesi pasiv.
- (d) Një palë tregëtarësh/furnizuesish mund të bien dakord të kryejnë nominime të njëanshme në një pikë interkoneksioni të njëanshme dhe duhet të njoftohet OST-ja pasive për atë marrëveshje nga tregëtari/furnizuesi pasiv duke dërguar një njoftim nominimi të përbashkët tek OST pasive, duke e njoftuar atë për faktin që tregëtari/furnizuesi pasiv autorizon tregëtarin/furnizuesin aktiv që të emërojë në emër të tregëtarëve/furnizuesve pasiv dhe të specifikojë datën e fillimit për atë autorizim dhe ose datën e mbarimit për atë autorizim ose që autorizimi është me kohë të pacaktuar.
- (e) Në periudhën pas marrja nga OST pasive të njoftimit të përbashkët të shpalljes së nominimit deri në datën e skadimit (nëse ka) të autorizimit të përmendur në paragrafin (d) më lart, OST aktive do të jetë përgjegjëse për marrjen e nominimeve për një Palë tregëtarësh/furnizuesish nga tregëtari/furnizuesi aktiv për të dy anët e pikës përkatëse të interkoneksionit të njëanshëm, dhe OST aktive do të dërgojë nominime tek OST pasive. Nëse transportuesi është OST pasive, atëherë nominimi i marrë nga OST aktive do të konsiderohet si sasia e nominuar e marrë nga tregëtari/furnizuesi përkatës.

8.2. Nominimet për kapacitetin në drejtim të kundërt (revers)

- a) Tregëtarëve/Furnizuesve do t'i caktohen kodet e llogarisë së **tregëtarëve/furnizuesve të veçantë nga transportuesi për Kapaciteti në drejtimin përpara (forward) dhe kapacitetin në drejtim të kundërt (revers.)**

8.3. Nuk përdoret

8.4. Procedura e përgjithshme

- (a) Është përgjegjësi e tregëtarëve/furnizuesve që të paraqesë nominimet e sakta brenda afateve kohore dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë nen 8.
- (b) Për të njoftuar transportuesin për sasi të gazit natyror që do të transportohen duke përdorur kapacitetin e rezervuar të tregëtarëve/furnizuesve, tregëtari/furnizuesi dërgon nominimet e tij dhe, nëse është e aplikueshme, rinominimet tek transportuesi, i cili do të përpunohet sipas procedurës vijuese:
- (i) Tregëtari/Furnizuesi i dërgon një njoftim Transportuesit me Nominimin e tij për një Pikë Hyrje ose Pike Dalje;
 - (ii) Transportuesi llogarit sasinë e konfirmuar të gazit Natyror të tregëtarëve/furnizuesve që planifikohet të dorëzohet ose ri-dorëzohet tek transportuesi në atë pikë hyrjeje ose pikë daljeje; dhe
 - (iii) Transportuesi dërgon një njoftim të sasisë së konfirmuar për secilin tregëtar/furnizues duke përcaktuar sasi të tij të konfirmuara në atë pikë hyrjeje ose në pikën e daljes.

8.5. Dorëzimi i nominimeve

- (a) Çdo tregëtar/furnizues është i detyruar të paraqesë nominime të veçanta për kapacitetin në drejtimin përpara (forward) dhe kapacitetin në drejtim të kundërt (revers) për secilën pikë hyrjeje dhe secilën pikë daljeje për të cilën ka kapacitet të rezervuar për çdo ditë gazi, në përputhje me kalendarin e parashikuar në nenin 8.7. për secilin nominim, tregëtari/furnizuesi duhet të specifikojë sa vijon:
- i) Identifikimi i pikës të sistemit (p.sh. pika specifike hyrëse ose dalje në sistemin e transmetimit)
 - ii) Kodin e llogarisë së tregëtarëve/furnizuesve (i cili do të jetë i ndryshëm për kapacitetin në drejtimin përpara (forward) dhe kapacitetin në drejtim të kundërt (revers));
 - iii) identifikimin e palës homologe (kodi i llogarisë së dërguesit të lëshuar nga OST-ja i fjinje për dërguesin homolog në

palën përkatëse të tregëtarëve/furnizuesve në anën tjetër të pikës së interkoneksionit);

- iv) Dita e gazit në të cilën aplikohet nominimi;
 - v) Sasia e gazit natyror që do të transportohet në njësi të kwh për ditë gazi; dhe
 - vi) Lloji i nominimit që është ose nominim i njëanshëm ose nominim i dyanshëm.
- (b) Nëse një Tregëtar/Furnizues paraqet një nominim si pjesë e një nominim të dyanshëm, është përgjegjësi e tregëtarëve/furnizuesve dhe homologut të tij të sigurojnë që nominimet për atë çift tregëtarësh/furnizuesish në secilën anë të pikës së interkoneksionit të jenë të barabarta.

8.6.Pika Virtuale e Tregimit dhe Njoftimet Tregëtare

- (a) Transportuesi do të lehtësojë tregtimin e gazit natyror midis tregëtarëve/furnizuesve duke lejuar që të bëjnë tregti në pikën virtuale të tregimit. tregëtarët/furnizuesit mund të bëjnë një tregti titulli për gazin natyror duke paraqitur njoftime tregëtare për transportuesin në përputhje me kalendarin në nenin 8.7.
- (b) Gazi natyror i tregtuar në pikën virtuale të tregimit mund të dorëzohet nga një tregëtar/furnizues që ka Kapacitet në drejtimin përpara (forward) në një pikë hyrëse dhe mund të ridërgohet tek një tregëtar/furnizues që ka kapacitet në drejtimin përpara (forward) në një pikë daljeje. tregëtarët/furnizuesit nuk mund të tregtojnë në pikën virtuale të tregimit gaz natyror që do të dërgohet ose ri-dërgohet duke përdorur kapacitetin në drejtim të kundërt(revers) dhe palët e regjistruara që nuk janë tregëtar/furnizues nuk mund të tregtojnë gaz natyror në pikën virtuale të tregimit.
- (c) Tregtia midis dy tregëtarëve/furnizuesve në pikën virtuale të tregimit do të bëhet përmes njoftimeve tregëtare të paraqitura tek transportuesi nga të dy tregëtarët/furnizuesit.
- (d) Një njoftim tregëtar do të sigurojë informacionin e mëposhtëm:
 - (i) që është një njoftim për një tregti në pikën virtuale të tregimit;
 - (ii) Kodi i llogarisë së tregëtarëve/furnizuesve (për kapaciteti në drejtimin përpara (Forward);
 - (iii) Kodi i llogarisë së tregëtarëve/furnizuesve homolog (për kapaciteti në drejtimin përpara (forward);

- (iv) Dita e gazit në të cilën aplikohet tregtia; dhe
 - (v) sasia e gazit natyror që duhet të tregtohet si një sasi pozitive për një blerje ose një sasi negative për një shitje në njësi kWh për ditë gazi.
- e) Tregëtarët/Furnizuesit janë përgjegjës për paraqitjen e saktë të njoftimeve tregëtare për sasi të gazit natyror që dëshirojnë të tregtojnë. Transportuesi nuk do të jetë përgjegjës nëse sasi të konfirmuara ose sasi të alokuara të tregëtarëve/furnizuesve në pikën virtuale të tregtimit nuk pasqyrojnë sasi të gazit natyror që një tregëtar/furnizues ka pranuar të blejë ose shesë në pikën e tregtimit virtual, nën çdo marrëveshje të shitjes së gazit ndërmjet tij dhe një tregëtari/furnizuesi tjetër.

8.7. Kalendari

- a) Kalendari i mëposhtëm vlen për një Tregëtar/Furnizues që paraqet Nominimet ose Njoftimet Tregëtare për Transportuesin:
- (i) Tregëtari/Furnizuesi mund të paraqesë një nominim ose një Njoftim tregëtar tek transportuesi për një ditë gazi në çdo kohë pas datës që bie një vit kalendarik para asaj dite gazi;
 - (ii) Tregëtari/Furnizuesi duhet të paraqesë një nominim ose një njoftim tregëtar tek transportuesi për një ditë gazi jo më vonë se ora 13.00 UTC (ora dimërore) ose 12.00 UTC (ora verore) në ditën e menjëhershme të mëparshme të gazit;
 - (iii) nëse tregëtari/furnizuesi ka paraqitur një nominim ose një njoftim tregëtar në lidhje me një ditë gazi, atëherë në çdo kohë para afatit të nominimit për atë ditë gazi, tregëtari/furnizuesi mund të paraqesë një nominim të ri ose një njoftim tregëtar për transportuesin, i cili do të hedhë poshtë çdo nominim ose njoftim tregëtar të mëparshëm për atë ditë gazi;
 - (iv) pas afatit të nominimit për një ditë të veçantë gazi, transportuesi kryen proceset e përputhjes siç përcaktohet në nenin 9 duke përdorur nominimin e fundit dhe njoftimet tregëtare të marra nga një tregëtar/furnizues para afatit të nominimit, pas së cilës transportuesi njofton tregëtarin/furnizuesin për sasi të tij të konfirmuara jo më vonë se ora 15.00 UTC (koha dimërore) ose 14.00 UTC (koha verore) në ditën e menjëhershme të mëparshme të gazit.
- (b) Nëse Transportuesi nuk merr një mesazh të vlefshëm me nominimet për një pikë interkoneksioni ose njoftim tregëtar për pikën virtuale të tregtimit për një ditë gazi brenda afatit të

nominimit, sasi të e nominuara të tregëtarëve/furnizuesve në atë pikëinterkoneksioni dhe/ose sasi të e tregtuara në pikën virtuale të tregtimit (sipas rastit) do të konsiderohen të jenë zero.

8.8. Rinominimet

- (a) **Sasia ne total e konsideruar**, në lidhje me një orë në një ditë gazi dhe një pikëhyrje, pikë dalje ose pikës virtuale të tregtimit llogaritet si:
- (i) për orën e parë në atë ditë gazi, zero; dhe
 - (ii) për çdo orë tjetër në atë ditë gazi, totali i sasive të konsideruara për orë për çdo orë në atë ditë gazi që bie përpara asaj ore në atë pikë hyrje, pikë dalje ose pikë virtuale tregtimi (sipas rastit).
- (b) **Sasia e konsideruar për orë**, për një orë (H) në një Ditë Gazi dhe një pikëhyrje, pikë dalje ose pikë virtuale tregtimit llogaritet si:
- (i) vlera absolute e sasive të konfirmuara të dërguesit në vijim të proceseve të përputhjes që ndodhin në fund të ciklit të rinominimit, duke rënë dy orë para orës H në atë pikë hyrje, pikë dalje ose pikëvirtuale tregtimi (sipas rastit),minus
 - (ii) Sasia në total e konsideruar për orën H në atë pikë hyrje, pika dalje ose pikë virtuale tregtimi (sipas rastit),pjesëtuar me
 - (iii) numrin e orëve të mbetura në atë ditë gazi nga dhe përfshirë orën H.
- (c) Pas afatit të njoftimit për sasi të e konfirmuara të tij, në bazë të nenit 8.7 (a) (iv), një tregëtar/furnizues mund të paraqesë Rinominime ose njoftime tregëtare të përditësuara në lidhje me një ditë gazi deri në tre orë para përfundimit të asaj dite gazi. Transportuesi do të zhvillojë një cikël rinominimi për çdo orë, në të cilin rinominimet dhe njoftimet tregëtare të përditësuara të marra gjatë një ore përpunohen përmes procesit të përputhjes në fund të asaj ore. Çdo sasi e konfirmuar e rishikuar që rezulton nga një rinominim ose njoftim tregëtar i përditësuar do të hyjë në fuqi dy orë pas përfundimit të ciklit të rinominimit në të cilin është dorëzuar rinominimi ose njoftimi tregëtar i përditësuar.
- (d) Rinominimi i një tregëtari/furnizuesi duhet të sigurojë që vlera absolute e sasive të nominuara për pikën e hyrjes ose pikën e daljes nuk është më e madhe se totali i:

- (i) Sasia në total e konsideruar në atë pikë hyrje ose pikë dalje për orën që i takon një orë pas përfundimit të ciklit përkatës të rinominimit; dhe
 - (ii) Kapaciteti i rezervuar i tregëtarëve/furnizuesve në atë pikë hyrje ose pika dalje pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të orëve në ditën e gazit dhe shumëzuar me numrin e orëve të mbetura në ditën e gazit nga dhe duke përfshirë orën që bie dy orë pas përfundimit të ciklit përkatës të rinominimit.
- (e) Rinominimi i një tregëtari/furnizuesi ose njoftimi tregëtar i përditësuar duhet të sigurojë që vlera absolute e sasive të nominuara ose sasive të tregtuara të jetë jo më e vogël se sasia në total e konsideruar në pikën përkatëse të tregtimit virtual, pikën e hyrjes ose pikën e daljes për orën që i takon një orë pas fundit të ciklit përkatës të rinominimit.

9. PËRPUTHJA DHE KONFIRMIMI

9.1. Fillimi i procesit të përputhjes

- (a) Pas afatit të nominimit dhe në fund të çdo cikli të rinominimit, në përputhje me nenin 8.8 (b), transportuesi dhe secili OST fqinje do të fillojnë procesin e përputhjes në lidhje me secilën pikë të sistemit dhe transportuesi do të fillojë procesin e Përputhjes në pikën virtuale të tregtimit.

9.2. Verifikimi i sasive të nominuara dhe sasive të tregtuara

- (a) Tregëtari/Furnizuesi është përgjegjës për paraqitjen e nominimeve që nuk tejkalojnë kapacitetin e tij të rezervuar dhe rinominimet që përputhen me kufizimet e rinominimit. Si pjesë e proceseve të përputhjes, transportuesi së pari do të sigurojë që sasi të nominuara të jenë në përputhje me këto vlera. Për këtë qëllim, kapacitetet e rezervuara për të gjitha produktet e kapacitetit që përbëjnë kapacitetin në drejtimin përpara (Forward) do të trajtohen në bazë totale në secilën pikë të interkoneksionit.
- (b) Nëse nominimet e një tregëtari/furnizuesi tejkalojnë kapacitetin e tij të rezervuar, transportuesi do të zvogëlojë ato sasi të nominuara të tregëtarëve/furnizuesve në pikën përkatëse të interkoneksionit përpara se t'i përdori ato për qëllimin e procesit të përputhjes, në mënyrë që ato të jenë të barabarta me kapacitetin e rezervuar. Nëse rinominimi i një tregëtari/furnizuesi nuk është në përputhje me kufizimet e rinominimit, transportuesi do ta refuzojë atë rinominim dhe do të zbatohet nominimi ose rinominimi i fundit i vlefshëm.
- (c) Nëse si rezultat i një kufizimi të kapacitetit, duke iu nënshtruar dispozitave të nenit 12.2 (d), sasi të nominuara të tregëtarëve/furnizuesve janë më të mëdha se shumata maksimale e kapacitetit të rezervuar të atij tregëtari/furnizuesi që transportuesi është në gjendje të vendosë në dispozicion tregëtari/furnizuesi, transportuesi do të reduktojë sasi të nominuara të atij tregëtari/furnizuesi para se t'i përdorë ato për qëllimin e procesit të përputhjes, në mënyrë që ato të jenë të barabarta me sasi maksimale.
- (d) Tregëtari/Furnizuesi është përgjegjës për paraqitjen e njoftimeve tregëtare të përditësuara që përputhen me kufizimet e rinominimit. Nëse njoftimi tregëtar i përditësuar i tregëtarëve/furnizuesve nuk është në përputhje me kufizimet e rinominimit, transportuesi do ta refuzojë atë njoftim tregëtar të përditësuar dhe do të zbatohet njoftimi tregëtar i fundit i vlefshëm njoftimi tregëtar i azhurnuar.

9.3. Përputhja

- (a) Gjatë procesit të përputhjes në një pikë sistemi transportuesi dhe OST-ja dhe OSSH-ja i fqinje, kur është e nevojshme, do të verifikojnë që:
- (i) identiteti i tregëtarëve/furnizuesve dhe homologut të tij në secilin palë tregëtarësh/furnizuesish, siç përmbahet në një nominim është i njëjtë me identitetin e dërguesve të njoftuar për OST-në e fqinje, aty ku është e nevojshme; dhe
 - (ii) për secilin palë tregëtarësh/furnizuesish, sasi të nominuara (siç mund të jenë rregulluar në bazë të nenit 9.2) për një tregëtar/furnizues në pikën e sistemit përkatëse që identifikon dorëzimin tek ose nga dërguesi homolog në atë çift tregëtarësh/furnizuesish është e barabartë me sasinë e nominuar nga ai dërgues homolog tek OSSH-ja i fqinje, aty ku është e nevojshme, për dërgimin tek ose nga tregëtari/furnizuesi.
- (b) Procesi i përputhjes do të rezultojë në sasi provizore për secilin tregëtar/furnizues në secilën pikë sistemit si më poshtë:
- (i) nëse çifti i tregëtarëve/furnizuesve është i njëjtë dhe sasi të nominuara janë të barabarta, atëherë ekziston një "përputhje" dhe sasi të provizore të tregëtarëve/furnizuesve do të jenë të barabarta me sasi të tij të nominuara (siç mund të jetë rregulluar në nenin 9.2);
 - (ii) nëse çifti i tregëtarëve/furnizuesve është i njëjtë, por sasi të nominuara nuk janë të barabarta, atëherë ekziston një "mospërputhje" dhe sasi të provizore të tregëtarëve/furnizuesve do të jenë më të vogla se sasi të nominuara (siç mund të jetë rregulluar në nenin 9.2) dhe sasinë e nominuar tek OST-ja fqinje, aty ku është e nevojshme; dhe
 - (iii) nëse çifti i tregëtarëve/furnizuesve nuk është i njëjtë, atëherë ka një "mospërputhje" dhe sasi të provizore të tregëtarëve/furnizuesve do të jenë zero.
- (c) Transportuesi gjithashtu do të zhvillojë një proces përputhje në pikën virtuale të tregimit për të verifikuar që:
- (i) identiteti i tregëtarëve/furnizuesve në secilin çifti tregëtarësh/furnizuesish siç përmbahet në dy njoftimet tregëtare përkatëse është i njëjtë; dhe

- (ii) për secilin çifti tregëtarësh/furnizuesish, sasi të tregtuara të njoftuara nga secili tregëtar/furnizues për atë çifti tregëtarësh/furnizuesish janë të barabarta.
- (d) Procesi i përputhjes në pikën virtuale të tregtimit do të rezultojë në sasi provizore për secilin tregëtar/furnizues si më poshtë:
- (i) nëse çifti i tregëtarëve/furnizuesve është i njëjtë dhe sasi të tregtuara janë të barabarta, atëherë ekziston një "përputhje" dhe secila sasi provizore e dërguesit do të jetë e barabartë me sasinë e tregtuar;
 - (ii) nëse çifti i tregëtarëve/furnizuesve është i njëjtë, por sasi të tregtuara nuk janë të barabarta, atëherë ekziston një "mospërputhje" dhe secila sasi provizore e dërguesit do të jetë më e ulët se dy sasi të tregtuara të njoftuara; dhe
 - (iii) nëse çifti i tregëtarëve/furnizuesve nuk është i njëjtë, atëherë ekziston një "mospërputhje" dhe sasi provizore të dërguesit do të jenë zero.

9.4. Sasi të konfirmuara

- (a) Sasi të konfirmuara të një tregëtari/furnizuesi do të jenë të barabarta me sasi të tij provizore pas përfundimit të të gjitha proceseve të përputhjes.
- (b) Transportuesi do t'i dërgojë një njoftim të sasive të konfirmuara secilit tregëtar/furnizues me një sasi të konfirmuar në një pikë interkoneksioni pas përfundimit të proceseve të përputhjes në atë pikë interkoneksioni.
- (c) Transportuesi do të dërgojë një njoftim të sasisë së konfirmuar të secili tregëtar/furnizues me një sasi të konfirmuar në pikën virtuale të tregtimit pas përfundimit të procesit të konfirmimit.
- (d) Në pikat e sistemit, përveç atyre të seksionit 9.4 (a), nëse si rezultat i një kapaciteti kufizues që i nënshtrohet parashikimeve të seksionit 12.2 (d), sasi të emërtuara të tregëtarëve/furnizuesve janë më të mëdha se shumat maksimale të kapacitetit rezervuar i tregëtarëve/furnizuesve kapaciteti që transportuesi është në gjendje t'i vërë në dispozicion të tregëtarëve/furnizuesve, transportuesi do të zvogëlojë sasi të emërtuara të tregëtarëve/furnizuesve në atë pikë sistemi në mënyrë që ata të jenë të barabartë me atë sasi maksimale.
- (e) Në pikat e sistemit, përveç atyre të seksionit 9.4 (a), sasia e konfirmuar e një tregëtari/furnizuesi do të jetë e barabartë me sasinë e nominuar të saj, duke iu nënshtuar çdo ulje të kryer në

përputhje me seksionin 9.4 (d) dhe transportuesi do të dërgojë një njoftim të konfirmuar të sasisë për këtë qëllim.

- (f) Në të gjitha pikat e tjera të sistemit që nuk i nënshtrohen një kufizimi të kapacitetit, sasia e konfirmuar e një tregëtari/furnizuesi do të jetë e barabartë me sasinë e nominuar të saj dhe transportuesi do të dërgojë një njoftim të konfirmuar të sasisë për këtë qëllim.

10. BALANCIMI DHE ALOKIMI

10.1. Disbalancimi i transmetimit

- a) Disbalancimi i transmetimit për një ditë gazi për një tregëtar/furnizues do të llogaritet nga transportuesi sipas formulës së mëposhtme:

$$FTI'_{d,s} = \sum FEA'_{d,s} + \sum FXA'_{d,s} + \sum VTPA'_{d,s}$$

ku:

- (i) $FTI'_{d,s}$ është disbalancimi i transmetimit për ditën e gazit d për tregëtarin/furnizuesin s
- (ii) $\sum FEA'_{d,s}$ janë sasi të alokuara në secilën pikë hyrëse për ditën e gazit d për tregëtarin/furnizuesin s
- (iii) $\sum FXA'_{d,s}$ janë sasi të alokuara në secilën pikë dalje për Ditën e Gazit d për tregëtarin/furnizuesin s
- (iv) $\sum VTPA'_{d,s}$ janë sasi të alokuara në pikën virtuale të tregimit

dhe të gjitha shifrat janë rregulluar për të llogaritur shpërndarjen e Gazit Balancues.

10.2. Nuk Përdoret

10.3. Tarifa Ditore e Disbalancimit

- a) Transportuesi do të llogarisë tarifën ditore të disbalancimit për secilin tregëtar/furnizues për çdo ditë gazi në të cilën tregëtari/furnizuesi ka sasi të alokuara. Totali i tarifave ditore të disbalancimit për çdo ditë gazi në një muaj gazi do të mbledhet ose zbritet nga (sipas rastit) shuma totale që paguhet nga ai tregëtar/furnizues në lidhje me atë muaj gazi.
- b) Tarifa ditore e disbalancimit llogaritet, për secilën ditë gazi d, si disbalancim i transmetimit për tregëtarin/furnizuesin s për atë ditë gazi d shumëzuar me çmimin e disbalancimit të gazit te tepërt ($EIGP_d$) për atë ditë gazi në rastin e një disbalancimi pozitiv të transmetimit dhe nga çmimi i disbalancimit të mungesës së gazit (SIGPd) për atë ditë gazi në rast të një disbalancimi negativ të transmetimit (secila siç përcaktohet më poshtë)
- c) Çmimi i disbalancimit për gazin e tepërt ($EIGP_d$) për ditën e gazit d llogaritet si më i vogli prej (i) çmimi i balancimit për

tepricën (EBP_d) dhe (ii) çmimi referencë i gazit (GP_d) (secili siç janë të përcaktuara më poshtë), në secilin rast për atë Ditë Gazi d.

$$EIGP_d = \min(EBP_d | GP_d)$$

Ku:

- (i) EBP_d është çmimi më i ulët për shitje të gazit natyror nga transportuesi në ditën e gazit i shprehur në lek / kwh (ose, nëse transportuesi zvogëlon sasinë e gazit të karburantit ose UFG-së që përndryshe do të blinte si rezultat i disbalancimit të transmetimit, çmimi që transportuesi do të kishte paguar për një sasi të tillë të gazit natyror).
 - (ii) GP_d është çmimi i referencës për atë Ditë Gazi i shprehur në lekë / kWh.
- c) Çmimi i disbalancimit i mungesës së gazit ($SIGP_d$) për ditën e gazit d llogaritet si më i madhi (i) çmimi i balancimit i mungesës (SBP_d) dhe (ii) çmimi i referencës së gazit (GP_d) (secili siç është përcaktuar më poshtë), në secilin rast për atë ditë gazit d.

$$SIGP_d = \max(SBP_d | GP_d)$$

Ku:

- (i) SBP_d është çmimi më i lartë për çdo blerje të gazit natyror nga transportuesi në ditën e gazit d i shprehur në lek / kwh.
- (ii) GP_d ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin (c) më lart.

Transportuesi do të publikojë në faqen e tij të internetit çmimin e referencës të aplikueshëm GP_d [për ditën e mëparshme të gazit së bashku me listën e çmimeve të mëparshme të referencës.

Kur për ndonjë arsye transportuesi nuk është në gjendje të llogarisë çmimin e disbalancimit për tepricën e gazit ($EIGP_d$) ose çmimin e disbalancimit të mungesës së gazit ($SIGP_d$) për çdo ditë gazi d, atëherë do të aplikohet një çmim i paracaktuar i barabartë me mesataren aritmetike të çmimit të disbalancimit për tepricën e gazit ($EIGP_d$) ose çmimit të disbalancimit të mungesës së gazit ($SIGP_d$) sipas rastit, i [7] ditëve të fundit.

10.4. Alokimi në pikat e interkoneksionit

- a) Kur ekziston një marrëveshje operationale e balancimit dhe ajo nuk është ndërprerë, sasi të alokuara në një Pike interkoneksioni do të jenë të barabarta me sasi të konfirmuara.

- b) Kur një marrëveshje operationale e balancimit nuk ekziston ose është ndërprerë, sasia e alokuara (AQF_S) në një pikë interkoneksioni për tregëtarët/furnizuesit S në drejtimi përpara do të llogaritet duke përdorur rregullin e mëposhtëm të alokimit proporcional:

- (ii) periudha midis datës në të cilën ndodhi verifikimi i fundit i të dhënave matëse dhe data në të cilën u krye rregullimi ose riparimi i pajisjeve matëse siç kërkohet nga paragrafi (a) (i) më lart,
- d) Nëse ndonjë e dhënë e matjes është korrigjuar në përputhje me këtë nen 17.2:
- (i)nëse ato të dhëna matëse prekin gazin gatyror të dorëzuar në një pikë interkoneksioni:
 - A. transportuesi do të komunikojë me OST-në fqinje përkatëse për të përcaktuar nëse korrigjimi mund të përthithet ndërmjet transportuesit dhe OST-së së Fqinje në përputhje me çdo marrëveshje interkoneksioni ose marrëveshje të balancimit operacional në fuqi në atë pikë interkoneksioni (ose siç mund të jetë rënë dakord ndërmjet transportuesit dhe OST-së Fqinje) pa ndonjë nevojë për të rishikuar sasinë e alokuara; dhe
 - B. nëse nuk është e mundur të përthithet korrigjimi në përputhje me paragrafin (A) më lart, sasinë e alokuara do të rishikohen për çdo ditë gazi në të cilën aplikohen vlerat e zëvendësimit në përputhje me rregullin e alokimit proporcional në nenin 10.4 (b); dhe
 - (ii) transportuesi duhet, në masën e nevojshme, të azhurnojë çdo deklaratë të prekur në përputhje me nenin 19.3.

17.3. Kërkesat për Verifikim

- a) Nëse një palë e regjistruar që është ose ka qenë, në kohën përkatëse, një tregëtar/furnizues ose konsumator përfundimtar beson në mënyrë të arsyeshme se ndonjë pajisje matëse nuk është, ose nuk ka qenë, në çdo kohë që nga data që bie tre muaj para Verifikimit më të fundit, duke matur me saktësi të dhënat e matjes, ajo palë e regjistruar mund të kërkojë kopje të të gjitha regjistrimeve përkatëse të kalibrimit, validimit dhe verifikimit, të cilat janë të lidhura me periudhën dhe pajisjet matëse nën shqyrtim. Transportuesi duhet të sigurojë të gjitha regjistrat e tillë në lidhje me pajisjen matëse dhe periudhën përkatëse brenda dy javësh nga një kërkesë e tillë.
- b) Pas marrjes dhe shqyrtimit të informacionit të parashikuar në paragrafin (a) më sipër, pala e regjistruar përkatëse ose përdoruesi përfundimtar mund, nëse i vërteton transportuesit se me arsyeshmëri beson se ka një gabim material në të dhënat përkatëse të matjes, të njoftojë transportuesin se kërkon që transportuesi të verifikojë të dhënat e matjes.

- c) Pas marrjes së një njoftimi të përmendur në paragrafin (b) më lart, transportuesi duhet:
- (i) të sigurojë që verifikimi i kërkuar është kryer sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme dhe të sigurojë që pala e regjistruar ose konsumatori përfundimtar të marrin, të paktën pesë ditë pune, njoftim për kohën dhe vendndodhjen e secilit hap të verifikimit;
 - (ii) të sigurojë që verifikimi i kërkuar është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 17.1 (b) (A) deri në (C); dhe
 - (iii) jo më vonë se katër javë pas përfundimit të verifikimit të kërkuar, të sigurojë një raport që deklaron nëse pajisja matëse përkatëse subjekt i verifikimit është dhe ishte duke operuar me saktësi dhe në përputhje me specifikimet teknike të pajisjeve matëse ose jo dhe, nëse është e rëndësishme, të specifikojë çdo veprim që rezulton të jenë ndërmarrë nga transportuesi.
- d) Nëse verifikimi konkludon se:
- (i) Pajisja matëse është dhe ka qenë duke operuar me saktësi, në përputhje me specifikimet teknike të pajisjeve matëse, pala e regjistruar ose konsumatori përfundimtar që kërkon verifikimin duhet të rimbursojë menjëherë transportuesin për të gjitha kostot dhe shpenzimet që transportuesi ose ndonjë prej punonjësve ose kontraktorëve të tij të paraqitura në lidhje me atë verifikim dhe prodhimin e raportit; ose
 - (ii) Nëse pajisja matëse nuk është ose nuk po operonte me saktësi, transportuesi do të jetë përgjegjës për çdo kosto ose shpenzim që transportuesi ose ndonjë nga punonjësit ose kontraktorët e tij kanë në lidhje me atë verifikim dhe prodhimin e raportit.
- e) Një palë e regjistruar ose konsumatori përfundimtar që kërkon një verifikim ka të drejtë të ketë personelin e tij të pranishëm gjatë verifikimit, me kusht që një palë e regjistruar ose konsumatori përfundimtar të përfshijë, në njoftimin e tij të dhënë nën paragrafin (b) më lart, konfirmimin që synon të ketë prezent personelin e tij dhe emrat dhe detajet e kontaktit të këtij personeli. Pala e regjistruar ose konsumatori përfundimtar është përgjegjës për të siguruar që personeli i saj të respektojë në çdo kohë që ata janë të pranishëm të gjitha kërkesat e zbatueshme të sigurimit dhe sigurisë, siguracionit, konfidencialitetit dhe kërkesat ligjore të transportuesit dhe/ose një OST-je Fqinje përkatëse.

- f) Nëse një inspektim, auditim ose investigim i sistemit të transmetimit nga ndonjë autoritet publik, kombëtar ose metrologjik ndodh gjatë ndonjë periudhe verifikimi të planifikuar në përputhje me këtë nen 17.3, ai inspektim, auditim ose investigim do të ketë përparësi mbi atë verifikim dhe transportuesi mund të vonojë atë verifikim siç është e nevojshme për të akomoduar atë inspektim, auditim ose investigim.
- g) Nëse transportuesi vonon një verifikim, në përputhje me paragrafin (f) më lart, ai duhet të ri-planifikojë atë verifikim, sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, pas përfundimit të inspektimit, auditimit ose investigimit përkatës dhe t'i japë palës së regjistruar përkatëse ose konsumatorit përfundimtar njoftim të paktën pesë ditë pune mbi kohën dhe vendndodhjen e secilit hap të verifikimit të planifikuar.

17.4. Detyrimi për të instaluar pajisje matëse

- a) Sipas Ligjit për sektorin e gazit natyror, transportuesi është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve në sistemin e transmetimit.
- b) Sistemi matës i instaluar nga, ose në emër të transportuesit në ambientet e klientit përfundimtar, do të jetë pronë e transportuesit.
- c) Transportuesi mund të kontraktojë operatorë të pavarur për të kryer veprimtari matëse dhe/ose ofrimin e shërbimeve në lidhje me leximin e matësve në sistemin e transmetimit.
- d) Transportuesi duhet të sigurojë që konsumatori përfundimtarë të ketë qasje në çdo kohë për të lexuar dhe monitoruar pajisjet e matjes së gazit natyror. Shërbimi i tillë do të ofrohet falas.
- e) Asgjë në këtë kod nuk do të ndalojë që transportuesi ose konsumatori përfundimtar të instalojë matës kontrolli ose pajisje matëse për qëllimet e faturimit të konsumatorit përfundimtar për aq kohë sa instalimi i një pajisje të tillë nuk ndërhyt në aktivitetet e matjes së transportuesit dhe montimi i pajisjeve përputhet me të gjitha rregullat përkatëse të sigurisë.

18. RISHPËRNDARJA

18.1. Të përgjithshme

- a) Ky nen 18 përcakton zbatimin e parimeve për llogaritjen dhe alokimin e sasive që kërkohen të rishpërndahen në përputhje me tarifën e publikuar në faqen e internetit të transportuesit.

18.2. Fondi i veçantë i rregullatorit

- a) Në përputhje me paragrafin 10 të nenit 4.7 të opinionit të përbashkët (final joint opinion), sasia që do të transferohet në fondin e veçantë të rregullatorit për secilën periudhë të ardhurlllogaritjet si më poshtë:

$$RA_{a_t} = AMC_{mtp_t} + AMC_{rfp_t}$$

ku:

RA_{a_t} është shuma që do të transferohet në fondin special në dispozicion të autoriteteve për periudhë të ardhurash

AMC_{mtp_t} është sasia totale e marrë nga transportuesi brenda periudhës e të ardhurave t nga pjesa e tarifave mujore aktuale që i atribuohen një primi ankandi që paguhet në përputhje me procedurat e testit të tregut

AMC_{rfp_t} është sasia totale e marrë nga Transportuesi brenda Periudhës e të Ardhurave t nga pjesa e Tarifave Mujore Aktuale që i atribuohet një Primi Ankandi për Kapacitetin Tregëtar Revers.

të tregon periudhën e marrjes së të ardhurave

- b) Transportuesi do të transferojë të gjithë shumën e tillë në fondin special të rregullatorit në përputhje me udhëzimet e rregullatorit.

19. FATURIMI

19.1. Deklarata master

- a) Transportuesi do t'i dërgojë çdo Palë të regjistruar që ka ndonjë shumë që do të paguhet kundrejt ose nga ajo palë e tillë e regjistruar në një muaj të veçantë gazit sipas këtij kodi rrjeti një deklaratë master jo më vonë se dita e dhjetë pas përfundimit të atij muaji gazi.
- b) Deklarata master do të përfshijë secilën nga deklaratat Mujore që transportuesi kërkohet t'i dërgojë asaj pale të regjistruar sipas paragrafit (e).
- c) Për më tepër, deklaratata master do të përcaktojë detaje të shumave të mëposhtme për muajin përkatës të gazit (në masën e zbatueshme):
 - (i) çdo reduktim i aftësisë së palës së regjistruar për të përdorur kapacitetin e saj të rezervuar si rezultat i një kufizimi të kapacitetit;
 - (ii) sasitë e alokuara për atë palë të regjistruar në lidhje me secilin nga kodet e llogarisë së tregëtarëve/furnizuesve në secilën pikë interkoneksioni dhe në pikën virtuale të tregtimit për çdo ditë gazi në muajin përkatës të gazit;
 - (iii) shuma e pagesës së neutralitetit, e kredituar ose e pagueshme nga ajo palë e regjistruar;
 - (iv) tarifa ditore e disbalancimit për çdo ditë gazi në atë muaj gazi për atë palë të regjistruar;
 - (v) çdo tarifë e pagueshme në lidhje me kapacitetin e dorëzuar, në përputhje me nenin 13.2 (d);
 - (vi) çdo tarifë e pagueshme në lidhje me kapacitetin e tërhequr, në përputhje me nenin 13.9 (b);
 - (vii) çdo shumë për të kompensuar transportuesin për primin e ankandit të pakthyesëm në përputhje me nenin 13.11;
 - (viii) gazi karburanti total i alokuar asaj pale të regjistruar dhe çmimi i gazit karburant i aplikueshëm; dhe
 - (ix) UFG totale e alokuar asaj pale të regjistruar dhe çmimi UFG i aplikueshëm për kwh dhe kostoja UFG për kwh.
- d) Përveç deklaratës master, shumat e përcaktuara në paragrafin (c) më lart (ose proporcioni përkatës i tyre) do të përcaktohen në deklaratën mujore të cilës i përkasin ose të cilës ky kod i rrjetit ia

ka alokuar ato dhe të tillat shuma do të paguhen në përputhje me kushtet e këtij kodi të rrjetit.

e) Deklaratat mujore do të përgatiten për të mbuluar aktivitetet e mëposhtme:

(i) Shërbimet e transportit përfshirë rregullimet arpon;

(i) UFG;

(iii) gazi karburant;

(iv) neutraliteti;

(v) gazi Balancues; dhe

(vi) faturimi Ad Hoc

duke ofruar një tregues të qartë të tarifës ose tarifave që duhet të paguhen nga pala e regjistruar tek transportuesi ose nga transportuesi tek pala e regjistruar, sipas rastit, dhe datën e pagesës në të cilën duhet të bëhet pagesa.

f) çdo deklaratë mujore do të specifikojë:

(i) identitetin e tregëtarëve/furnizuesve;

(ii) periudha me të cilën lidhet deklarata mujore;

(iii) lloji i deklaratës mujore;

(iv) shumën për secilin artikull në deklaratën mujore;

(v) data e pagesës;

(vi) shumën e taksave (nëse ka) që paguhet për secilin artikull të faturës;

(vii) një numër unik me të cilin mund të identifikohet deklarata mujore

dhe të ofrojë detaje të tilla mbështetëse siç mund të kërkojë pala e regjistruar në mënyrë që të vërtetojë tarifën e pagueshme.

19.2. Deklarata vjetore

a) Çdo deklaratë vjetore do të përcaktojë (sipas rastit) detajet dhe shumën e çdo pagese të kërkuar në përputhje me nenin 14.1 (e) ose 16.1 (d).

- b) Për më tepër, çdo deklaratë vjetore do të përmbajë gjithashtu detaje të shumave të mëposhtme (nëse ka) që do të rishpërndahen tek pala e regjistruar përkatëse:
- (i) shuma e çdo rishpërndarje të të ardhurave nga kapaciteti përcjellës i ndërprershëm i ditës në avancë i zbatueshëm për atë palë të regjistruar në përputhje me nenin 18; dhe
 - (ii) shuma e çdo rishpërndarje të të ardhurave të tjera të zbatueshme për atë palë të regjistruar në përputhje me nenin 18.
- c) Nëse kërkohet një pagesë nga tregëtari/furnizuesi për transportuesin sipas paragrafit (a) më lart, pala e regjistruar do të paguajë një shumë të tillë në përputhje me kushtet e këtij kodi të rregjimit.
- d) Transportuesi do të kreditojë çdo shumë pozitive të specifikuar në paragrafin (b) më lart ndaj shumave të pagueshme sipas kushteve të këtij kodi të rregjimit.

19.3. Korrigjimi i deklaratave mujore

- a) Nëse ndonjë e dhënë matëse në lidhje me një muaj gazi për të cilin është dërguar një deklaratë master është korrigjuar më pas në përputhje me nenin 17, atëherë transportuesi duhet të:
- (i) rishikojë çdo deklaratë (përfshirë çdo deklaratë vjetore) të prekur nga të dhënat përkatëse matëse në mënyrë që të pasqyrojë të dhënat matëse të korrigjuara; dhe
 - (ii) ti dërgojë secilës palë të regjistruar të prekur sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme deklaratat e azhornuara së bashku me një ripërshtatje kundrejt deklaratave të lëshuara më parë, duke treguar në veçanti:
 - A. çdo ndryshim në sasi të alokuara, alokimin e shumës së pagesës së neutralitetit, tarifën e disbalancimit ditor, alokimin e gazit karburant, alokimin e UFG-së, alokimin evlerësimit të kostos së energjisë elektrike, alokimin e kostos aktuale të energjisë elektrike dhe shumën e çdo rishpërndarjeje;
 - B. shumën totale që transportuesi duhet t'i paguajë palës së regjistruar ose shumën totale shtesë të pagueshme nga pala e regjistruar për transportuesin, sipas rastit, si rezultat i korrigjimit të të dhënave matjes, azhurnimit të deklaratës përkatëse dhe pershtatjes së shumave të detyrueshme dhe të pagueshme në bazë të deklaratës

së azhornuar me shumat që ishin të detyrueshme dhe të pagueshme sipas deklaratës origjinale.

- b) Nëse deklaratat e rishikuara të parashikuara në paragrafin (a) (ii) më lart rezultojnë në një pagesë totale shtesë nga pala e regjistruar për transportuesin, pala e regjistruar do të paguajë një shumë të tillë në përputhje me kushtet e këtij kodi të rrjetit.
- c) Nëse deklaratat e rishikuara të parashikuara në paragrafin (a) (ii) më lart rezultojnë në një pagesë që kërkohet nga transportuesi për palën e regjistruar, transportuesi do të kreditojë një shumë të tillë kundrejt shumave të pagueshme sipas këtij kodi të rrjetit.

19.4. Procedurat e faturimit, afatet kohore etj.

- a) Transportuesi do të paraqesë në lidhje me një muaj 'm' pas deklaratës përfundimtare, dhe jo më vonë se dita [e dhjetë (10)] e punës e "m + 1", deklaratat mujore në lidhje me shërbimet e detajuara në nenin 19.1 (e).
- b) Në rast të një ngjarjeje emergjence, transportuesi do të përdorë përpjekjet e tij të arsyeshme për të paraqitur deklaratat mujore të identifikuar (a) tek tregëtarët/furnizuesit brenda [pesëmbëdhjetë (15)] ditëve të punës prej datave të parashikuara në (a) në lidhje me një muaj në të cilin ka ndodhur një emergjencë ose kur ekziston një emergjencë në lidhje me periudhën e fundit të balancimit në një muaj, brenda pesë (5) ditëve pune prej datës së ri-fillimit të kodit.
- c) Nuk ka asnjë kërkesë për të paraqitur një deklaratë mujore Ad Hoc deri në ndonjë datë specifike në një muaj dhe transportuesi mund të paraqesë më shumë se një deklaratë të tillë mujore në çdo muaj.
- d) Pavarësisht nga sa më lart (a), transportuesi mund, në çdo kohë (para ose pas datës së ndërprerjes së tregëtarëve/furnizuesve) pasi të paraqesë tek tregëtari/furnizuesi një njoftim për përfundim, të paraqesë çdo deklaratë mujore tek tregëtari/furnizuesi për çdo muaj (ose një pjesë të tij) që përfundon në ose para kohës në të cilën transportuesi paraqet një deklaratë mujore në përputhje me këtë paragraf.
- e) Kur transportuesi ka paraqitur një njoftim për përfundim tek ndonjë tregëtar/furnizues, të gjitha shumat e paguara nga tregëtari/furnizuesi tek transportuesi ose nga transportuesi tek tregëtari/furnizuesi (pavarësisht nëse deklarata mujore në të cilën shumat e tilla janë treguar është dorëzuar para ose pas datës të njoftimit për përfundim) do të paguhet menjëherë.
- f) Shumat nën çdo deklaratë mujore do të paguhen nga tregëtari/furnizuesi për transportuesin ose (sipas rastit) nga

transportuesi për tregëtarin/furnizuesin në ose para datës së detyrimit.

- g) Kur një deklaratë mujore përmban shuma të pagueshme nga dhe për një tregëtar/furnizues do të paguhet vetëm shuma neto ("shuma e neto e faturës").
- h) Kur ndonjë shumë e pagueshme sipas një deklaratë mujore nuk është paguar në ose para datës së detyrimit, përfituesi do të paguajë interes në normën e interesit të aplikueshëm + [pesë (5)] përqind, mbi shumën e papaguar nga data e detyrimit deri në ditën në të cilën është bërë pagesa.
 - i) paragrafi (h) nuk do të interpretohet sikur lejon pagesën me vonesë të ndonjë shume.
- j) Kur interesi paguhet në përputhje me këtë nen, interesi:
 - (i) do të grumbullohet çdo ditë dhe në bazë të një viti me 365 ditë; dhe
 - (ii) do të përfshihet në masën dhe në sajë të faturimit në një deklaratë mujore Ad Hoc, pagesa me vonesë e së cilës do të jetë subjekt i interesit në përputhje me paragrafin (h).
- k) "Norma e interesit e zbatueshme" është norma e interesit, e shprehur si një normë përqindjeje për vit, e përdorur në lidhje me shumën e vonuara për pagesë, ose që i nënshtrohet ripagimit, sipas kodit dhe do të jetë një normë e barabartë me euribor plus [6%] për periudhën në të cilën rritet interesi.

20. PEZULLIMI

20.1. Pezullimi i të drejtave dhe shërbimet e transportit

- a) Nëse, në ndonjë kohë, ndonjë prej rrethanave të përcaktuara në nenin 20.2 (a) zbatohet në lidhje me një palë të regjistruar, transportuesi mund të njoftojë atë palë të regjistruar dhe rregullatorin që do të pezullojë disa ose të gjitha të drejtat e asaj pale të regjistruar sipas këtij kodi të rrejtës nga data dhe koha e specifikuar në atë njoftim deri në fillimin e ditës së parë të gazit që menjëherë pason datën në të cilën rrethanat e tilla pushojnë së ekzistuari.
- b) Njoftimi për pezullimin e përmendur në paragrafin (a) më lart duhet të:
 - (i) përmbajnë detaje të rrethanave të zbatueshme të përcaktuara në nenin 20.2 (a);
 - (ii) përcaktojnë cilat të drejta janë pezulluar; dhe
 - (iii) shënojnë datën dhe kohën nga e cila transportuesi synon të pezullojë të drejtat e asaj pale të regjistruar dhe (nëse është e aplikueshme) shërbimet e transportit.
- c) Ky nen 20 është shtesë përveç të drejtave të përfundimit dhe të pezullimit të transportuesit në bazë të termave dhe kushteve të përgjithshme.
- d) Kur pala e regjistruar referuar në paragrafin (a) më sipër është një subjekt i licencuar, transportuesi do të lidhet me rregullatorin për të përcaktuar se cilat të drejta mund të pezullohen dhe mund të, për shmangien e dyshimit, lëshojë më shumë se një njoftim për pezullimin e të drejtave në mënyrë sekuenciale.

20.2. Rrethanat që nxisin një pezullim

- a) Rrethanat që do t'i lejojnë transportuesit të ndërmarrë veprimet e përmendura në nenin 20.1 (a) në lidhje me një palë të regjistruar janë:
 - (i) transportuesi do të ishte subjekt i përgjegjësisë penale ose civile si rezultat i marrëdhënies së transportuesit me atë palë të regjistruar ose filialin e saj;
 - (ii) pala e regjistruar është në shkelje të një dispozite materiale të kodit, përfshirë ato që lidhen me pagimin e shumave sipas kodit;
 - (iii) ajo palë e regjistruar është duke shkelur vazhdimisht ndonjë dispozitë të kodit përveç atyre dispozitave të përfshira në 20.2 a) iii);

- (iv) ajo palë e regjistruar ndalon pagesat e borxheve ose pranon pamundësinë e saj për ti paguar këto borxhe ose falimenton sipas legjislacionit të aplikueshëm
- (iv) sigurimi i gazit natyror nga ajo palë e regjistruar për transportuesin:
 - A. do të binte në kundërshtim me nenin 14a të rregullores së këshillit (BE) 267/2012 (e ndryshuar me rregulloren e këshillit (BE) 1263/2012);
 - B. e bën transportuesin ose ndonjë tregëtar/furnizuesjetër që pranon ridorëzimin e gazit natyror nga transportuesi subjekt të përgjegjësisë penale ose civile; ose
 - C. do të rezultonte që transportuesi të mos ishte në pajtim me opinionin e përbashkët.

21. KOMUNIKIMET

21.1. Rendi i përparësisë së komunikimeve

- a) Ky nen 21 është subjekt çdo dispozite të kundërt të këtij kodi të rrjetit që përshkruan se si duhet të bëhet një komunikim i veçantë.
- b) Të gjitha komunikimet nën dhe në lidhje me këtë kod të rrjetit duhet të bëhen në gjuhën shqipe dhe angleze.
- c) Komunikimet nën dhe në lidhje me këtë kod të rrjetit duhet të bëhen si më poshtë nëse nuk ka padisponueshmëri të përgjithësuar të këtyre mjeteve të komunikimit:
 - (i) në lidhje me komunikimet operacionale ndërmjet Transportuesit dhe tregëtarëve/furnizuesve, duke përdorur softuer të përdorur nga transportuesi që mbështet komunikimin përmes Edig@s;
 - (ii) në lidhje me komunikimet midis transportuesit dhe palëve të regjistruara dhe komunikimeve midis palëve të regjistruara në secilin rast në lidhje me rezervimin dhe tregtimin e produkteve të kapacitetit në pikat e ankandit, duke përdorur platformën e rezervimit të kapacitetit;
 - (iii) në lidhje me komunikimet midis transportuesit dhe palëve të regjistruara dhe komunikimet ndërmjet palëve të regjistruara në secilin rast në lidhje me çështjet që nuk përmenden në paragrafët (i) ose (ii) më lart, duke përdorur platformën elektronike të të dhënave;
 - (iv) tregëtari/furnizuesi duhet të aksesojë lehtësisht sistemin përmes website të transportuesit
- d) Në mungesë të softuerit që mundëson komunikimet përmes Edig@s, komunikimet operacionale dhe ato në lidhje me këtë kod rrjeti, midis transportuesit dhe tregëtarëve/furnizuesve, duhet të kryhen përmes platformës elektronike të të dhënave.
- e) Subjekt i paragrafit (d) më lart, nëse ekziston një padisponueshmëri të përgjithësuar të ndonjë prej mjeteve të komunikimit të përmendura në paragrafin (a) më lart, komunikimet nën dhe në lidhje me këtë kod të rrjetit duhet të bëhen në rendin e përparësisë si më poshtë:
- f) Çdo komunikim i bërë duke përdorur një mjet komunikimi të përmendur në paragrafin (a), (d) ose (e) më lart do të konsiderohet të jetë bërë me shkrim për qëllimet e këtij kodi të rrjetit.
 - (i) me e-mail duke përdorur shabllonet dhe adresat e postës elektronike të publikuara në faqen e internetit të

transportuesit në kohën e shfaqjes së padisponueshmërisë (ose, për një tregëtar/furnizues, në adresën e postës elektronike të specifikuar në formularin e tij të regjistrimit ose adresën e tillë të azhornuar siç mund të jetë njoftuar për të tek transportuesi); dhe

- (ii) me faks duke përdorur çfarëdo lloj shablloni dhe numrat e faksit të publikuar në faqen e internetit të transportuesit në kohën e shfaqjes së padisponueshmërisë, e ndjekur, në rastin e secilit faks të tillë, me një telefonatë drejtuar transportuesit në numrin e telefonit të publikuar në faqen e internetit të transportuesit, në kohën e shfaqjes së padisponueshmërisë, duke njoftuar transportuesin se faksi i është dërguar atij.
- g) Nëse ka një padisponueshmëri të përgjithësuar të ndonjë prej mënyrave të komunikimit të përmendura në paragrafin (a), (d) ose (e) më lart, transportuesi do të informojë të gjithë tregëtarët/furnizuesit dhe palët e regjistruara (sipas rastit) për faktin se padisponueshmëria e tillë është në vazhdim e sipër dhe për kohëzgjatjen e asaj periudhe padisponueshmërie, transportuesi do të pranojë vetëm komunikimet e bëra duke përdorur mjetet e tjera të mundshme të komunikimit të specifikuar në paragrafin (d) ose (e) më lart.
- h) Pasi të ketë mbaruar një periudhë e padisponueshmërisë së përgjithshme të ndonjë prej mënyrave të komunikimit të përmendura në paragrafin (a), (d) ose (e) më lart, transportuesi do të njoftojë të gjithë Tregëtarët/Furnizuesit dhe Palët e Regjistruara (sipas rastit) se periudha e padisponueshmërisë ka përfunduar dhe, nga data e këtij njoftimi, komunikimet mund të rifillojnë duke përdorur mjetet e para të mundshme të komunikimit të specifikuar në paragrafin (a), (d) ose (e) më lart.
- i) Secila palë e regjistruar duhet të sigurojë që personi që ai ka nominuar në formularin e regjistrimit për të menaxhuar komunikimet e palës së regjistruar (ose ndonjë person pasardhës të njoftuar nga kjo palë e regjistruar tek transportuesi) është në dispozicion për të kontaktuar në mënyrë të vazhdueshme. Një alë e regjistruar mund të nominojë një firmë të shërbimeve profesionale si palë të tretë për të kryer këtë funksion.

21.2. Edig@s

- a) Transportuesi do t'i njoftojë me shkrim të gjitha palët e regjistruara nëse është lëshuar një version i azhornuar i Edig@s ose nëse është lëshuar një version i azhornuar i softuerit që mbështet Edig@s. Secila palë e regjistruar duhet të sigurojë që ka shkarkuar dhe do të jetë në gjendje të përdorë atë version të azhornuar të Edig@s ose softuerin mbështetës të Edig@s, siç mund të jetë rasti deri në një

datë që bie jo më vonë se 6 muaj pas datës së këtij njoftimi të transportuesit.

21.3. Platforma elektronike e të dhënave

- a) Transportuesi do të përdorë përpjekje të arsyeshme për ta vënë platformën elektronike të të dhënave në dispozicion të të gjitha palëve të regjistruara që kërkojnë qasje në platformën elektronike të të dhënave.
- b) Çdo palë e regjistruar që akseson platformën elektronike të të dhënave duhet të sigurojë që personeli i saj (ose personat që administrojnë komunikimet në emër të tij) të zotërojnë kompetencën teknike dhe përvojën e nevojshme për të komunikuar me saktësi duke përdorur platformën elektronike të të dhënave. Vetëm personat që kanë kaluar një test komunikimi do të lejohen të komunikojnë duke përdorur platformën elektronike të të dhënave në emër të një pale të regjistruar.
- c) Transportuesi do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar mbështetje teknike dhe testuese për palët e reja të regjistruar që kërkojnë të aksesojnë platformën elektronike të të dhënave.
- d) Transportuesi do t'i ofrojë të gjitha palëve të regjistruara që kërkojnë akses në platformën elektronike të të dhënave identifikime dhe fjalëkalime unike të përdoruesit, në mënyrë që të lehtësojë aksesin e palëve të tilla të regjistruara në platformën elektronike të të dhënave.
- e) Transportuesi do të vërë në dispozicion një manual përdorimi për platformën elektronike të të dhënave në faqen e tij të internetit dhe do të përdorë përpjekje të arsyeshme për ta mbajtur atë manual të përditësuar herë pas here.

22. MODIFIKIMI

22.1. Modifikimi i Kodit të Rrjetit

- a) Ky kod i rrjetit mund të modifikohet herë pas here në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen 22. Rrethanat në të cilat ky kod i rrjetit mund të modifikohet përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
- (i) kur transportuesit i kërkohet, ose zgjedh, të vërë në dispozicion kapacitetin e zgjerimit;
 - (ii) kur transportuesi synon të ndërtojë, ose të bëjë operacional, pika sistemi shtesë;
 - (iii) kur ka një ndryshim në sistemet e ndërlidhura që kërkon një ndryshim në procedurat e këtij kodi të rrjetit në mënyrë që transportuesi të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjeve të interkoneksionit, marrëveshjeve të balancimit operacional dhe këtij kodi të rrjetit.
 - (iv) kur ka një ndryshim në ligj, i cili ndikon në procedurat në këtë kod të rrjetit ose kërkon një modifikim të këtij Kodi të rrjetit në mënyrë që transportuesi të përmbushë detyrimet e tij sipas këtij kodi të rrjetit;
 - (v) me kërkesë të ERE-s ose
 - (vi) çdo situatë tjetër që transportuesi përcakton, duke vepruar si një operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm, ka rezultuar se është e nevojshme ose e dëshirueshme për të azhornuar ose modifikuar kodin e rrjetit në mënyrë që të lehtësojë ofrimin e shërbimeve të transportit.

22.2. Dorëzimi i kërkesave për modifikim

- a) Transportuesi ose një palë e regjistruar mund, në çdo kohë, të paraqesë një propozim për ndryshimin e këtij kodi të rrjetit duke dërguar një kërkesë për modifikim tek transportuesi.
- b) Çdo kërkesë modifikimi, përveçse nga ERE, duhet të:
- (i) specifikojë emrin e subjektit që bën kërkesën për modifikim, adresën e tij të regjistruar dhe emrin, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit të një personi kontakti që është përgjegjës për kërkesën për modifikim në subjektin që bën kërkesën për modifikim;
 - (ii) përmbajë një përshkrim sa më të plotë të ndryshimeve në kodin e rrjetit që janë duke u propozuar, së bashku me një

përshkrim të arsyeve teknike, operacionale ose tregëtare përse janë propozuar ato ndryshime;

- (iii) identifikojë se cilat nga objektivat e aplikueshëm të paraqitura në seksionin 22.3 do të përmbusheshin më mirë nga propozimi për modifikim; dhe
- (iv) specifikojë një datë të propozuar në të cilën ndryshimet e propozuara duhet të hyjnë në fuqi, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për të ndryshuar kodin e rrjetit dhe, në rastin e ndryshimeve të propozuara që mund të ndikojnë në funksionimin e sistemit të transmetimit, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për zbatimin e çdo ndryshimi të kërkuar në funksionimin e sistemit të transmetimit.

22.3. Vlerësimi i kërkesave për modifikim

- a) Transportuesi duhet të pranojë marrjen e një kërkesë për modifikim të paraqitur tek transportuesi nga ndonjë prej personave të përmendur në nenin 22.2 (a) (personi dorëzues) jo më vonë se [shtatë] ditë pas marrjes.
- b) transportuesi duhet, jo më vonë se [14] ditë pas marrjes:
 - (i) të pranojë marrjen e një kërkesë për modifikim; dhe
 - (ii) kur është e aplikueshme, marrjen e informacionit plotësues më të fundit të kërkuar nën paragrafin (d) më poshtë, të njoftojë personin dorëzues nëse ai:
 - A. do të përparojë kërkesën për modifikim, në këtë rast, transportuesi duhet t'i sigurojë personit dorëzues një kuadër kohor të vlerësuar për zbatimin e ndryshimeve të propozuara në kërkesën për modifikim; ose
 - B. refuzon kërkesën për modifikim, në këtë rast, transportuesi duhet të ofrojë arsyet për refuzimin e tij tek personi dorëzues dhe rregullatori.
- c) Në marrjen e vendimit të saj nëse ta përparojë apo refuzojë një kërkesë për modifikim sipas paragrafit (b) më lart, transportuesi duhet të marrë parasysh:
 - (i) konsistencën e ndryshimeve të propozuara në kërkesën për modifikim me ligjin në fuqi për sistemin e transmetimit dhe përjashtimin; dhe

- (ii) nëse një kërkesë për modifikim e ngjashme, ose thelbësisht e ngjashme, është dorëzuar më parë dhe vlerësuar në përputhje me këtë nen të kodit të rrjetit.
- d) Në varësi të paragrafit (e) më poshtë, në çdo kohë para afatit të përmendur në paragrafin (b) (i) më lart, transportuesi mund të kërkojë informacion shtesë ose sqarime nga Personi Dorëzues për sa i përket kërkesës për modifikim dhe personi dorëzues duhet të sigurojë menjëherë një informacion të tillë ose shpjegime që janë nën kontrollin e tij ose t'i konfirmojnë transportuesit që informacionet ose shpjegimet e tilla nuk janë nën kontrollin e tij.
 - e) Në vijim të kërkesës së parë për informacion ose shpjegim të bërë nën paragrafin (d) më lart në lidhje me një kërkesë për modifikim, transportuesi mund të bëjë kërkesa të mëvonshme për informacion ose shpjegime në lidhje me atë Kërkesë për modifikim pavarësisht afatit të përmendur në paragrafin (b) (i) më lart.
 - f) Kërkesat për modifikim që nuk janë refuzuar nga transportuesi do të vlerësohen nga paneli i modifikimit në mbledhjen e ardhshme në vijim të vendimit të transportuesit për të përparuar kërkesën për modifikim.
 - g) Paneli i modifikimit do të vlerësojë kërkesën për modifikim kundër objektivave të zbatueshëm në mënyrë që të vendosë nëse modifikimi duhet të bëhet.
 - h) Kur Paneli i modifikimit beson se kërkohet një analizë e mëtejshme përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikim, ai mund të ngrëjë një grup modifikimi të përbërë nga përfaqësues të tregëtarëve/furnizuesve dhe transportuesit së bashku me ekspertë të tillë që i gjykon të nevojshme për të hetuar më plotësisht çështjen.
 - i) Objektivat e zbatueshëm kundrejt të cilave duhet të vlerësohet çdo kërkesë për modifikim janë nëse modifikimi do të parashikonte më mirë për:
 - (i) funksionimin efikas dhe ekonomik të sistemit të transmetimit, duke përfshirë dekurajimin e keqpërdorimit të sistemit të transmetimit;
 - (ii) Funksionimi i koordinuar, efikas dhe ekonomik i të gjithë ose një pjese të sistemit të transmetimit;
 - (iii) shkarkimi efektiv i detyrimeve të të licencuarit;
 - (iv) sigurimi i konkurrencës efektive;

- (v) Sigurimi i stimujve të arsyeshëm ekonomik për tregëtarët/furnizuesit që të sigurojnë përmbushjen e standardeve të furnizimit;
 - (vi) Promovimi i efikasitetit në zbatimin dhe administrimin e kodit; dhe
 - (vii) Pajtueshmëria me ligjin, rregullat dhe rregulloret përkatëse.
- sesa formulimi ekzistues i kodit të rrjetit.

22.4. Konsultimi publik i modifikimit

- a) Nëse, sipas nenit 22.3 (b), transportuesi përparon një kërkesë për modifikim të bërë nga një personi dorëzues, transportuesi duhet të përgatisë një propozim për modifikim për konsultim publik, duke përmbledhur ndryshimet e propozuara në kodin e rrjetit, arsyetimin mbështetës për ato ndryshime, diskutimet e panelit të modifikimit dhe çdo grupi modifikimi dhe një kuadër kohor të parashikuar për zbatimin e këtyre ndryshimeve.
- b) Transportuesi duhet të publikojë propozimin për modifikim në faqen e tij të internetit për një periudhë konsultimi që zgjat për një minimum prej [30] ditësh radhazi dhe një maksimum prej [45] ditësh radhazi, siç vlerësohet e përshtatshme nga paneli i modifikimit në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të ndryshimeve të propozuara në kodin e rrjetit të përfshira në propozimin e modifikimit.
- c) Transportuesi duhet të vërë në dispozicion një formular përgjigje online së bashku me publikimin e propozimit të modifikimit dhe duhet të mbledhë çdo reagim të paraqitur nga personat e mëposhtëm në përgjigje të propozimit të modifikimit:
 - i) çdo palë e regjistruar; dhe
 - ii) çdo OST i Lidhur.

22.5. Procesi i miratimit

- a) Pas përfundimit të periudhës së konsultimit të përmendur në nenin 22.4 (b), transportuesi duhet të marrë në konsideratë çdo reagim të marrë prej tij nën nenin 22.4 (b) në përgjigje të propozimit të modifikimit dhe të përgatisë vendimin e tij përfundimtar nëse duhet të ndryshojë kodin e rrjetit dhe si ta ndryshojë kodin e rrjetit brenda [28] ditësh pas përfundimit të asaj periudhe konsultimi (vendimi përfundimtar i transportuesit).
- b) Transportuesi, brenda ose para afatit të përmendur në paragrafin (a) më lart, do t'i paraqesë rregullatorit dokumentet e mëposhtme

në mënyrë që ata të vlerësojnë vendimin përfundimtar të transportuesit.

- (i) kërkesën për modifikim;
 - (ii) propozimin e modifikimit;
 - (iii) çdo reagim të marrë nga transportuesi mbi propozimin e modifikimit gjatë periudhës së konsultimit të përmendur në nenin 22.4 (b); dhe
 - (iv) vendimin përfundimtar të transportuesit.
- c) Transportuesi do të kërkojë, në të njëjtën kohë kur të paraqesë dokumentet e përmendura në paragrafin (b) më lart, që rregullatori ose:
- (i) t'i sigurojë transportuesit ratifikimin e vendimit përfundimtar të transportuesit, përfshirë datën e zbatimit; ose
 - (ii) t'i kërkojë transportuesit të rishyrtojë dhe modifikojë vendimin përfundimtar të transportuesit.
- d) Nëse Rregullatori kërkon që vendimi përfundimtar i transportuesit të rishyrtohet dhe modifikohet, transportuesi do ta modifikojë atë dhe t'ia paraqesë vendimin përfundimtar të transportuesit rregullatorit dhe të kërkojë që rregullatori të ndërmarrë ndonjë nga veprimet e përcaktuara në paragrafët (i) ose (ii) më lart në lidhje me vendimin përfundimtar të transportuesit të modifikuar.

22.6. Ndryshimi i kodit të rrjetit

- a) Pas marrjes së një vendimi ratifikimi nga rregullatori sipas Nenit 22.5 (c), transportuesi duhet të ndryshojë kodin e Rrjetit në përputhje me atë vendim ratifikimi.
- b) Në datën e zbatimit, transportuesi duhet të publikojë kodin e rrjetit të modifikuar në faqen e tij të internetit, së bashku me një njoftim që përmbledh përmbajtjen dhe qëllimin e ndryshimeve të bëra në kodin e rrjetit.
- c) Çdo ndryshim në kodin e rrjetit të bërë në përputhje me këtë nen 22 do të jetë i detyrueshëm për transportuesin dhe të gjitha palët e regjistruara, pasi të publikohet sipas paragrafit (b) më lart.

22.7. Paneli i modifikimit

Paneli i modifikimit

- a) Paneli i modifikimit do të përbëhet nga:

- (i) kryetari i pavarur i emëruar nga [autoriteti / transportuesi];
 - (ii) dy përfaqësues të secilit prej transportuesve;
 - (iii) pesë (5) tregëtarë/furnizues dy përfaqësues të tregëtarëve/furnizuesve; dhe
 - (iv) Palë të tjera të tilla që autoriteti, mund të udhëzojë herë pas here.
- b) Paneli i modifikimit do të marrë parasysh ndryshimet e propozuara dhe të ndërmarrë funksione të tjera në lidhje me ndryshimet në kod, të cilat autoriteti mund t'i udhëzojë herë pas here.
 - c) Paneli i modifikimit do të marrë në konsideratë çdo modifikim të propozuar dhe do të konsultohet me çdo palë të tretë që paneli i modifikimit do ta konsiderojë të përshtatshme dhe me çdo person të cilin autoriteti do ta drejtojë, në lidhje me secilin modifikim të propozuar.
 - d) Mbështetja e sekretariatit për panelin e modifikimit do të sigurohet nga transportuesi dhe do të jetë një shpenzim i lejueshëm për përcaktimin e tarifës.

22.8. Modifikime urgjente

- a) Transportuesi ose tregëtari/furnizuesi mund t'i paraqesë autoritetit që një modifikim i propozuar kërkohet urgjentisht për të:
 - (i) përmbushur çdo kërkesë ligjore ose ndryshim në ligj ose rregullore që prek sistemin e transmetimit;
 - (ii) qenë në përputhje me pasojat e ndryshimeve në funksionimin normal të sistemit të transportit të tubacionit të gazit dhe / ose cilitdo sistem të lidhur; dhe / ose;
 - (iii) marrë parasysh përvojën në funksionimin, mirëmbajtjen dhe /ose përdorimin e sistemit të transportit të tubacionit të gazit dhe të sistemeve të transportit në përgjithësi, praktikat e mirë të industrisë dhe/ose ndryshimet në teknologji.
- b) Kur autoriteti është i bindur që modifikimi i propozuar kërkohet urgjentisht, autoriteti mund t'i referojë modifikimin e propozuar panelit të modifikimit të kodit dhe të udhëzojë që afatet kohore dhe përpunimi i modifikimit të dhënë në këtë nen duhet të ndryshojë në atë mënyrë që ai gjykon të përshtatshme pasi deklaron arsyet e tij.

23. NUK PËRDORET

24. REGJISTRIMET

24.1. Regjistri i pikës dalëse të sistemit

- a) Transportuesi krijon dhe mirëmban, ose siguron mirëmbajtjen e një regjistri ("regjistri i pikës së daljes të sistemit") që përmban detaje të secilës pikë daljeje të sistemit në përputhje me këtë nen.
- b) Në lidhje me secilën pikë daljeje të sistemit, regjistri i pikës së daljes të sistemit do të regjistrojë detajet që duhet të dorëzohen në lidhje me këtë pikë në një njoftim për regjistrimin e pikës së daljes.
- c) Për qëllimet e kodit, një "tregëtar/furnizuesi regjistruar" në lidhje me një pikë dalje të sistemit është tregëtar/furnizuesi në emrin e të cilit është regjistruar pika e daljes së sistemit në regjistrin e pikës së daljes së sistemit.
- d) Gazi i marrë nga sistemi i transmetimit në një pikë dalje të sistemit do t'i atribuohet tregëtarët/furnizuesit të regjistruar; dhe tregëtar/furnizuesi i regjistruar pranon për qëllimet e kodit përgjegjësinë për marrjen e gazit në pikën e daljes së sistemit nga vetë ai ose nga një person tjetër (pavarësisht nëse është i autorizuar apo jo nga tregëtar/furnizuesi i regjistruar).
- e) Transportuesi do të jetë përgjegjës për të dhënë njoftimin e regjistrimit të pikës së daljes, në përputhje me nenin 24.2 për atë pikë dalje të sistemit ku gazi natyror largohet nga sistemi i transmetimit dhe hyn në një sistem të shpërndarjes ose në një sistem të ndërlidhur.

24.2. Njoftim për regjistrimin e pikës dalëse

- a) Pa paragjykuar paragrafin (d), përpara se një tregëtar/furnizues të marrë gaz nga sistemi i transmetimit në një pikë dalje të sistemit (pavarësisht nëse tregëtar/furnizuesi i tillë është apo jo tregëtar/furnizuesi i parë që e bën këtë):
 - (i) Tregëtar/furnizuesi do t'i paraqesë transportuesit një njoftim ("njoftim i regjistrimit të pikës së daljes") në përputhje me paragrafin (b); dhe
 - (ii) Transportuesi do ta ketë njoftuar tregëtarin/furnizuesin se ka pranuar njoftimin e regjistrimit të pikës së daljes.
- b) Një Njoftim për regjistrimin e pikës dalëse do të specifikojë, pa paragjykuar paragrafin (d), në lidhje me pikën përkatëse të daljes nga sistemi:
 - (i) Numrin e identifikimit të matësit për instalimin e matësit;

- (ii) adresën në të cilën ndodhet instalimi i matësit dhe vëndndodhja e instalimit të matësit në adresë;
 - (iii) identiteti i tregëtarëve/Furnizuesve (dhe ID e tregëtarëve/furnizuesve) që paraqet njoftimin dhe në rastin e një njoftimi të paraqitur sipas Nenit 24.3, identitetin e tregëtarëve/furnizuesve të regjistruar, dëshmi se tregëtari/furnizuesi i regjistruar është i pranueshëm për transferim në pikën e daljes së sistemit dhe data në të cilën transferimi do të ketë efekt (e cila nuk duhet të jetë më e hershme se data e parashikuar në nenin 24.3);
 - (iv) lloji i Instalimit (ve) të matësit të instaluar në pikën e daljes së sistemit;
 - (v) arsyen e paraqitjes së njoftimit (në përputhje me nenin 24.3);
 - (vi) datën në të cilën gazi është marrë, ose propozohet të merret fillimisht nga tregëtari/furnizuesi nga sistemi i transmetimit në pikën e daljes së sistemit; dhe
 - (vii) datën në të cilën është lidhur, ose është propozuar ose është porositur lidhja me sistemin e transmetimit në pikën e daljes së sistemit.
- c) Transportuesi:
- (i) mund të refuzojë një njoftim të regjistrimit të pikës së daljes i cili nuk përputhet me kërkesat e paragrafit (b); dhe
 - (ii) do ta njoftojë tregëtarin/furnizuesin nëse e ka pranuar ose refuzuar njoftimin jo më vonë se tre (3) ditë pune pas dorëzimit të njoftimit nga tregëtari/furnizuesi.
- d) Kur një tregëtar/Furnizues paraqet njoftimin e regjistrimit të pikës së daljes për qëllimet e nenit 24.3, njoftimi specifikon identitetin e tregëtarëve/furnizuesve, ID e tregëtarëve/furnizuesve, numrin e identifikimit të matësit dhe detajet në lidhje me të cilat të dhënat e regjistruara në regjistrin e pikës së daljes së sistemit nuk janë më të sakta.

24.3. Njoftimi

- a) Një Tregëtari/Furnizuesi do t'i kërkohej të paraqesë një njoftim të regjistrimit të pikës së daljes:
- (i) në përputhje me paragrafin 24.2;
 - (ii) kur tregëtari/furnizuesi që paraqet njoftimin dëshiron të zëvendësojë tregëtarin/furnizuesin e regjistruar si të tillë (dhe tregëtari/furnizuesi ekzistues i regjistruar është i

- pranueshëm për të njëjtën gjë); kur ndonjë prej detajeve të paraqitura më herët në njoftimin e regjistrimit të pikës dalëse (kur janë paraqitur më parë nga tregëtari/furnizuesi) nuk janë më të sakta; dhe
- (iii) kur ndonjë nga detajet të dorëzuara në njoftimin e rregjistrimit të pikës dalëse (të dorëzuara më përpara nga tregëtari/furnizuesi) nuk janë më të sakta
 - (iv) kur propozohet që marrja e gazit në pikën e daljes së sistemit të ndërpritet.
- b) Një tregëtar/furnizues do t'i paraqesë transportuesit një njoftim për regjistrimin e pikës së daljes:
- (i) në rastin e paragrafit (a) (i), jo më vonë se dhjetë (10) ditë pune para ditës së parë në të cilën tregëtari/furnizuesi propozon marrjen e gazit në pikën e daljes së sistemit;
 - (ii) në rastin e paragrafit (a) (ii), jo më vonë se pesë (5) ditë pune para ditës së parë në të cilën tregëtari/furnizuesi propozon të bëhet tregëtar/furnizuesi regjistruar në lidhje me pikën e daljes së sistemit;
 - (iii) në rastin e paragrafit (a) (iii), jo më vonë se pesë (5) ditë pune para ditës së parë në të cilën tregëtari/furnizuesi dëshiron të ndryshojë detajet e regjistruara në regjistrin e pikës së daljes së sistemit; dhe
 - (iv) në rastin e paragrafit (a) (v), jo më vonë se pesë (5) ditë pune para ditës nga e cila tregëtari/furnizuesi propozon që marrja e gazit në pikën e daljes së sistemit të ndërpritet.
- c) Për njoftimet e paraqitura jo në përputhje me afatet e përcaktuara në paragrafët (b) dhe pa paragjykuar paragrafin 24.2, transportuesi mund të ushtrojë diskrecionin e miratimit rast pas rasti.
- d) Pas dorëzimit të një njoftimi regjistrimi të pikës dalëse, i cili nuk është refuzuar nga transportuesi, transportuesi do të:
- (i) ndryshojë regjistrin e pikës së daljes së sistemit për të pasqyruar detajet e përcaktuara në njoftimin e regjistrimit të pikës së daljes;
 - (ii) njoftojë tregëtarin/furnizuesin që paraqet njoftimin se regjistri i pikës së daljes së sistemit është ndryshuar; dhe
 - (iii) në rastin e paragrafëve (b) (ii) deri (b) (v), të njoftojë, kur është e nevojshme, tregëtarin/furnizuesin e regjistruar

ekzistues se regjistrimi i pikës së daljes së sistemit është ndryshuar.

- e) Kur një tregëtar/furnizuesparaqet një njoftim për regjistrimin e pikës së daljes, i cili është refuzuar nga transportuesi, tregëtari/furnizuesi mund, pa paragjykuar të drejtat e transportuesit nga paragrafi 24.2, të riparaqesë një njoftim të tillë.

24.4. Data

- a) Transportuesi do të mbajë të gjitha të dhënat që duhet të mbahen, ose të sigurojë se të gjitha të dhënat do të mbahen, në regjistrin e pikës së daljes së sistemit, në përputhje me këtë nen, për një periudhë prej dhjetë (10) vjetësh.

25. KËRKESAT PËR HYRJE DHE DALJE

25.1. Qëllimi

- a) Dispozitat e këtij neni do të zbatohen në lidhje me dorëzimin e gazit në sistemin e transmetimit në pikat e hyrjes të sistemit të transmetimit.
- b) Dispozitat e këtij neni do të zbatohen në lidhje me marrjen e gazit nga sistemi i transmetimit në pikat e daljes të sistemit.
- c) Tregëtarët/Furnizuesit që dorëzojnë gaz në sistemin e transmetimit në një pikë hyrëse të sistemit të transmetimit ose marrjen e gazit nga sistemi i transmetimit në një pikë daljeje të sistemit, do të jenë në përputhje me kërkesat përkatëse të këtij neni.
- d) Asgjë në kod nuk i jep asnjë personi të drejtë të ketë ndonjë tubacion, impiant ose instalim tjetër të lidhur me sistemin e transmetimit për qëllimet e furnizimit të gazit në sistemin e transmetimit ose marrjen e gazit nga sistemi i transmetimit.

25.2. Dispozitat e Matjes

- a) Çdo tregëtar/furnizues pranon që vlera kalorifike bruto (GCV), sasia dhe karakteristikat e gazit të dorëzuar ose të vënë në dispozicion për dorëzim ose marrje ose të vëna në dispozicion për marrje (nga tregëtarët/furnizuesit në total) nga sistemi i transmetimit në çdo pikë sistemi dhe pajtueshmërinë ose mospajtueshmërinë me kushtet e aplikueshme të hyrjes së gazit ose kërkesat e marrjes në lidhje me to, do të përcaktohen nga transportuesi dhe / ose OST-ja fqinje në përputhje me dispozitat e matjes në fuqi dhe me anë të pajisjeve matëse, dhe çdo tregëtar/furnizues pajtohet që të jetë i detyruar (për qëllimet të këtij kodi) me atë që është krijuar tashmë.
- b) Sasia e gazit e regjistruar në një pikë sistemi është vëllimi në total i matur nga pajisja matëse e shumëzuar nga vlera kalorifike bruto (GCV) në ato pika të sistemit.

25.3. Kërkesat për hyrje në sistem

- a) Një tregëtar/furnizues nuk mund të dorëzojë gaz në sistemin e transmetimit në çdo pikë hyrje të sistemit të transmetimit, përveç nëse ekziston një marrëveshje midis transportuesit dhe OST-së fqinje, që përmban, pa kufizime, dispozitat e Hyrjes në sistem që specifikojnë kërkesat (për qëllimet e këtij kodi) në lidhje me dorëzimin e gazit në sistemin e transmetimit të zbatueshme në lidhje me atë pikën hyrje të sistemit të transmetimit.
- b) Marrëveshja e përmendur në (a) mund të përmbajë dispozita të ndryshme nga dispozitat e hyrjes në sistem.

- c) Ekzistenca e një marrëveshjeje nuk do të çlirojë tregëtarët/furnizuesit nga çdo detyrim sipas këtij kodi, dhe transportuesit nuk do t'i kërkohet (për veten e tij ose në dobi të ndonjë tregëtari/furnizuesi) të sigurojë në ndonjë marrëveshje ndonjë zgjidhje kundrejt OST-së fqinje dhe as të marrë hapat për të zbatuar ndonjë dispozitë të një marrëveshjeje të tillë.
- d) Subjekt i paragrafit (e), transportuesi do të publikojë dispozitat e hyrjes në sistem dhe, subjekt i paragrafit 25.6, procedurat lokale të operimit të zbatueshme në çdo pikë hyrëse të sistemit të transmetimit, e cila është e lidhur me një sistem të ndërlidhur, por nuk do të kërkohet t'i sigurojë tregëtarëve/furnizuesve ose tregëtarëve/furnizuesve aplikues ndonjë detaj tjetër të një marrëveshjeje për hyrje në sistem.
- e) Paragrafi (d) nuk do të zbatohet për ndonjë dispozitë të veçantë të Dispozitave të Hyrjes në Sistem, të zbatueshme në bazë të Nenit 25.4 ose Procedurave Lokale të Operimit, kur dhënia e informacioneve shpjeguese për këtë dispozitë do të ishte me paragjykim material për interesat Tregëtare të OST-së Fqinje ose kur dispozita ose procedura përmban informacione personale ose konfidenciale që kanë të bëjnë me individët ose i referohet ndonjë marrëveshjeje tjetër në të cilën OST-ja Fqinje është palë.

25.4. Ndryshime në dispozitat e hyrjes në sistem

- a) Subjekt i nenit 25.5, dispozitat e hyrjes të sistemit në lidhje me çdo pikë hyrëse të sistemit të transmetimit, e cila është e lidhur me një sistem të ndërlidhur, nuk mund të modifikohen, përveçse me marrëveshje midis transportuesit dhe OST-së së fqinje përkatëse.
- b) Subjekt i nenit 25.5, transportuesi nuk do të pajtohet me ndonjë modifikim të dispozitave të hyrjes në sistem, përveçse me pëlqimin me shkrim të të gjithë tregëtarëve/furnizuesve, të cilët në datën kur do të hyjë në fuqi një ndryshim i tillë, kanë të drejta të kapacitetit të rezervuar, duke i lejuar ata të dorëzojnë gaz në pika e hyrjes së sistemit të transmetimit, e cila është e lidhur me një sistem të ndërlidhur.
- c) Dispozitat e tilla të hyrjes në sistem mund (në përputhje me dispozitat e marrëveshjes përkatëse) të ndryshohen pa miratimin e ndonjë tregëtari/furnizuesi, aq sa kërkohet për të mundësuar:
 - i) transportuesin; ose
 - ii) OST-në fqinje përkatëse, për të qenë në përputhje me kërkesat ligjore.
- d) Transportuesi do të njoftojë të gjithë dërguesit që mbajnë kapacitet, duke i lejuar ata që të dorëzojnë gaz në pikën e hyrjes së

sistemit të transmetimit, i cili është i lidhur me një sistem të ndërlidhur, për çdo modifikim në dispozitat e hyrjes në sistem, jo më vonë se data në të cilën hyn në fuqi një ndryshim i tillë.

25.5. Dispozitat e hyrjes në sistem

- a) Dispozitat e hyrjes në sistem duhet të:
- (i) identifikojnë sistemin e ndërlidhur (sipas emrin, vendndodhjes ose ndryshe);
 - (ii) specifikojnë pikën (at) e hyrjes në sistemin e transmetimit;
 - (iii) për pikën e hyrjes në sistemin e transmetimit, të specifikojnë dispozitat e matjes në përputhje me nenin 25.2 dhe procedurat lokale të operimit, në përputhje me paragrafin 25.8; dhe
 - (iv) identifikojë (nëpërmjet përshkrimit ose diagramave, ose të dyjave) pikën në të cilën gazi dorëzohet në sistemin e transmetimit.
- b) Dispozitat e hyrjes në sistem mund të specifikojnë (përveç nëse specifkohet ndryshe) procedurat lokale të operimit në përputhje me paragrafin 4.4.
- c) Dispozitat e hyrjes në sistem, pa kufizime, përfshijnë:
- (i) procedurat dhe standardet me të cilat do të mirëmbahet, riparohet dhe operohet sistemi i ndërlidhur, por vetëm atë sa procedurat dhe standardet e tilla janë materiale për aftësinë e transportuesit që të funksionojë me siguri, efikasitet dhe ekonomi sistemin e transmetimit ose në përputhje me çfarëdo kërkesë ose direktive ligjore;
 - (ii) termat që lejojnë transportuesin dhe OST-në Fqinje të kenë akses në objektet e njëri-tjetrit për qëllimin e verifikimit të pajtueshmërisë me kërkesat e dispozitave të hyrjes në sistem, ose që u kërkojnë atyre që të prokurojnë dhe lehtësojnë një kontroll teknik të një pajtueshmërie të tillë;
 - (iii) termat sipas të cilave, dhe rrethanat në të cilat lejohet të devijohet ose të largohet nga ndonjë dispozitë tjetër e hyrjes në sistem;
 - (iv) çdo term ose kusht tjetër që mund të jetë i përshtatshëm për qëllime të (por në përputhje me termat e) të këtij kodi në lidhje me dorëzimin e gazit në sistemin e transmetimit ose (në lidhje me këtë dorëzim) të sistemit të ndërlidhur;

- (v) procedurat e zbatueshme për flukset e gazit në rast të ndonjë rrethane emergjente që prek transportuesin ose OST-në fqinje; dhe
 - (vi) rrethanat në të cilat transportuesi ka të drejtë të refuzojë pranimin e dorëzimit të gazit nga tregëtarët/furnizuesit në sistemin e transmetimit në pikën e hyrjes në sistemin e transmetimit, përfshirë, pa kufizime, kur dispozitat e hyrjes në sistem për momentin nuk janë në pajtueshmëri ose në gjendje për që në pajtueshmëri (përveç se si rezultat i dështimit të transportuesit për të vepruar).
- d) Dispozitat e hyrjes në sistem mund të ndryshojnë midis pikave të ndryshme të hyrjes në sistemin e transmetimit të cilat janë të lidhura me objektet në drejtim të rrjedhës.

25.6. Procedurat lokale të operimit

- a) "Procedurat lokale të operimit" në lidhje me një pikë hyrje në sistemin e transmetimit i cili është i lidhur me një sistem të ndërlidhur janë procedurat e komunikimit, shkëmbimi i informacionit dhe bashkërendimi midis transportuesit dhe OST-së fqinje në lidhje me funksionimin e sistemit të ndërlidhur dhe pjesën e sistemit të transmetimit në të cilin është i lidhur, përfshirë si të përshtatshme dhe pa kufizime:
- (i) procedurat e sigurisë;
 - (ii) procedurat e mirëmbajtjes dhe riparimit;
 - (iii) procedurat e emergjencës;
 - (iv) pronësinë e aseteve dhe kufijtë;
 - (v) terminologjinë që do të përdoret (për të identifikuar impiantin);
 - (vi) diagramat që duhet të shkëmbehen dhe shfaqen në kantier;
 - (vii) emrat dhe numrat e telefonit të personelit kryesor të autorizuar; dhe
 - (viii) të drejtat e aksesit në vëndin (**site**) e sistemit të ndërlidhur për transportuesin.
- b) Me përjashtim të pëlqimit paraprak me shkrim të OST-së fqinje, transportuesi nuk duhet dhe nuk do të kërkohet t'i sigurojë ndonjë tregëtar/furnizuesi çdo informacion të dhënë nga OST-ja fqinje sipas procedurave lokale të operimit.

- c) Transportuesi mund të mbështetet në informacionin e dhënë prej OST-së fqinje në operimin dhe planifikimin e operimit të sistemit të transmetimit dhe për qëllimet e sigurimit të operimit të sigurt dhe të besueshëm të sistemit të transmetimit.

25.7. Tregëtar/Furnizues dorëzues dhe gaz i dorëzuar

- a) "Kushtet e hyrjes së gazit" në lidhje me të gjitha pikat e hyrjes në sistemin e transmetimit janë kufij ose kërkesa të tjera në lidhje me përbërjen, presionin, temperaturën dhe karakteristikat e tjera të gazit të dorëzuar në, ose të vendosur në dispozicion për dorëzim në sistemin e transmetimit në pikën e hyrjes në sistemin e transmetimit.
- b) Subjekt i ndonjë kërkesë ligjore në fuqi të re ose të ndryshuar (e cila do të rezultojë në një ndryshim të kushteve të hyrjes së gazit), kushtet e hyrjes së gazit mund të përfshijnë kufij, ndalime ose kërkesa në lidhje me vetitë që duhet të jenë në përputhje me specifikimet e zakonshme të gazit për sistemin e transmetimit të paraqitur në shtojcën 4.
- c) Subjekt i nenit 10, kur gazi dorëzohet nga më shumë se një tregëtar/furnizues në sistemin e transmetimit në një pikë hyrje të sistemit të transmetimit gjatë një periudhe balancimi, secili tregëtar/furnizuesi tillë do të konsiderohet se ka dorëzuar gaz me të njëjtat karakteristika si ai i dorëzuar, ose të vërë në dispozicion për dorëzim, në atë pikë hyrje të sistemit të transmetimit nga secili tregëtar/furnizues tjetër.

25.8. Përputhshmëria me kushtet e hyrjes së gazit

- a) Për qëllimet e këtij paragrafi 25.8:
- b) "Gaz jashtë-specifikimi" është gazi i furnizuar ose i disponueshëm për dorëzim në një pikë hyrëse të sistemit të transmetimit, në lidhje me të cilin ndonjë prej kushteve përkatëse të hyrjes së gazit nuk janë ose nuk ishin në përputhje; dhe
- c) Në përputhje me këtë paragraf 25.8, çdo tregëtar/furnizues do të sigurojë që i gjithë gazi i disponueshëm nga dorëzuesi për tu shpërndarë në një pikë hyrëse të sistemit duhet të jetë në pajtim me kushtet përkatëse të hyrjes së gazit ose, kur nuk përputhet, të trajtohet në përputhje me këtë nen dhe të njoftojë menjëherë transportuesin, sapo të bëhet i vetëdijshëm se gazi natyror që ka qenë, është ose do të vihet në dispozicion për dorëzim në emër të tij, nuk i përmbush kushtet përkatëse të hyrjes së gazit.
- d) Në përputhje me këtë paragraf 25.8, transportuesi do të sigurojë që i gjithë gazi i disponueshëm nga tregëtarët/furnizuesit për dorëzim në një pikë hyrëse të sistemit do të jetë në përputhje me kushtet

përkatëse të hyrjes së gazit, kur nuk janë përmbushur, do të trajtohet në përputhje me këtë nen.

- e) Nëse gazi është dorëzuar ose tenderuar për shpërndarje në një pikë hyrëse që nuk është në përputhje me specifikimin e gazit ("gaz jashtë-Specifikimit") transportuesi mund të, herë pas here, deri në kohën kur gazi që dorëzohet ose tenderohet për shpërndarje të përputhet me specifikimin e gazit, në diskrecionin e tij:
- (i) të refuzojë të pranojë ose ndërmarrë një veprim të tillë siç e konsideron të përshtatshme për të parandaluar dorëzimin ose dorëzimin e vazhdueshëm të të gjithë ose një pjese të gazit të tillë jashtë-specifikimit; ose
 - (ii) subjekt i ndonjë kërkesë ligjore ose udhëzimeve nga rregullatori ose ministria e qeverisë, pranojë dorëzimin e të gjithë ose një pjese të gazit të tillë jashtë-specifikimit.
- f) Të drejtat e transportuesit sipas paragrafit (j) nuk paragjykojnë nëse pranon dorëzimin e gazit për të cilin është i vetëdijshëm se është gaz jashtë-specifikimit.
- g) Kur, në ndonjë ditë, gazit jashtë-specifikimit është shpërndarë në sistemin e transmetimit në pikën e hyrjes, secili tregëtar/furnizues që merr një alokim në atë pikë hyrëse, do t'i paguajë transportuesit pjesën që alokimi i tij në pikën e hyrjes në atë ditë mbart në shumën e të gjitha alokimeve të tregëtarëve/furnizuesve në pikën e hyrjes të asaj dite të shumës së përcaktuar në paragrafin (k). Kur vetëm një tregëtar/furnizues ka alokime në një pikë hyrëse në ditë, ai do të mbartë të gjithë këtë shumë.
- h) Shuma e përmendur më lart do të jenë të gjitha kostot dhe shpenzimet e bëra në mënyrë të arsyeshme nga transportuesi si rezultat i dorëzimit të gazit jashtë-specifikimit, përfshirë ato në lidhje me:
- (i) pastrimin e ndonjë pjese të sistemit të transmetimit ose korrigjimin e ndonjë dëmi tjetër ndaj tij të shkaktuar nga pranimi i gazit jashtë-specifikimit;
 - (ii) marrjen e masave të arsyeshme për të siguruar që sistemi i transmetimit mund të operohet në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi ose standardin e njohur, pavarësisht shpërndarjes ose shpërndarjes së vazhdueshëm të këtij gazi jashtë-specifikimit; dhe/ose
 - (iii) marrjen e masave që kërkojnë në mënyrë të arsyeshme për sjelljen e këtij gazi jashtë-specifikimit brenda specifikimit të gazit.

- i) Kur transportuesi bëhet së pari i vetëdijshëm se gazi që po jepet është jashtë-specifikimit, ose është dorëzuar në sistemin e transmetimit në një pikë hyrëse, në ndonjë ditë të dhënë, transportuesi do të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur, tregëtarët/furnizuesit duke specifikuar:
- (i) ditën ose ditët në të cilat gazit jashtë-specifikimit i është dorëzuar sistemit të transmetimit;
 - (ii) detaje të arsyeshme për aspektin me të cilin gazi nuk përputhet me specifikimin e gazit;
 - (iii) detaje të arsyeshme të kostove dhe shpenzimeve të përmendura në paragrafin (k) dhe personin prej kujt dhe qëllimet për të cilat janë bërë; dhe
 - (iv) sasia e përgjithshme e gazit jashtë-specifikimit.
- l) Asnjë dështim i transportuesit për të njoftuar ndonjë tregëtar/furnizues nuk do të ndikojë në të drejtat e transportuesit sipas këtij neni 25.8.

25.9. Lidhjet e marrjes (offtake)

- a) Transportuesi do të zhvillojë, publikojë dhe zbatojë detyrimet e tij sipas një procedurë shtesë të kodit të titulluar "procedura e operimit për lidhjen e gazit" e cila përshkruan proceset, afatet kohore, kërkesat teknike, rregullatore dhe dokumentare, dhe produktet për lidhjen e instalimit të gazit të një konsumatori përfundimtar në një pikë daljeje.
- b) Një tregëtar/furnizues nuk ka të drejtë të marrë gaz nga sistemi i transmetimit në një pikë daljeje, përveçse nëse tregëtari/furnizuesi i tillë mban kapacitetin e nxjerrë në bazë të nenit 6, në lidhje me pikën e tillë të daljes.
- c) Një tregëtar/furnizues nuk ka të drejtë të marrë gaz në një pikë dalje përveçse nëse ai tregëtar/furnizues është i regjistruar në lidhje me pikën e daljes, në përputhje me nenin 24.
- d) Një tregëtar/furnizues që dëshiron të marrë gaz në një pikë daljeje për herë të parë, do të aplikojë tek transportuesi në lidhje me këtë pikë daljeje, në përputhje me procedurën operative për lidhjen e gazit dhe këtë paragraf. Transportuesi mundet, pas një vlerësimi nga transportuesi i një kërkesë të tillë nga tregëtari/furnizuesi, duke përfshirë nëse ekziston një kapacitet i mjaftueshëm në sistemin e transmetimit për të përmbushur kërkesat e rrjedhës dhe presionit të kërkuara nga tregëtari/furnizuesi i tillë në aplikimin e tij, të konfirmojë aplikimin e tregëtarëve/furnizuesve në lidhje me pikën e tillë të daljes, duke specifikuar, ndër të tjera, sa vijon:

- (i) identitetin e tregëtarëve/furnizuesve dhe ID-në e tregëtarëve/furnizuesve;
- (ii) pika e daljes me të cilën lidhet një regjistrim i tillë;
- (iii) kur është e aplikueshme, emrin e konsumatorit përfundimtar dhe adresën e objektit përkatës të konsumatorit përfundimtar të lidhur në pikë daljeje;
- (iv) pikën e saktë të marrjes nga sistemi i transmetimit;
- (v) informacion përmbledhës i impiantit të gazit dhe pajisjeve të instaluara në pikën e daljes;
- (vi) presioni minimal i kërkuar i marrjes në pikën e daljes ("presioni minimal i kërkuar i marrjes"); dhe
- (vii) norma maksimale e rrjedhës së menjëhershme me të cilën tregëtari/furnizuesi i tillë është i lejuar të marr gaz në atë pikë daljeje ("norma maksimale e marrjes së menjëhershme").

25.10. Të drejtat sipas ligjit

- a) Asgjë në këtë kod nuk e ndalon transportuesin të ushtrojë ndonjë të drejtë ose të shkarkojë ndonjë detyrë sipas ligjit ose në përputhje me licencën e tij të transportuesit ose ndonjë kërkesë tjetër ligjore që mund të përfshijë shkëputjen nga, ose refuzimin e transportimit të gazit, ose lejimin e transportimit të gazit në çdo objekt.
- b) Kur në bazë të ligjit ose në përputhje me licencën e transportuesit, transportuesit nuk i kërkohet të lidhë ose të mbajë një lidhje, të ushtrojë ose ka të drejtë të ushtrojë ndonjë të drejtë për t'u shkëputur, ose kërkohet të shkëputet, nga ndonjë objekt, ose (pasi i ka shkëputur ato) nuk i kërkohet që të lidhin përsëri objektet, ose ka të drejtë të refuzojë transportin e gazit ose të lejojë që gazi të transportohet në ndonjë objekt, transportuesi nuk do të jetë në shkelje të detyrimit të tij për të vënë në dispozicion gazin për marrje nga sistemi i transmetimit në pikën (pikat) e daljes së sistemit përkatës.
- c) Transportuesi do të informojë tregëtarin/furnizuesin e regjistruar në një pikë daljeje të sistemit, sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme pasi të ketë ushtuar një të drejtë (siç përshkruhet në paragrafin (b) të shkëputet ose të refuzojë transportimin e gazit ose të lejojë transportimin e gazit.

25.11. Kërkesat për marrjes

- a) Për qëllimet e këtij kodi, dhe në bazë të paragrafit (b), "kërkesat për marrje **offtake requirements**" në lidhje me një pikë daljeje të sistemit janë kufijtë ose kërkesat e tjera për përbërjen, presionin, temperaturën dhe karakteristikat e tjera të gazit të marrë nga sistemi i transmetimit në atë pikë daljeje të sistemit.
- b) Subjekt i ndonjë kërkesë ligjore të re ose të ndryshuar (e cila do të rezultojë në ndryshimin e kërkesave për marrje) kërkesat për marrje duhet të jenë në përputhje me parametrat e specifikimit të zakonshëm të gazit, të përcaktuara në shtojcën 4.
- c) "Presioni i marrjes" është presioni nominal i gazit i vënë në dispozicion për marrjen nga sistemi i transmetimit në një pikë daljeje të sistemit të transmetimit ose pikës së daljes së sistemit të lidhur.
- d) Transportuesi do ta vërë gazin në dispozicion për marrje nga sistemi i transmetimit në një pikë daljeje dhe/ose në një pikë pnterkoneksioni me një presion minimal ("presioni minimal i transmetimit") i matur në pikën përkatëse të daljes prej jo më pak se nje shufër (shirit) [xx].
- e) Subjekt i paragrafit (f), transportuesi do të vërë gazin në dispozicion për marrje në një pikë daljeje të sistemit të transmetimit ose në pikën e interkoneksionit në presionin minimal të transmetimit.
- f) Një Transportues nuk duhet të:
 - (i) ndryshojnë shkallën që merr gaz nga ndonjë pikë daljeje për më shumë sesa norma e devijimit në lidhje me atë pikë daljeje të përcaktuar në shtojcën 4; ose
 - (ii) tejkalojë normën maksimale të marrjes përsa i përket çdo pike daljeje siç përcaktohet në shtojcën 4.
- g) nëse një tregëtar/furnizues:
 - (i) merr me një normë që tejkalon normën e tillë të devijimit; ose
 - (ii) tejkalon normën e tillë maksimal të marrjes;

Transportuesi mund të ndërmarrë çdo hap në dispozicion të tij për të siguruar një ulje të normës së marrjes së gazit nga sistemi i transmetimit në pikën e daljes nga transportuesi ose ta ndërpresë atë.

- h) Transportuesi nuk do të shkelë të detyrimin e tij për të vënë në dispozicion gazin për marrje nga pika e daljes së sistemit të transmetimit nëse një dështim i tillë është për shkak të ndonjë arsye që nuk i atribuohet veprimeve ose mosveprimeve të transportuesit, përfshirë këtu edhe kur presioni i përgjithshëm në rrjetin e transportit bie nën presionin e tij normal të funksionimit.
- i) Transportuesi do të përdorë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar tregëtarët/furnizuesit sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme pasi transportuesi të jetë i vetëdijshëm se presioni i rrjetit të gazit në dispozicion në pikën e daljes së sistemit është ulur ose do të ulet nën presionin minimal të transmetimit.
- j) Asgjë në këtë paragraf 25.11 nuk do të interpretohet se kërkon që transportuesi të vërë në dispozicion gazin për marrje në pikën e daljes së sistemit të transmetimit në çdo presion nominal të kërkuar nga tregëtari/furnizuesi i regjistruar.
- k) Transportuesit do t'i kërkohe vetëm që të vendose gazin në dispozicion për marrje në pikën e daljes së sistemit të transmetimit me një normë uniforme.

25.12. Specifikimi i gazit në dalje

- a) Me kusht që i gjithë gazi i dorëzuar në sistemin e transmetimit të jetë në përputhje me specifikimin e gazit, transportuesi do të përpiqet të sigurojë gazin në dispozicion për marrje në përputhje me specifikimin e gazit.
- b) Nëse i gjithë gazi i furnizuar në sistemin e transmetimit është në përputhje me specifikimin e gazit, por nuk përputhet me specifikimin e gazit kur vihet në dispozicion për marrje nga një tregëtar/furnizues nga sistemi i transmetimit në një pikë daljeje ("gaz jashtë-specifikimit"), tregëtari/furnizuesi mund, kohë pas kohe, deri në kohën kur gazi i vënë në dispozicion për marrje të jetë në përputhje me specifikimin e gazit, në diskrecionin e tij:
 - (i) të marrë ose të vazhdojë të marrë gazit të tillë jashtë-specifikimit; ose
 - (ii) të refuzojë marrjen ose vazhdimin e marrjes së gazit të tillë jashtë-specifikimit.
- c) Kur gazi jashtë-specifikimit është marrë në ndonjë ditë nga sistemi i transmetimit, përgjegjësia e transportuesit ndaj secilit tregëtar/furnizues do të kufizohet në një sasi të përcaktuar në përputhje me paragrafin (d).
- d) Shuma e pagueshme nga transportuesi për një tregëtar/furnizues në bazë të këtij neni 25.12 do të jetë më e vogla e:

- (i) çdo kosto dhe shpenzim i arsyeshëm të bëra siç duhet nga tregëtari/furnizuesi si rezultat i marrjes së gazit jashtë-specifikimit nga tregëtari/furnizuesi në një pikë daljeje; dhe
- (ii) një shumë e barabartë me x milion lekë.

26. PLANIFIKIMI I SISTEMIT

26.1. Përgatitja e planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit

- a) Deri në datën 30 qershor të çdo viti, transportuesi do të hartojë dhe paraqesë për konsultim publik një draft plan për zhvillimin e rrjetit të transmetimit për dhjetë (10) vitet e ardhshme.
- b) Për të përgatitur një draft plan të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, transportuesi duhet të marrë parasysh:
 - (i) informacionin për pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, si dhe informacionin mbi infrastrukturën kryesore të transmetimit që duhet të ndërtohet ose azhurnohet gjatë 10 (dhjetë) viteve të ardhshme;
 - (ii) të përfshijë të gjitha investimet e miratuara tashmë dhe të identifikojë investimet e reja që duhet të kryhen në tre vitet e ardhshme;
 - (iii) të sigurojë një kuadër kohor për të gjitha projektet e investimeve.
- c) Gjatë hartimit të planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, transportuesi do të bëjë supozime të arsyeshme në lidhje me prodhimin, furnizimin, konsumin dhe shkëmbimin e gazit natyror me vendet e tjera, duke marrë parasysh planet e investimeve për rrjetet përreth, si dhe planin e investimit për objektet e ruajtjes dhe ri-gazifikimi GNL.
- d) Rregullatori do të shqyrtojë nëse plani i zhvillimit të rrjetit të transmetimit dhe nëse konstaton se jo të gjitha nevojat për investime janë identifikuar gjatë procesit të konsultimit, mund të kërkojë që transportuesi të ndryshojë planin e tij të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.
- e) Rregullatori do të aprovojë planin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit deri në datën 31 tetor dhe do të vazhdojë të monitorojë vlerësoje zbatimin e planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

26.2. Dispozitat e informacionit për transportuesin

- a) Për hartimin, zhvillimin dhe funksionimin e sistemit të transmetimit, në përputhje me këtë seksion ose pas një kërkesë të transportuesit, deri më 31 mars të çdo viti:
 - (i) Konsumatorët e gazit natyror, objektet e të cilëve janë të lidhura drejtpërdrejt me sistemet kombëtare të transmetimit të gazit natyror (NNGTS) dhe Operatorët e rrjeteve të shpërndarjes duhet t'i sigurojnë transportuesit vlerësimet e

tyre më të mira të mundshme për çdo vit dhe për dhjetë (10) vitet e ardhshme në lidhje me sasinë maksimale ditore dhe sasinë vjetore të gazit natyror të kërkuar për nevojat e tyre.

- (ii) Operatorët e rrjeteve të shpërndarjes duhet të sigurojnë informacionin e lartpërmendur në lidhje me shërbimin e nevojave të konsumatorëve të cilët janë të lidhur ose që do të lidhen me të, si dhe numrin e lidhjeve ekzistuese dhe të ardhme, për pikën e daljes së rrjetit të shpërndarjes dhe për kategorinë e konsumit të gazit natyror, si minimum për kategoritë e konsumit të ngrohjes për rezidencat dhe bizneset, pjesën tjetër të sektorit familjar dhe atë të biznesit, sektorin industrial dhe sektorin automobilistik. Ata gjithashtu duhet të japin informacionin e lartpërmendur për çdo muaj të vitit të ardhshëm.
 - (iii) Përdoruesit duhet t'i sigurojnë transportuesit vlerësimet e tyre më të mira të mundshme për çdo vit dhe për dhjetë (10) vitet e ardhshme në lidhje me sasinë Maksimale ditore dhe sasinë vjetore të gazit natyror të cilin ata do ta transmetojnë nëpërmjet sistemit të transmissioinit si më poshtë:
 - A. për pikën e hyrjes ekzistuese ose të ardhshme,
 - B. për pikën e daljes ekzistuese ose të ardhshme,
 - C. për pikën e interkoneksioinit ekzistuese ose të ardhshme, për kalimin e gazit natyror.
- b) Informacioni që i jepet transportuesit, sipas këtij neni, do të përdoret si të dhëna për hartimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit dhe ato konsiderohen konfidenciale. Vlerësimet që duhet të jepen sipas paragrafit (a) nuk do të jenë detyruese për ofruesit e informacionit ose për transportuesin. Transportuesi është përgjegjës për t'i siguruar rregullatorit qasje në këto të dhëna.

27. TË PËRGJITHSHME

27.1. Ligji drejtues

- a) Ky Kod i Rrjetit dhe çdo detyrim jo-kontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me të do të qeveriset dhe do të interpretohet dhe shpjegohet në përputhje me ligjin shqiptar, duke përjashtuar....

27.2. Përgjegjësia

- a) Transportuesi, në masën maksimale të lejuar me ligj, nuk do të ketë përgjegjësi, qoftë për shkelje të kontratës, përgjegjësi jashtë-kontraktore ose për çdo humbjeje, dëm ose përgjegjësi tjetër që ndonjë Person ka marrë nën ose në lidhje me këtë kod të rrjetit, përveç nëse është shkaktuar nga mosveprimi i qëllimshëm i transportuesit.

27.3. Mosmarrëveshjet që do të zgjidhen nga autoritetet rregullatore

- a) Një mosmarrëveshje në lidhje me LT UIOLI për të cilën është lëshuar një njoftim për kërkesë do të zgjidhet në përputhje me një vendim rregullator.
- b) Çdo mosmarrëveshje tjetër që përfshihet në fushën e vendimit të përbashkët të lëshuar në bazë të nenit 4.8.2 të Opinionit përfundimtar të përbashkët, do të zgjidhet në përputhje me atë vendim të përbashkët.

27.4. Mosmarrëveshjet që lidhen me kodin e rrjetit

- a) Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje midis transportuesit dhe një palë të regjistruar (palët) në lidhje me këtë kod të rrjetit që nuk bën pjesë në nenin 27.3 ose 27.4, palët duhet të, brënda 10 ditëve nga shërbimi i një njoftimi me shkrim nga njëra palë për alën tjetër (një njoftim për mosmarrëveshje), të zhvillojnë një takim në përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Secila palë duhet të dërgojë një përfaqësues për të marrë pjesë në atë takim i cili ka autoritetin për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 30 ditëve nga dërgimi i një njoftimi për mosmarrëveshje, pavarësisht nëse është mbajtur një takim apo jo, atëherë do të zbatohen paragrafët (b) deri në (f) më poshtë.
- b) Çdo mosmarrëveshje që nuk zgjidhet ndryshe në pajtim me paragrafin (a) më lart do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht në pajtim me rregullat e arbitrazhit të dhomës ndërkombëtare të tregtisë siç është në fuqi në datën në të cilën kërkesa për arbitrazh është parashtruar në përputhje me ato rregulla (rregullat).
- c) Numri i personave të arbitrimin do të jetë tre persona, të caktuar në përputhje me rregullat.

- d) Selia ose vendi ligjor i arbitrazhit do të jetë Vjena.
- e) Gjuha e procedurave të arbitrimit do të jetë gjuha Angleze. Të gjitha dokumentat e paraqitura në lidhje me procedurat do të jenë në gjuhën angleze, ose, nëse janë në një gjuhë tjetër, duhet të shoqërohen nga përkthimi në gjuhën Angleze.
- f) Shërbimi i çdo kërkesë për arbitrim bërë në bazë të këtij neni 23.5 do të jetë me postë të regjistruar, në rastin e transportuesit, adresën e korporatës së transportuesit siç është publikuar në faqen e internetit të transportuesit në atë kohë dhe në rastin e një pale të regjistruar, në adresën më të fundit të asaj ale të regjistruar që i është njoftuar transportuesit nga ajo Palë e regjistruar sipas këtij kodi të rrjetit.

27.5. Taksat etj.

- a) Një tregëtar/furnizues do të jetë përgjegjës për pagesën e taksave, detyrimeve ose tatimeve të tjera që i janë ngarkuar transportuesit, pavarësisht nëse në momentin e hyrjes në këtë kod, në lidhje me dorëzimin, transportin, marrjen, furnizimin ose dispozitat e tjera të gazit të tij në lidhje me këtë kod, përveç taksës së korporatës që paguhet nga transportuesi.
- b) Për shmangien e dyshimit, transportuesi dhe operatorët e ndërlidhësve të sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, janë të përjashtuar nga çdo aplikim i taksave ose tarifave të përcaktuara nga pushteti vendor mbi pasuritë, rrjetet dhe instalimet përkatëse që u përkasin atyre operatorëve sipas ligjit për sektorin e gazit natyror.

27.6. Konfidencialiteti

- a) Në këtë Kod,
 - (i) "Informacion konfidencial" do të thotë:
 - A. në lidhje me transportuesin:
 - I. çdo informacion në lidhje me punët e një tregëtari/furnizuesi; ose
 - II. kushtet e çdo marrëveshjeje shtesë (përveç kodit) në lidhje me secilin tregëtar/furnizues; dhe
 - B. në lidhje me tregëtarin/furnizuesin, çdo informacion në lidhje me transportuesin ose tregëtar/furnizues tjetër, ose kushtet e ndonjë marrëveshjeje shtesë (përveç kodit),

të marra në lidhje me këtë Kod, përveç kushteve të tij, i cili për shmangien e dyshimit përfshin (por nuk kufizohet në) informacione të marra nga një OST Fqinje ose Operatori i Platformës së Kapacitetit;

- (ii) "Palë Zbuluese " nënkupton Palën që zbulon informacionin konfidencial tek një Pale Pritëse;
 - (iii) "Qëllimi i lejuar" do të thotë çdo qëllim që lidhet me pjesëmarrjen e një Pale në këtë Kod, duke përfshirë në lidhje me përgatitjen e Planit të Zhvillimit të Sistemit të Transmetimit; dhe
 - (iv) "Pala Pranuese" do të thotë Pala tek e cila zbulohet Informacioni Konfidencial nga një Palë Zbuluese
- b) Një Palë Pranuese nuk do të shpalosë asnjë informacion konfidencial ndaj ndonjë personi tjetër, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin (b) dhe (d), ose të përdorë ndonjë informacion konfidencial, përveç se për qëllimin e lejuar, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës Zbuluese.
- c) Paragrafi (b) nuk do të zbatohet për asnjë informacion konfidencial i cili:
- (i) në, ose pas, momentit të publikimit bëhet pjesë e fushës së përgjithshme (**public domain**) (për çdo arsye tjetër përveç shkeljes së këtij kodi nga pala pranuese);
 - (ii) njihet nga pala pranuese në kohën kur merr informacionin konfidencial (përveç rastit kur informacioni njihet nga pala pranuese si rezultat i një zbulimi të mëparshëm të tij nga pala zbuluese);
 - (iii) është marrë në mënyrë të ligjshme nga pala pranuese nga një palë e tretë jo në shkelje të një detyrimi të konfidencialitetit;
 - (iv) kërkohet të shperndahet tek nje transportues fqinje në një pikë interkonjeksioni.
- d) Një palë pranuese mund të zbulojë informacionin konfidencial pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës zbuluese:
- (i) për çdo punonjës, oficer, drejtor, këshilltar profesional dhe konsulent të palës pritëse në masën që zbulimi është i nevojshëm në lidhje me qëllimin e lejuar;
 - (ii) tek çdo filial, ose cilindo person që zotëron më shumë se 25% të kapitalit aksionar të lëshuar të palës pranuese ose

ndonjë prej Filialeve të atyre personave, deri në masën që zbulimi është i nevojshëm në lidhje me qëllimin e lejuar;

- (iii) tek çdo transferues i besueshëm në të ardhmen që zotëron më shumë se 25% të kapitalit aksionar të lëshuar të palës pranuese ose ndonjë prej filialeve të tij;
- (iv) tek çdo bankë ose institucion financiar nga i cili Pala Pranuese po kërkon ose po merr fonde në atë masë që zbulimi është i nevojshëm në lidhje me një financim të tillë;
- (v) çdo personi të caktuar si ekspert në përputhje me këtë kod në masën e nevojshme në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e detyrave të tij në masën që kërkohet me ligj ose me urdhrin e çdo gjykate kompetente mbi palën pranuese ose rregulloret e një burse të njohur ose e kërkuar nga ndonjë autoritet kompetent; dhe
- (vi) në masën që kërkohet me ligj ose me urdher të ndonjë gjykate që ka juridiksion kompetent mbi palën pranuese ose rregulloret e një burse të njohur ose të kërkuar nga ndonjë autoritet kompetent.

e) Një palë pranuese do të:

- (i) sigurojë që çdo person tek i cili pala pritëse zbulon informacionin sipas paragrafit (d) (i) deri (vi) të veprave në përputhje me detyrimet e paragrafëve (a) deri (g) sikur ky person të ishte një palë në masën më të plotë mundur; dhe
- (ii) marrë nga çdo person tek i cili pala pranuese zbulon informacionin nën paragrafin (d) (iii) deri në (v) një marrje përsipër në favor të palës zbuluese për ta bërë këtë.

f) Transportuesi mund të zbulojë Informacionin Konfidencial pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës Zbuluese për:

- (i) një transportues fqinje, kur një zbulim i tillë parashikohet ose justifikohet nga ky kod ose marrëveshja e interkoneksionit; dhe
- (ii) Operatorin e platformës së kapacitetit dhe në këtë rast do të zbatohet neni 6.

g) Nëse një palë pushon ose vazhdon të jetë e detyruar nga ky kod, detyrimet e saj të konfidencialitetit, sipas këtij kodi, do të qëndrojnë në fuqi në lidhje me çdo informacion konfidencial derisa informacioni i tillë të jetë ifushës së përgjithshme (public domain) ose të merret, bëhet i ditur ose zhvillohet nga pala pranuese përkatëse në përputhje me paragrafin (c).

- h) Çdo e dhënë që përpunohet, regjistrohet ose mirëmbahet në lidhje me sistemin e transmetimit që i përket transportuesit, dhe është subjekt i dispozitave të këtij kodi, transportuesi mund të përdorë të dhëna të tilla në atë mënyrë që transportuesi e shoh të arsyeshme përfshirë dhënien e të dhënave për platformën e transparencës së krijuar nga ENTSOG.
- i) Nëse një tregëtar/furnizuesi i siguron transportuesit të dhëna, atëherë tregëtari/furnizuesi i jep transportuesit një licencë të përhershme jo-ekskluzive, pa privilegje, në lidhje me të dhënat e tilla dhe të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të tyre për të përdorur, kopjuar, miratuar dhe trajtuar të dhëna të tilla për qëllimet e performancës dhe zbatimit të këtij kodi dhe qëllimeve të tjera të parashikuara nga ky kod por jo ndryshe. Paragrafi (h) vlen për çdo të dhënë që rrjedh nga të dhëna të tilla dhe të gjitha përpunimet që krijohen nga ose në emër të transportuesit të të dhënave të tilla.
- j) Nëse Transportuesi siguron ose vë në dispozicion të dhëna një tregëtar/furnizues, transportuesi ka të drejtë të përdorë të dhëna të tilla pa pagesë për qëllimet e performancës dhe zbatimit të këtij kodi dhe për qëllime të tjera të parashikuara nga ky kod, por jo ndryshe.

27.7. Delegimi

- a) Në varësi të paragrafit (d) dhe (e) një tregëtar/furnizues mund t'ia delegojë të drejtat e tij sipas këtij kodi:
 - (i) një Filiali (përkufizimi i filialit do të ndryshohet për këto qëllime në mënyrë që një përqindje aksionare prej 33 1/3% të konsiderohet se është kontrollues i tregëtarëve/furnizuesve), me kusht që tregëtari/furnizuesi delegues të vazhdojë të jetë i detyruar dhe përgjegjës sipas këtij kodi;
 - (ii) subjekt i paragrafit (e) me marrëveshjen paraprake me shkrim të Transportuesit, i cili nuk do të mbahet në mënyrë të paarsyeshme, për çdo person.
- b) Me përjashtim të parashikimeve të paragrafit (a), ose siç është parashikuar ndryshe në këtë kod, një tregëtar/furnizues nuk do të delegojë ose transferojë dhe nuk do të ketë qëllim të delegojë ose transferojë ndonjë prej të drejtave ose detyrimeve të tij sipas këtij kodi.
- c) Asnjë delegim nuk mund t'i bëhet një personi përveç nëse, kur tregëtari/furnizuesi delegues ka një regjistrim të pikës së hyrjes ose një regjistrim të pikës së daljes në lidhje me një pikë interkoneksioni ose një pikë daljeje në sistemin e transmetimit, ai person është i licencuar në mënyrë të duhur;

- d) Kur një tregëtar/furnizues ia delegon të drejtat e tij sipas këtij kodi një personi (duke përfshirë një filial me 33 1/3%), në përputhje me paragrafin (a), ai do të jetë një kusht paraprak i një delegimi të tillë që personi i tillë:
- (i) të lidhë një marrëveshje në formën e përshkruar me transportuesin duke rënë dakord të jetë i detyruar nga ky kod;
 - (ii) të plotësojë kërkesat e nenit 3.1 (b) të këtij kodi
- e) Kur një delegues ia delegon të drejtat e tij sipas këtij kodi një personi në pajtim me paragrafin (a) tregëtar/furnizuesi delegues do të lirohet nga detyrimet e tij sipas këtij kodi që lindin pas kohës në të cilën delegimi është efektiv, por do të mbetet përgjegjës për çdo detyrim të mbledhur deri në atë kohë.
- f) Një referencë në këtë kod për një transportues do të përfshijë një referencë për delegimet e atij transportuesi.

27.8. Forcë madhore

- a) Palët kontraktore lirohen nga detyrimet e tyre për mospërbushje ose përmbushje me vonesë të detyrimeve të tyre, nëse mospërbushja, ose përmbushja me vonesë është rezultat i forcës madhore, për sa i përket ligjit për sektorin e gazit natyror.
- b) Për shmangien e dyshimit, forca madhore e cila shkakton çlirimin nga detyrimet që palët kanë pranuar në bazë të këtij kodi rrjeti duhet të lidhet vetëm me funksionimin e sistemit të transmetimit dhe/ose disponueshmërinë e kapacitetit të sistemit të transmetimit.
- c) Një ngjarje e forcave madhore që ka të bëjë me gazin në çfarëdo mënyre (përfshirë për shembull cilësinë, disponueshmërinë ose mungesën e gazit) nuk e liron transportuesin ose tregëtarin/furnizuesin nga detyrimet e tjera të pranuar sipas kushteve të kodit të rrjetit.
- d) Në rast të një ngjarje të forcës madhore, pala kontraktuese e prekur nga forca madhore duhet të njoftojë palën tjetër kontraktuese pa vonesë për ndodhjen e rrethanave që ai konsideron se është një forcë madhore dhe në hapat që po ndërmerr për të lehtësuar ose larguar pasojat e forcës madhore.
- e) Nëse, për shkak të një forcëmadhore, vonesa në përmbushje ose pamundësia për të përmbushur detyrimet kontraktuale të një pale zgjat më shumë se 30 ditë rresht, palët kontraktuese do të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur negociatat për të gjetur një zgjidhje e cila është e pranueshme për të dyja palët kontraktuese.

- f) Në rast se nuk arrihet një marrëveshje, brënda një afati 15-ditor shtesë, të dyja palët kanë të drejtë të tërhiqen nga Kodi i Rrjetit, në rastin e një tregëtari/furnizuesi, ose të çregjistrojnë tregëtarin/furnizuesin në rastin e transportuesit.

27.9. Titulli i gazit

Nuk mund të gjej asgjë në ligj që e përcakton këtë për Shqipërinë.

Cila është situata aktuale për gazin e prodhuar në pjesën tokësore?

Nuk është e qartë kodin e TAP, por tregëtarët janë tregëtarë me një emër të caktuar tek pika virtuale e tregimit - gjë që padyshim nuk do të mund të funksiononte nëse do t'ia kishit dhënë titullin transportuesit.

Është e vështirë për të kuptuar përkthimin e kodit Kroat - përkthyesi përdor termat "marrje në dorëzim" ose "marrje përsipër", kuptimi i saktë i të cilit nuk është menjëherë i qartë për një folës me gjuhë mëmë anglishten.

Në kodin grek, risku kalon tek transportuesi, por jo titulli me aq sa mund të kuptoj - më është dashur të kontrolloj me një folës të gjuhës greke pasi qartazi ka një gabim në përkthimin në anglisht.

Në mbretërinë e bashkuar, transferimi i titullit dhe i riskut të transportuesit dhe përsëri tek tregëtari/furnizuesi përkatës në dalje.

SHTOJCA 1: SISTEMI I TRANSMETIMIT

PJESA 1: PËRSHKRIMI I SISTEMIT




Figura 4 – Skema e sistemit të transmetimit të gazit

PJESA 2: PAJISJET MATËSE

SHTOJCA 2: PIKAT E NDËRLIDHJES

Tabela A: Pikat e interkoneksionit dhe pikat e hyrjes dhe daljes në lidhje me kapacitetin në drejtimin përpara (forward)

Tabela B: Pikat e hyrjes dhe daljes në lidhje me kapacitetin në drejtim të kundërt (revers)

SHTOJCA 3: FORMULARI I REGJISTRIMIT

SHTOJCA 4: SPECIFIKIMI I GAZIT NATYROR

SHTOJCA 5: PROCEDURA OPERACIONALE PËR LIDHJEN E GAZIT

- a) Transportuesi duhet të theksojë kapacitetin rezervë në sistemin e transmetimit në planin dhjetëvjeçar
- b) Çdo person mund të aplikojë për një lidhje të re me anë të formularit x. formulari përfshin:
 - (i) Detajet e tregëtarëve/furnizuesve ose investitorit
 - (ii) Vendndodhja e kantierit të konsumatorit përfundimtar
 - (iii) Vendndodhja e lidhjes nëse dihet
 - (iv) Konsumi maksimal ditor dhe vjetor për 5 vitet e ardhshme.
 - (v) Presioni maksimal dhe minimal i kërkuar
 - (vi) Data e kërkuar
- c) Transportuesi duhet të kryejë studimin për projektimin në përputhje me tarifën në faqen e internetit / në këtë procedurë.

Aplikuesi duhet të paguajë tarifën për studimin për projektimin.

- d) OSTjep konkluzionet e studimit duke përfshirë emërtimin e kostos së lidhjes të ndarë në:
 - (i) kostot lokale të lidhjes; dhe
 - (ii) kosto për çdo përforsim të rrjetit.
- e) Një emërtim të vlefshëm për [2] vjet
- f) Siguria për lidhjen e barabartë me [25%] të tarifave vjetore të kapacitetit në drejtim të rrjedhës, që paguhet përsëri për regjistrim të suksesshëm të pikës së daljes.
- g) Punimet për lidhjen do të kryhen nga transportuesi ose kontraktori i aprovuar.
- h) Transportuesi duhet të informojë aplikuesin për datën për testimin përfundimtar të lidhjes përpara rrjedhjes tregëtare të gazit.
- i) Të paktën [30] ditë para operimit tregëtar, një tregëtar/furnizues duhet të kryejë procedurat e regjistrimit në vend në përputhje me nenin 24 të kodit.

